

RAPORT VJETOR

PËR VEPRIMTARINË E
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

2025



RRJET I SIGURT,
SHËRBIME CILËSORE



TEKNOLOGJI
E AVANCUAR



INFRASTRUKTURË
MODERNE



POSTË E SIGURT DHE
E BESUESHME

5G



PËRMBAJTJA

PËRMbledhje Ekzekutive	4
KAPITULLI I: ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2025	7
KAPITULLI II: KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE.....	26
2.1 Akte rregullatore në plotësim të kuadrit ligjor	26
2.2 Ecuria e tregut të Komunikimeve Elektronike 2025.....	33
2.2.1 Tregues të rrjetit dhe shërbimeve celulare	35
2.2.2 Shërbimet dhe rrjetet fikse.....	42
2.2.3 Të ardhurat dhe investimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike 2025.....	48
2.2.4 Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike (2025)	54
2.3 Roaming Like at Home	65
2.4 Infrastruktura e rrjeteve të komunikimeve elektronike	67
2.4.1 Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)	67
2.4.2 Standardizimi i rrjeteve kabllore.....	68
KAPITULLI III: TREGU POSTAR.....	71
3.1 Ecuria e tregut postar. Panoramë e treguesve statistikore	71
3.2 Të ardhurat dhe investimet e tregut postar	73
3.3 Statusi i Shërbimit Universal Postar	77
3.4 Transparenca në tarifat e pakove postare ndërkufitare	81
KAPITULLI IV: LICENCIMI, AUTORIZIMI DHE ADMINISTRIMI/ MENAXHIMI I BURIMEVE TË FUNDME.....	83
4.1 Administrimi dhe menaxhimi i frekuencave	83
4.2 Administrimi dhe menaxhimi i numeracionit	87
4.2.1 Alokime/anulime numeracioni 2025	87
4.2.2 Numri i emergjencës 112.....	88
4.3 Regjistri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike.....	89
4.4 Autorizimet, Licencat dhe Certifikatat për shërbimet aeronautike, detare, radioamatore	89
4.5 Veprimtaria monitoruese gjatë vitit 2025	90
4.5.1 Monitorimi i treguesve të cilësisë së shërbimit	91
4.5.2 Mbyllja e transmetimeve në teknologjinë 3G (3G Sëitch off).....	93
4.5.3 Monitorimi i shtrirjes së infrastrukturës 5G	94
4.5.4 Monitorimi i spektrit të frekuencave	95
4.6 Adresimi i problematikave të interferencave të dëmshme	96
4.7 Konformiteti i pajisjeve radio.....	97
KAPITULLI V: MBROJTJA E KONSUMATORIT.....	98

5.1 Treguesit statistikorë të ankesave ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.....	98
5.3 Mosmarrëveshje të trajtuara nga Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve	103
5.4 Portabiliteti i numrave.....	104
5.5 Mbikëqyrja e tregut/inspektimi.....	105
KAPITULLI VI: TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	107
6.1 Siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike	107
6.2 Siguria kibernetike për rrjetet 5G	108
6.3 Administrimi i domain-it.....	108
6.4 Siguria e rrjetit të teknologjisë së informacionit të autoritetit.....	113
KAPITULLI VII: BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE.....	115
7.1 Procesi i integritetit evropian.....	115
7.2 Bashkëpunime ndërinstucionale	117
7.2.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për legjislacionin parësor dhe sekondar	117
7.2.2 Bashkëpunime të tjera.....	119
7.3 Pjesëmarrje në organin e rregullatorëve evropianë (BEREC)	121
7.4 Aktivitete dhe pjesëmarrje në evente gjatë vitit 2025	122
7.4.1 Takim teknik ndërinstucional për funksionimin e tregut të komunikimeve elektronike	122
7.4.2 Takim pune me ofruesit e shërbimit postar për transparencën, cilësinë dhe konkurrencën në treg	123
7.4.3 Takim dialogues mbi reformat për zhvillimin e infrastrukturave digjitale dhe integrimin në BE	124
KAPITULLI VIII: MIRADMINISTRIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	126
8.1 Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe operatorët e shërbimeve postare.....	126
8.2 Ecuria e mbledhjes së detyrimeve financiare.....	130
8.2.1 Procedurat gjyqësore	131
8.2.2 Rishikimet buxhetore gjatë vitit 2025.....	132
8.2.3 Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2025	133
8.3 Reforma institucionale e AKEP-it në kuadrin e ligjit nr. 54/2024.....	135
8.3.1 Miratimi i strukturës së re organizative nga KD.....	135
8.3.2 Metodologjia e pagave dhe trajtimeve financiare të punonjësve	136
8.4 Trajnime profesionale të stafit	137
KAPITULLI IX: DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2026..	139
ANEKS 1: VENDIME TË MIRATUARA NGA KËSHILLI DREJTUES I AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE GJATË VITIT 2025.....	140

ANEKS 2: ÇËSHTJET GJYQËSORE ME PALË AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE	143
Figura 1: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2021-2025.....	38
Figura 2: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonisë Fikse 2021-2025	44
Figura 3: Penetrimi i aksesit <i>broadband</i> nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve (2021-2025)	45
Figura 4: Numri i pajtimtarëve me akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	46
Figura 5: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses <i>broadband</i> fiks sipas shpejtësisë 2021-2025.....	47
Figura 6: Lidhjet <i>broadband</i> fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2025	48
Figura 7: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike 2021-2025 (milion lekë).....	50
Figura 8: Të ardhurat totale të operatorëve celularë 2022-2025 (në milion lekë).....	52
Figura 9: Të ardhurat totale të operatorëve të rrjeteve fikse (në milion lekë).....	53
Figura 10: Pjesët e tregut për të ardhurat sipas operatorëve kryesorë fiks në 2025	54
Figura 11: Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet <i>roaming</i> në BP (2021-2025)	67
Figura 12: Të dhënat e përdorimit të internetit në <i>roaming</i> në BP (në GB).....	66
Figura 13: Pjesët e tregut të ofruesve të shërbimeve postare 2025 (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë postar)	73
Figura 14: Pjesët e tregut sipas të ardhurave ndërmjet disa operatorëve kryesorë	74
Figura 15: Pjesët e tregut sipas të ardhurave të shërbimeve postare 2025	75
Figura 16: Investimet në vite nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë (2021-2025)	76
Figura 17: Ecuria e numrit të objekteve të Shërbimit Universal Postar (2021-2025).....	78
Figura 18: Caktime, anulime të kodeve dhe numrave gjatë vitit 2024-2025	87
Figura 19: Ecuria vjetore e numrit të ankesave të pajtimtarëve të komunikimeve elektronike 2020-2025.....	98
Figura 20: Numri dhe struktura e ankesave të pajtimtarëve sipas objektit/ shërbimit celular dhe fiks (2024-2025)	99
Figura 21: Ecuria mujore e numrit të ankesave të pajtimtarëve të komunikimeve elektronike sipas shërbimeve Celulare vs Fiks (2024-2025)	99
Figura 22: Ankesat e pajtimtarëve sipas operatorëve (2024-2025).....	100
Figura 23: Numri i ankesave për 100,000 pajtimtarë.....	101
Figura 24: Ecuria e sasive vjetore të numrave të portuar 2012-2025.....	103
Figura 25: Ecuria e përqindjes së kërkesave për portime të refuzuara nga operatori dhënës 2016-2025 ..	104
Figura 26: Statistika mbi regjistrimin e domain.al.....	108
Figura 27: Numri i domain .al të regjistruar për çdo Regjistrues gjatë vitit 2025	109
Figura 28: Numri total i Domaineve për çdo regjistrues në fund të vitit 2025	110
Figura 29: Historiku i numrit të domaineve .al dhe nëndomaineve në 5 vitet e fundit.....	111
Figura 30: Historiku i numrit total të domaineve .al në 5 vitet e fundit.....	111
Figura 31: Realizimi i pagesave nga AKEP sipas viteve	127
Figura 32: Struktura e pagesave për AKEP ndër vite.....	129
Figura 33: Struktura e shpenzimeve për vitet 2021-2025	135

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është institucioni rregullator në Republikën e Shqipërisë që ushtron kompetencat për mbikëqyrjen, rregullimin dhe zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe të shërbimeve postare. Në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e Bashkimit Evropian, AKEP ka një rol kyç në garantimin e funksionimit efikas të tregut, promovimin e konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve fundorë.

Në ushtrimin e funksioneve të tij, AKEP harton dhe zbaton politika rregullatore që synojnë krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe transparent për operatorët në treg. Autoriteti administron dhe menaxhon burime të kufizuara kombëtare, si spektri i frekuencave dhe burimet e numeracionit, duke siguruar përdorimin optimal dhe efikas të tyre. Njëkohësisht, AKEP licencon dhe autorizon subjektet që operojnë në sektor, monitoron përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore dhe ndërhyr në rastet e shkeljeve për të ruajtur integritetin e tregut. Një dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së AKEP-it është mbrojtja e konsumatorit. Në këtë kuadër, Autoriteti siguron që përdoruesit fundorë të përfitojnë shërbime me cilësi të lartë, me çmime të arsyeshme dhe në kushte transparence të plotë.

Gjatë vitit 2025, AKEP ka shënuar progres të konsiderueshëm në drejtim të forcimit të rolit të tij rregullator dhe zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare. Arritjet kryesore lidhen me konsolidimin e kuadrit rregullator, përmirësimin e kapaciteteve institucionale, avancimin teknologjik, rritjen e treguesve të tregut etj.

Plotësimi i kuadrit nënligjor: AKEP, gjatë vitit 2025 dhe në vijim, është angazhuar për plotësimin e kuadrit rregullator. Deri më tani janë miratuar 10 akte rregullatore, ndërsa 3 akte nënligjore janë në proces miratimi. Paralelisht, vijon puna edhe për aktet e tjera.

Zgjerimi i shërbimeve 5G në Shqipëri: Operatorët e telefonisë së lëvizshme bazuar në detyrimet e mbulimit në Autorizimin Individual si dhe planet e implementimit, kanë vijuar të zgjerojnë rrjetet e tyre në teknologjinë 5G, duke mundur zhvillimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale.

Megjithatë, përdorimi i brezit 700 MHz prej operatorëve audiovizivë mbetet një pengesë për mbulimin e popullsisë me shërbim cilësor 5G. Brezi 700 MHz vijon të jetë nën administrimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe në përdorim nga operatorët audiovizivë.

Lirimi sa më shpejt i këtij brezi frekuencash do të krijojë mundësinë e mbulimit më të shpejtë të gjithë territorit të vendit me rrjet 5G, si dhe do të shmangë edhe problematikat e interferencave

që transmetuesit e mediave audiovizive iu shkaktojnë operatorëve 5G në zonat kufitare me shtetet fqinje, madje edhe me vende të BE-së si me Greqinë, Italinë dhe Kroacinë.

Zhvillimi i rrjeteve dhe teknologjive: Në fokus të AKEP ka qenë nxitja e operatorëve në treg për zhvillimin e rrjeteve me kapacitet shumë të lartë (VHCN), në përputhje me objektivat dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian; mbështetje në zhvillimin dhe implementimin e teknologjive dhe aplikacioneve inovative nga operatorët celularë si aplikimi i identifikimit dhe i nënshkrimit elektronik, në përputhje me standardet e eIDAS, duke përmirësuar ndjeshëm eksperiencën e përdoruesit dhe efikasitetin operacional.

Rritja e përdorimit të internetit dhe zhvillimi i tregut: Treguesit e monitoruar nga AKEP tregojnë rritje të ndjeshme të përdorimit të internetit dhe zhvillim të vazhdueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike.

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2025, rezultoi rreth 2.1 milionë pajtimtarë (mbi 88% e numrit total të banorëve në Shqipëri) duke sinjalizuar një fazë stabilizimi të këtij numri me dy vitet pararendëse. Përkundrejt këtij stabiliteti sa i përket numrit të përdoruesve, në aspektin e përdorimit të shërbimeve, trafiku i të dhënave celulare ka shënuar rritje të ndjeshme, duke arritur rreth 260 milionë GB, e shprehur në mbi 16% krahasuar me vitin 2024, dhe gati trefishuar me vitin 2020, ku ky volum shënonte rreth 89 milionë GB. Rritje të theksuar ka shënuar edhe konsumi i internetit gjatë qëndrimit në *roaming* në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) duke arritur në mbi 1.6 milionë GB në vitin 2025, e shprehur ndryshe në një rritje me rreth 35% krahasuar me vitin 2024 dhe mbi tetëfishim krahasuar me vitin 2021 (200 mijë GB).

Bazuar në raportimet e kryera për vitin 2025, rezulton se mbulimi i territorit me rrjet 4G ka arritur në nivelin e rreth 97% të territorit dhe rreth 100% mbulim i popullsisë. Për sa i përket rrjetit 5G, përgjatë vitit 2025 shërbimi internet mobile nëpërmjet kësaj teknologjie ofron mbulim në nivele mbi 60% të popullsisë për një operator dhe mbi 70% për operatorin tjetër, ndërsa mbulimi territorial varion nga rreth 15% deri në mbi 36%.

Rritje të konsiderueshme ka shënuar numri i pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fikse duke tejkaluar 733 mijë pajtimtarë, e thënë ndryshe rreth 6% më shumë se viti i kaluar. Norma e penetrimit të aksesit *broadband* nga rrjetet fikse për familje në fund të vitit 2025 arriti në 97%, duke shënuar rritje me rreth 5 pp (pikë përqindje) krahasuar me periudhën pararendëse.

Të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit e ofrimit të rrjeteve fikse tregojnë se, përveç rritjes së numrit të pajtimtarëve, zhvillim mjaft pozitiv ka pasur edhe në drejtim të zhvendosjes drejt shpejtësive më të larta, duke i ofruar këto shërbime me teknologji që mundëson transmetim me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë (kryesisht nëpërmjet fibrave). Vërehet se në fund të vitit 2025 numri i pajtimtarëve që kanë akses me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbëjnë rreth 89% të totalit të numrit të pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fiks, duke shënuar rreth 5 pp rritje në krahasim me periudhën pararendëse. Ndërkaq, numri i pajtimtarëve të shërbimeve

broadband nga rrjetet fikse me akses mbi 100 Mbps është 387,184 (rreth 54% e pajtimtarëve) duke shënuar rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me vitin pararendës (rreth 42% të totalit të pajtimtarëve për 2024).

Mbrojtja e konsumatorit – AKEP i ka kushtuar një vëmendje të shtuar dhe sistematike mbrojtjes së konsumatorit, duke e shndërruar atë në një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së tij rregullatore. Përmes miratimit dhe përditësimit të legjislacionit sekondar, siç janë rregulloret për përmbledhjen e kontratës, rregullorja për portabilitetin e numrit, udhëzimi për internetin e hapur, etj., synohet garantimi i transparencës për shërbimet e ofruara, akses dhe shërbime cilësore në përputhje me praktikatat rregullatore të vendeve të Bashkimit Evropian.

Zhvillimi i sektorit postar dhe përmirësimi i standardeve – AKEP i ka kushtuar vëmendje të veçantë sektorit postar me qëllim rritjen e cilësisë, formalizimin e tregut dhe garantimin e konkurrencës së ndershme në këtë sektor. Gjatë viti 2025 e në vijim, Autoriteti ka zhvilluar disa takime me MIE dhe Postën Shqiptare për adresimin e shqetësimeve të kësaj të fundit, veçanërisht lidhur me tarifat e aplikuara për ofrimin e shërbimit universal postar.

Angazhimi ndërkombëtar dhe integrimi evropian përmes pjesëmarrjes në forume ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me institucione evropiane në funksion të harmonizimit të politikave me BE.

Një tjetër arritje e rëndësishme është **riorganizimi institucional**, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 54/2024. Struktura e re organizative me 70 pozicione pune ka sjellë një ndarje më të qartë të përgjegjësisë, eliminimin e mbivendosjeve dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të institucionit. Krijimi i një sektori të dedikuar për shërbimet postare përbën një hap të rëndësishëm drejt rritjes së efektivitetit rregullator.

Në të njëjtën linjë, **miratimi i metodologjisë së re të pagave**, duke vendosur një sistem transparent dhe konkurrues që mbështet tërheqjen dhe mbajtjen më afatgjatë të burimeve njerëzore të kualifikuara.

Në përfundim, gjatë vitit 2025, AKEP ka luajtur një rol thelbësor në modernizimin dhe zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike dhe postare në Shqipëri. Përmes vendimmarrjeve rregullatore, nxitjes për investime nga ana e operatorëve dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, Autoriteti ka kontribuar në sigurimin e një tregu më konkurrues, më inovativ dhe më të orientuar drejt nevojave të qytetarëve dhe të bizneseve. Këto zhvillime vendosin baza të qëndrueshme për avancimin e mëtejshëm të transformimit digjital dhe integrimin evropian të vendit.

KAPITULLI I: ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2025

- 1. Pas përfundimit të analizës së tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, të marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e masave rregulluese të përcaktuara për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në këtë treg, si dhe problematikave të tjera të dala nga kjo analizë.**

Statusi: Monitorimi dhe vlerësimi i këtij tregu është i vazhdueshëm

Objekti kryesor i analizës dhe rishikimit të tarifave të terminimit të thirrjeve mobile është vlerësimi i konkurrueshmërisë në tregun mobile në Republikën e Shqipërisë dhe marrja e masave të përshtatshme për rregullimin *ex-ante*, me synim nxitjen e konkurrencës dhe eficiencës në këtë treg.

Me Vendimin nr.4, datë 16.2.2024¹, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi dokumentin “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare) – Dokument Përfundimtar”. Procesi i analizës është zhvilluar në përputhje me përcaktimet e ligjit për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë, si edhe duke mbajtur në konsideratë praktikën e ndjekur nga vendet e BE-së për rregullimin e tregjeve të komunikimeve elektronike. Në dokumentin përfundimtar të miratuar nga Këshilli Drejtues i AKEP, u konkludua se në funksion të nxitjes së konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike duhet të vendosen masa rregullatore për të dy sipërmarrësit mobile.

AKEP, në përmbushje të objektivave për nxitjen e konkurrencës, rritjen e eficiencës, ka miratuar Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 4, 5 dhe 6, datë 16.2.2024, duke përcaktuar masa rregullatore, të cilat përfshijnë detyrimin e mosdiskriminimit, detyrimin e transparencës, detyrimin për akses dhe interkoneksion, si dhe detyrimin për kontrollin e tarifave të terminimit. Në mënyrë të veçantë, VKD-të përkatëse për Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a., parashikojnë:

- Detyrimin e mosdiskriminimit, në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 9918/2008², sipas të cilit sipërmarrësit me FNT janë të detyruar të aplikojnë kushte teknike, ekonomike dhe tarifore të barabarta për të gjithë operatorët që kërkojnë terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre, duke parandaluar çdo trajtim preferencial, subvencionim të kryqëzuar apo shtrembërim të konkurrencës në tregjet përkatëse dhe të lidhura me to.
- Detyrimin e transparencës, në përputhje me nenin 40, të ligjit nr. 9918/2008, i cili materializohet përmes detyrimit për publikimin dhe respektimin e kushteve të qarta dhe të verifikueshme për shërbimin e terminimit të thirrjeve, si dhe përmes sigurimit të

¹ https://akep.al/wp-content/uploads/2024/10/2024_014_16022024.pdf

² Masat rregullatore janë vendosur mbi bazën e ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar, dhe janë në fuqi edhe në zbatim të ligjit të ri 54/2024.

informacionit të nevojshëm për operatorët e tjerë dhe për AKEP, me qëllim garantimin e parashikueshmërisë rregullatore dhe monitorimin efektiv të zbatimit të masave.

- Detyrimin për akses dhe interkoneksion, përfshirë përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 9918/2008. Kjo masë synon garantimin e funksionimit normal dhe të pandërprerë të marrëdhënieve ndërmjet rrjeteve, sigurimin e terminimit të thirrjeve në kushte objektive dhe të arsyeshme, si dhe eliminimin e pengesave teknike apo ekonomike që mund të ndikojnë negativisht në tregjet me pakicë dhe në cilësinë e shërbimit për përdoruesit fundorë.
- Detyrimin për kontrollin e tarifave të terminimit, në bazë të nenit 45, të ligjit nr. 9918/2008, i cili përbën masën përkatëse rregullatore në këtë treg. Në VKD-të përkatëse, AKEP ka vendosur tarifa maksimale për terminimin e thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, të përcaktuara mbi bazën e rezultateve të modelit të kostove BU-LRIC, të miratuara me VKD nr. 10, datë 22.7.2021. Zbatimi i këtyre tarifave është parashikuar përmes një mekanizmi përshkallëzimi (*glide path*), duke siguruar një tranzicion të rregullt, të parashikueshëm dhe të qëndrueshëm për tregun dhe operatorët. Përmes këtij mekanizmi, VKD-të kanë përcaktuar vlerat maksimale të tarifave të terminimit për periudha të caktuara kohore, duke reflektuar uljen graduale të tarifave në përputhje me kostot reale të shërbimit dhe konvergjencën me *benchmark*-un evropian të Pure LRIC, sipas praktikave të BEREC dhe Komisionit Evropian.

Vlerat e MTR-së kombëtare për të dy operatorët celularë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 1: Tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile (lekë)

Tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet mobile (lekë)				
Sipërmarrësi	1.12.2019	1.10.2024	1.4.2025	1.10.2025
One Albania	1.11	1.02	0.89	0.75
Vodafone Albania				

Masat rregullatore të miratuara me vendimet e Këshillit Drejtues përkatësisht për One Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. bazohen në rezultatet e analizës së tregut, si dhe vijnë në përmbushje të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit.

Përpos monitorimit të masave rregullatore të paraqitura sa më lart, përgjatë vitit 2024 dhe 2025, AKEP i ka kushtuar vëmendje të veçantë edhe monitorimit të ecurisë së tarifave të shërbimeve celulare me pakicë.

AKEP, në zbatim të Rregullores nr. 27, datë 21.9.2012, e ndryshuar, “Mbi publikimin e informacionit për tarifën, si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, në mënyrë të vazhdueshme monitoron tregun e shërbimeve celulare dhe

fikse në lidhje me publikimin e informacionit të tarifave, ndryshimet e tyre, saktësinë e informacionit që publikohet, formën dhe afatet e njoftimit në AKEP.

Për të mundësuar lehtësi në krahasueshmërinë e planeve tarifore (që janë në shumicën e rasteve paketa të integruara me shërbime telefonie, SMS dhe të dhëna) të aplikuara nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, AKEP përgatit dhe publikon në faqen e internetit informacion mbi planet dhe tarifatat celulare të ofruara nga të dy sipërmarrësit, si për komunikimet brenda vendit ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve *roaming*.

Informacioni i publikuar në këto raporte përmban një përmbledhje të planeve/tarifave kryesore që ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike ofrojnë në treg, të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqesin:

- kategoritë e përdoruesve me parapagesë dhe me kontratë për planet standarde, planet individuale, si dhe planet biznes;
- paketat standarde kryesore, në të cilat referohen tabela të paketave bazë 30-ditore për të dy operatorët, duke përfshirë çmimin, minutat, SMS dhe volumnin e internetit;
- paketat dhe ofertat shtesë, si përmbledhje e paketave ditore, javore, mujore dhe shtesave (data/internet dhe ndërkombëtare), si mundësi për të evidentuar paketat diferencuese ndërmjet operatorëve;
- tarifatat standarde për ofrimin e shërbimeve voice, sms dhe data (internet);
- ofertat për turistë dhe përdorues *roaming* si mundësi për evidentim të ndryshimeve nga një plan tarifar në tjetrin sipas ofruesve mobile, për paketa të dedikuara me volumn të madh interneti apo oferta ditore dhe javore me *roaming* të integruar.

Në kuadër të procesit të hetimit të filluar nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare me pakicë, AKEP ka përcjellë në mënyrë të vazhdueshme informacion mbi raportet e publikuara, si edhe informacion shtesë të detajuar për planet tarifore të shërbimeve të komunikimeve elektronike të ofruara nga të dy sipërmarrësit celularë. Gjithashtu, AKEP, në kuadër të procedurës hetimore të ndërmarrë nga Autoriteti i Konkurrencës, përmes korrespondencave shkresore (nr. 1292, prot., datë 2.9.2025, nr. 1353/1 prot., datë 16.9.2025), ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim në analizimin dhe vlerësimin e shqetësimeve konsumatore në tregun e ofrimit të shërbimeve mobile me pakicë, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit konsumator dhe nxitjes së konkurrencës efektive në treg.

2. Të marrë masa për realizimin e analizës së tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimin e ofruesve të mundshëm të Shërbimit Universal në këtë treg.

Statusi: E zbatuar

Sektori i ofrimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë rregullohet me ligjin nr. 46/2015, i cili shërben si akti rregullator primar për ofrimin e shërbimeve postare dhe në mënyrë specifike, të Shërbimit Universal Postar (SHUP). Ky ligj ngarkon AKEP-in me përgjegjësinë për të garantuar që çdo qytetar, pavarësisht pozicionit gjeografik, qoftë në qendrat urbane apo në zonat më të thella rurale, të ketë akses në një paketë bazë shërbimesh postare me cilësi dhe çmim të përballueshëm. Rëndësia e këtij sektori tejkalon thjesht shkëmbimin e dërgesave, ai funksionon si një mjet i kohezionit social dhe ekonomik. Eksperienca e fundit gjatë pandemisë Covid-19 dëshmoi se rrjeti postar është një infrastrukturë kritike kombëtare, e aftë për të mbajtur gjallë komunikimin dhe shpërndarjen e mallrave jetike edhe në kushte të izolimit total.

Tregu postar shqiptar ka pësuar një transformim rrënjësor, duke u larguar gradualisht nga modeli i vjetër i monopolit shtetëror drejt një tregu të hapur dhe të liberalizuar, në përputhje me parimet dhe aktet rregullatore të aplikuara edhe nga vendet e Bashkimit Evropian. Ky ndryshim nuk ka qenë vetëm rregullator, por edhe teknologjik. Sot, sektori po përballë me fenomenin e "e-zëvendësueshmërisë", ku komunikimi tradicional përmes letrave po zëvendësohet me shpejtësi nga komunikimet elektronike dhe shërbimet publike *online* (e-Albania), gjë që ka çuar në rënie graduale të volumit të letrave tradicionale të ofruara nga shërbimi postar. Megjithatë, kjo rënie e postës së letrave është balancuar nga një rritje eksponenciale e dërgesave të pakove, e nxitur nga vrulli i tregtisë elektronike (e-commerce). Digjitalizimi, i parë fillimisht si kërcënim, po kthehet në një mundësi për ofruesit e shërbimeve postare, ku tashmë shumë prej tyre e kanë diversifikuar portofolin e shërbimeve duke i shndërruar në qendra multifunksionale ku qytetarët mund të marrin një gamë të gjerë shërbimesh digjitale dhe fizike në një pikë të vetme.

Duke qenë se autorizimi 5-vjeçar i Postës Shqiptare sh.a., i dhënë në vitin 2020, përfundonte më 7 korrik 2025, AKEP nisi procedurat ligjore për vlerësimin e tregut që në fillim të vitit 2025. Ky proces u bazua në një metodologji rigoroze që vlerësonte jo vetëm performancën e deritanishme, por edhe kapacitetet tekniko-ekonomike të të gjithë operatorëve të licencuar në vend, për të evidentuar mundësinë e ofrimit të shërbimit universal nga operatorë të tjerë potencial pjesë e tregut. Dokumenti "Analizë e Tregut të shërbimeve postare" shërbeu si baza shkencore për të përcaktuar nëse tregu ishte gati për të mbajtur më shumë se një ofrues të shërbimit universal. Analiza mori në konsideratë densitetin e rrjetit të kërkuar nga VKM nr. 239/2018, kërkesat për mbulim territorial dhe aftësinë financiare për të përballuar ofrimin e shërbimit universal postar edhe në zonat jofitimprurëse.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore AKEP me Vendimit nr. 6, datë 19.5.2025, miratoi dhe nxori për Këshillim Publik dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”. Miratimi i këtij dokumenti iu njoftua palëve të interesuara kryesore, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, si dhe u publikua në faqen e internetit të AKEP për Këshillim Publik për një periudhë 30 ditore, nga data 19 maj – 18 qershor 2025.

Në përfundim të këtij procesi, si edhe vlerësimeve të AKEP, rezultoi se Posta Shqiptare sh.a., mbetet i vetmi operator që plotëson kushtet ligjore dhe teknike për të mundësuar ofrimin e shërbimit universal postar. Si rrjedhojë, Këshilli Drejtues i AKEP, duke marrë në konsideratë edhe të gjithë faktorët e analizuar në dokumentin e analizës, miratoi dokumentin përfundimtar nëpërmjet të cilit miratoi zgjatjen e afatit të autorizimit ekzistues dhe lëshimin e autorizimit të ri individual për subjektin Posta Shqiptare sh.a. Ky akt siguron vazhdimësinë e shërbimit pa ndërprerje pas datës 7 korrik 2025. Autorizimi i ri nuk është thjesht një formalitet, por përmban detyrime të qarta për modernizimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së shpërndarjes dhe mbajtjen e tarifave në nivele të përballueshme, duke synuar formalizmin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e plotë të nevojave të përdoruesve shqiptarë në epokën digjitale.

- 3. Të marrë masat e nevojshme për rishikimin e rregullores “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” bazuar edhe në përcaktimet e reja ligjore të ligjit nr. 54/2024, që lidhen me këtë proces, për të bërë të mundur përmirësimin e procesit të portimit, duke siguruar që të jetë një proces i thjeshtë, efektiv dhe që mbrohet të drejtat e përdoruesve fundorë.**

Statusi: E zbatuar

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 7, datë 12.6.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik “*Projektregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”. Dokumenti për Këshillim Publik përmbante propozimin e AKEP për projektregulloren e re të portabilitetit të numrit që do të zëvendësojë rregulloren aktuale të portabilitetit (*Rregulloren 43/2016*) me qëllim reflektimin e përcaktimeve të reja të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me portabilitetin e numrit, si dhe adresimin e problematikave të evidentuara në vitet e fundit në lidhje me refuzimet e kërkesave për portimin e numrit celular.

Dokumenti “*Projektregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”, i miratuar me VKD nr.7, datë 12.6.2025, u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 18.6.2025, dhe periudha e Këshillimit Publik përfundoi më datë 18.7.2025. Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik në AKEP depozituan komente 2 palë të interesuara.

AKEP pas përfundimit të procesit të këshillimit ka zhvilluar dy takime me datat 12.9.2025 dhe 16.12.2025, me qëllim diskutimin dhe qartësimin e ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe

komenteve të dërguara nga palët e interesuara, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB (Data Baza Qendrore e Portabilitetit të Numrit).

Ndryshimet kryesore midis Rregullores së re për mënyrën, zbatimin e portabilitetit të numrit (në vijim Rregullore) dhe Rregullores aktuale për portabilitetin e numrit (Rregullore nr.43/2016), mund të grupohen në dy grupe kryesore:

- I. Ndryshime për të reflektuar përcaktimet e reja të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me portabilitetin e numrit, që nuk kanë qenë pjesë e ligjit nr. 9918/2008 apo Rregullores 43/2016, që përfshijnë ndër të tjera:
 - i. të drejtën e pajtimtarit/përdoruesit fundor për portimin e numrit te një operator tjetër deri në një muaj nga data e përfundimit të kontratës ekzistuese me operatorin aktual/dhënës (aktualisht një numër nuk mund të portohet pas përfundimit të kontratës/aktivizimit të numrit), si dhe
 - ii. detyrimet e operatorit dhënës për rimbursim, sipas kërkesës, të konsumatorëve për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim (aktualisht me portimin e numrit tek një operator tjetër, pajtimtari i humbet kreditet e papërdorura me parapagim te operatori i mëparshëm).
- II. Ndryshime që synojnë përmirësimin e procesit të portimit nëpërmjet adresimit të problematikave të raportuara nga pajtimtarët dhe/ose të evidentuara nga AKEP-i në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim nga operatorët dhënës, që përfshijnë ndër të tjera:
 - i. vendosjen e detyrimeve për operatorin dhënës (ODH) të numrit për komunikimin dhe informimin e pajtimtarit në lidhje me arsyen e refuzimit të kërkesës për portim (aktualisht këtë detyrim e ka vetëm Operatori Marrës), si dhe
 - ii. implementimin e statusit pezull apo miratimit me kusht për kërkesat për portim të numrave celularë të pajtimtarëve me paspagim që kanë detyrime kontraktore të pashlyera me operatorin aktual/dhënës dhe vendosjen e një afati të arsyeshëm kohor për shlyerjen e këtyre detyrimeve (sipas rregullores aktuale këto kërkesa shpesh refuzohen dhe interpretimet e ndryshme për detyrimet kontraktore bëhen shkak i mosmarrëveshjeve pajtimtar/OM v ODH).

Rregullorja e re e portabilitetit është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 02, datë 2.2.2026.

4. **Gjatë inspektimeve dhe auditeve të ndryshme që AKEP-i kryen, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve të sipërmarrësve në lidhje me implementimin e akteve ligjore dhe rregullatore, që kanë të bëjnë me sigurinë, integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, si dhe atyre që lidhen me mbrojtjen e të dhënave dhe ruajtjen e konfidencialitetit.**

Statusi: Monitorimi dhe vlerësimi i sigurisë së rrjeteve është i vazhdueshëm

Në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP-i, si autoritet rregullator i sektorit, kontribuon në mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare dhe në garantimin e ruajtjes së integritetit dhe sigurisë së rrjeteve publike të komunikimeve elektronike. Në këtë kuadër, ofruesit e rrjeteve publike dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun janë të detyruar të marrin masa teknike, organizative dhe proporcionale për menaxhimin e rreziqeve të sigurisë, përfshirë masa për parandalimin dhe minimizimin e ndikimit të incidenteve (p.sh., masa mbrojtëse ndaj sulmeve DDoS). AKEP gjatë takimeve, tryezave të diskutimit për masat zbatuese të ligjit nr. 54/2024, ka kërkuar nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike implementimin e masave teknike specifike, masave organizative dhe politikave që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike.

Bazuar në ndryshimet ligjore, AKEP me vendimin nr. 8, datë 13.3.2026 ka miratuar ndryshimet rregullatore që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke u bazuar në praktikat më të mira të BE-së. Rregullorja mbi “Masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” përcakton masat teknike dhe organizative që duhet të marrin këta sipërmarrës si dhe politikat që ata duhet të ndjekin. Kjo rregullore do të shërbejë si referencë kryesore në auditimet dhe inspektimet e vazhdueshme që AKEP do të kryejë tek ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike për vitin 2026.

Gjithashtu, sipërmarrësit kanë detyrimin të njoftojnë pa vonesë AKEP-in dhe autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë (AKSK) për incidentet e sigurisë kibernetike që ndikojnë funksionimin e rrjeteve, sistemeve ose shërbimeve. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me AKSK-në ka qenë dhe vijon të jetë i ngushtë, si në aspektin parandalues ashtu edhe në koordinimin e veprimeve për reagimin/mitigimin e incidenteve, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkërendimin me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare, në përputhje me detyrimet ligjore për njoftim dhe shkëmbim informacioni.

AKEP-i ka vijuar të mbajë komunikim të vazhdueshëm (24/7) me sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, me qëllim evidentimin në kohë të problematikave dhe rritjen e gatishmërisë për t’u paraprirë incidenteve të mundshme të sigurisë në sektorin e komunikimeve elektronike.

Gjatë vitit 2025, sipas njoftimeve/raportimeve të marra nga sipërmarrësit, nuk është raportuar asnjë incident i sigurisë kibernetike që të ketë ndikuar funksionimin e rrjeteve, sistemeve ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

5. **Të organizojë një këshillim publik lidhur me implementimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 54/2024, i cili të përfshijë aktorë të ndryshëm, siç janë operatorët e shërbimeve, qytetarët, etj., për të siguruar një proces transparent dhe të drejtë lidhur me ndryshimet e pritshme.**

Statusi: E zbatuar

Transparenca e veprimtarisë së AKEP-s, si dhe zhvillimi i një komunikimi të pandërprerë, me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e komunikimeve elektronike, është objektiv parësor i autoritetit.

Neni 44 i ligjit nr. 54/2024 përcakton se kur AKEP-i synon të marrë masa në përputhje me këtë ligj, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun përkatës, AKEP-i përgjatë procesit të përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, merr dhe vlerëson mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet procesit të këshillimit publik.

Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik, dhe në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit, hartimi i kuadrit nënligjor është shoqëruar me kryerjen e një procesi të gjerë konsultimi dhe këshillimi publik, duke u bërë objekt diskutimi me palët e interesuara.

Për sa më sipër, projektaktet rregullatore të miratuara nga autoriteti i janë nënshtruar një procesi të gjerë këshillimi publik jo më pak se 30 ditë, përpara miratimit të tyre nga Këshilli Drejtues.

Po në kuadër të këshillimit publik, AKEP, në kuadër të zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore të parashikuara në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, gjatë vitit 2025 ka zhvilluar një sërë takimesh me operatorët e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, me synim informimin, konsultimin dhe përgatitjen e tregut për implementimin efektiv të kuadrit të ri ligjor dhe rregullator.

Më 15 korrik 2025 AKEP-i organizoi një takim me ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP), ku morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve publike përgjegjëse. Takimi kishte si qëllim kryesor adresimin e sfidave që lidhen me zbatimin praktik të dispozitave të reja të ligjit nr. 54/2024, veçanërisht në lidhje me aksesin në infrastrukturën publike, procedurat ndërinstitutionale, si dhe nevojën për harmonizim rregullator dhe teknik. Gjatë diskutimeve, AKEP-i ritheksoi angazhimin e tij për të reflektuar shqetësimet e operatorëve në aktet nënligjore dhe për të forcuar mbikëqyrjen e respektimit të kushteve të autorizimit, në përputhje me kërkesat e reja ligjore.

Gjithashtu, më 3 nëntor 2025, u zhvillua takimi dialogues mbi reformat për zhvillimin e infrastrukturave digjitale dhe procesin e integritit në Bashkimin Evropian, i organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP. Ky takim u zhvillua në

funksion të implementimit të reformave të parashikuara nga ligji nr. 54/2024, si dhe të harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar me Rregulloren e Bashkimit Evropian për Infrastrukturën Gigabit (GIA).

Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, operatorë të komunikimeve elektronike dhe aktorë të tjerë të tregut, të cilët kontribuan me sugjerime dhe ide konkrete për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe zbatimin praktik të dispozitave që lidhen me zhvillimin e rrjeteve me shpejtësi shumë të lartë. Gjatë këtij takimi u trajtuan çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave të reja të ligjit nr. 54/2024 në fushën e *broadband* dhe zhvillimit të infrastrukturave digjitale.

Këto takime të zhvilluara dëshmojnë angazhimin e AKEP-it për të siguruar një proces transparent dhe gjithëpërfshirës të implementimit të ligjit nr. 54/2024, për të përmirësuar dialogun ndërinstitucional dhe për të rritur ndërveprimin me operatorët e tregut. Në këtë kuadër, AKEP synon forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe respektimin e kuadrit ligjor e rregullator të ri, si dhe ndërtimin e një mjedisi konkurrues, transparent dhe të qëndrueshëm, në shërbim të interesit të qytetarëve dhe bizneseve.

6. Të vijojë punën për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë që të sigurohet implementimi i tij.

Statusi: Në proces

Në zbatim të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që ka hyrë në fuqi në datën 20 dhjetor 2024, gjatë vitit 2025 e në vijim, AKEP ka qenë i angazhuar në hartimin dhe miratimin e akteve të nevojshme rregullatore, një pjesë e të cilave tashmë janë miratuar. Ndër to, përmendim akte me ndikim të drejtpërdrejtë në tregun e komunikimeve elektronike sikurse Rregullorja për Regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm.

Aktet e miratuara gjatë periudhës raportuese, renditen më poshtë:

1. Miratimi i disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike”, të ndryshuar” (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 9, datë 23.7.2025);
2. Vendim “Për miratimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 13, datë 27.8.2025);

3. Rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 22, datë 3.11.2025);
4. Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 23, datë 3.11.2025);
5. Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 26, datë 14.11.2025);
6. Rregullore “Për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr.1, datë 2.2.2026);
7. Rregullore “Për zbatimin e portabilitetit të numrit”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 2, datë 2.2.2026);
8. Rregullore “Për analizën e tregjeve”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 7, datë 13.3.2026);
9. Rregullore “Për masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 8, datë 13.3.2026);
10. Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, (miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 10, datë 31.3.2026).

Nga ana tjetër, ka përfunduar procesi i Këshillimit Publik dhe është në proces miratimi përfundimtar, projektakti:

1. Projektregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike” (miratuar për Këshillim Publik me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 28, datë 14.11.2025, pas finalizimit të procedurës së Këshillimit Publik dhe vlerësimit të komenteve të palëve pritet miratimi i aktit nga AKEP).

Ndërkohë AKEP vijon punën për plotësimin e paketës së plotë së akteve nënligjore/rregullatore në zbatim të ligjit nr. 54/2024.

7. **Pas miratimit të ligjit nr. 54/2024 dhe duke u bazuar në praktikat më të mira të BE-së, të marrë masa për implementimin në kohë të ndryshimeve rregullatore, që kanë të bëjnë me sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.**

Statusi: E zbatuar

Ligji nr. 54/2024 e ka ngarkuar AKEP-in me detyrimin për të përcaktuar rregulla të detajuara mbi masat që operatorët duhet të marrin për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të tyre. Kjo rregullore synon të krijojë një standard të unifikuar për të gjithë operatorët, në përputhje me praktikën më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar mbrojtjen e përdoruesve dhe funksionimin e qëndrueshëm të rrjeteve kombëtare.

Projektakti është hartuar në përputhje të plotë me dispozitat e ligjit nr. 54/2024, konkretisht:

- a) Nenit 56, pika 1, që ngarkon AKEP-in me mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 54, lidhur me marrjen e masave mbrojtëse teknike dhe organizative nga ofruesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, me qëllim garantimin e sigurisë dhe integritetin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike;
- b) Nenit 157, pika 10, që parashikon detyrimin e Autoritetit për të përcaktuar standarde dhe procedura për njoftimin, raportimin dhe trajtimin e incidenteve që ndikojnë në funksionimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike.

Me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 3.11.2025, AKEP-i ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik “*Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike*”. Dokumenti u publikua për Këshillim Publik në faqen zyrtare të AKEP gjatë periudhës 4.11.2025 - 3.12.2025.

Në përfundim të këtij procesi, pranë AKEP-it janë depozituar komente në rrugë elektronike më datë 2.12.2025, komente dhe vlerësime nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Zyra e Komisionerit). Gjatë muajit dhjetor 2025, pranë AKEP-it janë depozituar në rrugë elektronike komente dhe vlerësime nga sipërmarrësi i komunikimeve elektronike Vodafone Albania sh.a., dhe “One Albania” sh.a..

Rregullorja “Për masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 8, datë 13.3.2026.

- 8. Pas rritjes së pritshme të kapaciteteve logjistike nga Posta Shqiptare sh.a., të monitorojë ecurinë e përmirësimit të shërbimit për përmbushjen e detyrimit të shpërndarjes së objekteve postare në adresën e marrësit.**

Statusi: Monitorimi dhe vlerësimi është i vazhdueshëm

Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik të dokumentit *Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal*, AKEP, me vendimin nr.17,

datë 14.10.2025, miratoi dhënien e Autorizimit Individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e Shërbimit Universal Postar, me afat vlefshmërie 5 (pesë) vjet, nga data 7.7.2025 deri 7.7.2030. Në këtë autorizim janë përcaktuar detyrime të qarta për modernizimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së shpërndarjes dhe mbajtjen e tarifave në nivele të përballueshme, duke synuar formalizmin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e plotë të nevojave të përdoruesve shqiptarë në epokën digjitale. Në vijim të dhënies së Autorizimit Individual, me qëllim verifikimin e përmbushjes së kushteve të këtij autorizimi, AKEP me shkresën nr.1461/10 prot., datë 24.12.2025, ka kërkuar nga Posta Shqiptare informacion mbi treguesit e cilësisë së ofrimit të Shërbimit Universal Postar për vitin 2025, si dhe masat e ndërmarra për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm.

9. Të konsiderojë nga viti 2025 e në vijim implementimin e metodologjisë së vendeve të BE-së për përcaktimin e tarifave të terminimit duke qenë se ato kanë për qëllim orientimin e çmimeve drejt kostos së terminimit të thirrjeve.

Statusi: E zbatuar

Bazuar në proceset e analizave më të fundit të tregut të terminimit në rrjetet celulare (2024) dhe fikse (2025), AKEP ka konstatuar vijimësinë e karakteristikave strukturore të këtyre tregjeve si tregje me mungesë konkurrence efektive në tregjet me shumicë të analizuara, ku secili operator zotëron fuqi dominuese në ofrimin e shërbimit të terminimit në rrjetin e vet. Në këtë aspekt, AKEP ka ndërmarrë vendimmarrje rregullatore për vendosjen dhe reduktimin e tarifave të terminimit celular (MTR) dhe fiks (FTR), duke u mbështetur në metodologji të orientuara drejt kostove, në praktikat më të mira evropiane dhe në parimet e proporcionalitetit dhe transparencës rregullatore.

Për rrjetet celulare, vendimet e AKEP-it të nxjerra pas analizës së tregut kanë përcaktuar nivele të MTR-së të ulëta, simetrike dhe në trend zbritës, me synimin për të reflektuar kostot reale të një operatori efikas dhe për të shmangur transferimet e padrejta financiare ndërmjet operatorëve.

Në mënyrë të ngjashme, për rrjetet fikse, AKEP ka konfirmuar nevojën për rregullim *ex-ante* të FTR-së, duke marrë në konsideratë strukturën e tregut, nivelin e kufizuar të zëvendësueshmërisë dhe rëndësinë e këtij shërbimi për funksionimin e qëndrueshëm të lidhjes ndërmjet rrjeteve. Nëpërmjet vendimeve përkatëse (VKD nr.19/20/21, datë 3.11.2025) AKEP ka vendosur që tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet fiks të telefonisë të jenë të orientuara nga kosto, të harmonizuara me trendet evropiane dhe të përshtatshme për realitetin e tregut shqiptar.

AKEP ka vlerësuar që tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet e operatorëve që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse të jenë sipas vlerave dhe afateve të mëposhtme, ku për përcaktimin e tarifave të terminimit është përdorur tarifa e përcaktuar në rregulloren e BE

2021/654 (*Commission Delegated Regulation* (EU) 2021/654), si edhe krahasimi me tarifat mesatare të vendeve të rajonit.

Tabela 2: Reduktimi i tarifave të interkoneksionit në rrjetet fikse

	Aktualisht	1. 3. 2026	1. 9. 2026	1. 3. 2027	Ndryshimi 2026/2025
One Albania (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%
Operatorët Alternativë (Lokal/Njëfish)	0.7	0.3	0.15	0.07	-57%

Shënim: Tarifat në Lekë pa TVSH

Rregullimi i tarifave sipas nivelit *benchmark* (mesatar) dhe reduktimi i përshkallëzuar është një praktikë e ndjekur nga AKEP më parë si dhe një praktikë e lejuar nga ligji nr. 54/2024, neni 6, pika 3 dhe neni 100, pika 8.

Megjithatë, pavarësisht progresit të dukshëm në rregullimin e MTR dhe FTR në nivel kombëtar, mbetet e domosdoshme që këto zhvillime të shihen në një kontekst më të gjerë, veçanërisht në funksion të rregullimit të shërbimeve *roaming* ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, diferencat ende ekzistuese ndërmjet niveleve të tarifave të terminimit në Shqipëri dhe atyre të përcaktuara në BE përbëjnë një element kyç që ndikon drejtpërdrejt në kostot e *roaming*-ut dhe, rrjedhimisht, në çmimet që paguajnë përdoruesit shqiptarë dhe ata evropianë.

Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2021/654 ka përcaktuar nivele maksimale të harmonizuara për tarifat e terminimit celular dhe fiks në Bashkimin Evropian, duke synuar eliminimin e devijimeve ndërmjet tregjeve kombëtare dhe krijimin e një baze të qëndrueshme për funksionimin e parimit ‘*Roam Like at Home*’. Në këtë kuadër, përafrimi gradual i MTR dhe FTR në Shqipëri me këto nivele evropiane paraqitet jo vetëm si një objektiv teknik rregullator, por edhe si një domosdoshmëri strategjike për integrimin e tregut shqiptar të komunikimeve elektronike me tregun evropian.

Vlen të theksohet se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe AKEP gjatë vitit 2025 i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë procesit të reduktimit të tarifave të shërbimit *roaming* midis Shqipërisë dhe vendeve të BE-së, dhe në këtë kuadër, në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit dhe Kryenegociatoren dhe strukturat e Komisionit Evropian kanë filluar përgatitjen e draftakteve të nevojshme të cilat do të mundësojnë harmonizim të plotë të legjislacionit të Shqipërisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian për të bërë të mundur fillimin e RLAH midis dy palëve.

Në vijim të sa më lart, në koordinim me AKEP, MIE ka nxjerrë për Këshillim Publik miratimin e disa ndryshimeve në ligjin 54/2024 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024 “Për*

komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konsultim i cili parashikon të përfundojë me datë 20 janar 2026. Projektligji i shërben përmbushjes së objektivit politik të shprehur nga udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor dhe Drejtuesit e Lartë të Bashkimit Evropian për integrimin e përshpejtuar të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian për zbatimin e ‘Roaming Like At Home’ me BE. Projektligji është një hap i nevojshëm për realizimin e RLAH e cila do të sillte përfitime për lëvizjen e lirë të qytetarëve dhe do të përmirësonte klimën e biznesit midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të Bashkimit Evropian dhe do ishte një hap i rëndësishëm drejt integritetit në tregun unik digjital të BE-së.

Në projektligjin e propozuar për ndryshimin e ligjit nr. 54/2024, i cili përbëhet nga 10 nene, në nenin 6-të të tij është parashikuar: shtimi i nenit 100/1 për tarifat e terminimit për thirrjet zanore me shumicë për zbatimin e RLAH me vendet e BE-së. Neni 100/1 bën një harmonizim të plotë me nenin 75 të direktivës 2018/1972/EU dhe lidhet me zbatimin e shërbimit *roaming* me BE, në veçanti me rregullimin e tarifave të terminimit të thirrjeve zanore, si nga rrjetet e lëvizshme dhe atyre fiks, me Eurotarifën që zbatohet për RLAH.

Pra rregullimi i tarifave të terminimit në përputhje me praktikën e ndjekur nga vendet e BE-së, është domosdoshmëri për të kompletuar setin e masave ligjore dhe nënligjore për harmonizimin e legjislacionit dhe mundësimin e fillimit të RLAH me vendet e BE-së. AKEP, në përputhje me ndryshimet e pritshme të ligjit, si edhe akteve të tjera do të rishikojë tarifat e terminimit të thirrjeve sipas përcaktimit të tarifave të BE-së.

Arsyetimi për nevojën e rregullimit të mëtejshëm të MTR dhe FTR, në përputhje me përcaktimet e Rregullores (BE) 2021/654, lidhet drejtpërdrejt me nevojën për të krijuar kushte të qëndrueshme për rregullimin e *roaming* Shqipëri – BE. Ulja dhe harmonizimi i tarifave të terminimit redukton kostot me shumicë të *roaming*-ut, krijon hapësirë për marrëveshje më të favorshme ndërmjet operatorëve dhe shmang rrezikun e mbajtjes së çmimeve të larta për përdoruesit fundorë për shkak të kostove të tepruara ndër-operatoriale. Në këtë kontekst, vendimmarrja e AKEP-it për MTR dhe FTR, përbën një themel të rëndësishëm rregullator mbi të cilin *mund* dhe *duhet* të ndërtohen hapat e mëtejshëm drejt përafrimit me eurotarifat.

Në përfundim mund të vlerësohet se pika 9 e Rezolutës është në zbatim dhe në proces të vazhdueshëm, ndërkohë që zhvillimet rregullatore për rrjetet celulare dhe fikse në Shqipëri, të reflektuara në vendimet e AKEP-it për rregullimin e MTR dhe FTR, përbëjnë ndër të tjera dhe adresimin e kërkesave të pikës 9 të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë. Këto zhvillime do të shoqërohen me një proces të integruar që lidh rregullimin kombëtar të terminimit me objektivin strategjik të rregullimit të *roaming* Shqipëri – BE dhe me synimin për arritjen e niveleve të eurotarifave të aplikuara në vendet e Bashkimit Evropian.

10. Të rrisë përpjekjet për promovimin e investimeve në rrjetet e shpejtësisë së lartë, përfshirë 5G, dhe konkurrencën efektive në treg, duke pasur në vëmendje

mbrojtjen e përdoruesve dhe sigurimin e shërbimit universal të komunikimeve elektronike sipas përcaktimeve të ligjit të ri dhe përvojave në vendet e BE-së.

Statusi: Monitorimi dhe vlerësimi është i vazhdueshëm

AKEP, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit lidhur me rritjen e përpjekjeve për promovimin e investimeve në rrjetet e shpejtësisë së lartë, përfshirë rrjetet 5G, si dhe garantimin e konkurrencës efektive në treg, informon se këto objektiva përbëjnë prioritetet thelbësore të veprimtarisë së tij rregullatore, në përputhje me ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe praktikën më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

Në këtë kuadër, AKEP ka ndërmarrë dhe vijon të ndërmarrë masa rregullatore dhe administrative për krijimin e një mjedisi të favorshëm për investime afatgjata në rrjetet e komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta, duke përfshirë menaxhimin efikas të spektrit të frekuencave radio, lehtësimin e procedurave për autorizim dhe përdorim të rrjeteve, si dhe nxitjen e përdorimit të përbashkët të infrastrukturave ekzistuese, në përputhje me parimet e konkurrencës dhe neutralitetit teknologjik.

AKEP i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të rrjeteve 5G, si një element kyç për transformimin digjital të ekonomisë dhe shërbimeve publike, duke siguruar që proceset e dhënies në përdorim të frekuencave të shoqërohen me kushte që nxisin investimet, mbulojnë territorin në mënyrë progresive dhe garantojnë konkurrencë të drejtë ndërmjet operatorëve.

Gjatë vitit 2025, AKEP ka ndërmarrë një sërë veprimesh konkrete për krijimin e një ekosistemi rregullator që përshpejton investimet në rrjetet 5G dhe infrastrukturën mbështetëse. Këto veprime kanë përfshirë komunikime të vazhdueshme me operatorët celularë lidhur me ecurinë e mbulimit 5G, bashkëinvestimet për ndërtimin e stacioneve të reja në zona me densitet të ulët popullsie, si dhe monitorimin e zbatimit të kushteve të Autorizimeve Individuale.

AKEP ka luajtur një rol aktiv ndër-institucional për lehtësimin dhe përshpejtimin e procedurave administrative për instalimin/ndërtimin e stacioneve BTS dhe shtrirjen e rrjeteve me fibër optike, përmes komunikimeve dhe takimeve të rregullta me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), bashkinë Tiranë, ARRSH, AZHT, OSHEE dhe operatorët e tregut.

Në kuadër të monitorimit të shtrirjes së infrastrukturës 5G, në përmbushje të kushteve të Autorizimit Individual, gjatë vitit 2025, AKEP ka patur komunikime të vazhdueshme me operatorët celularë për t’u përditësuar me ecurinë e implementimit të planit të veprimit për mbulimin me shërbim 5G, si dhe mbulimin e zonave të rëndësishme të veçantë si porte, aeroporte, zona turistike, rrugë kombëtare si dhe tunele në akset kombëtare.

Sipas përcaktimeve në kushtet e autorizimit individual me të cilin janë pajisur operatorët celularë, detyrimet për mbulimin me shërbim 5G janë 55% e popullsisë brenda vitit 2027 dhe 85% të popullsisë brenda vitit 2030. Konkretisht mbulimi me sinjal i porteve, aeroporteve, zonës industriale Tiranë- Durrës, qendrat spitalore të Tiranës deri në fund të vitit 2025 si dhe mbulimi me shërbim 5G në të gjitha qytetet e Shqipërisë deri në fund të vitit 2028.

Gjatë vitit 2025, operatori One Albania ka instaluar 64 stacione të reja që operojnë në brezin 3.4-3.6 GHz, duke bërë të mundur mbulimin me shërbim në nivelet 46.6% të popullsisë dhe 15.7% të territorit. Deri në fund të vitit 2026, operatori parashikon edhe instalimin e 50 stacioneve të reja në disa qytete të vendit. Ndërkohë, duke përdorur edhe brezat e tjerë frekuencorë, One Albania sh.a., ka arritur të mbulojë me shërbime 5G mbi 70% të popullsisë.

Për përmbushjen e detyrimeve të autorizimit për vitin 2025, One Albania ka hasur vështirësi në implementimin e stacioneve 5G në aeroportin e Kukësit dhe të Vlorës, kjo për arsye se këto aeroporte nuk janë funksionale dhe për t'i mbuluar me shërbim duhet të vendosen pajisje në ambiente të brendshme.

Gjithashtu, operatori One Albania ka kryer investime të rëndësishme më qëllim përmirësimin e mbulimit me sinjal të vendit edhe me shërbimet 2G/3G/4G si dhe janë rritur kapacitetet në stacionet ekzistuese për teknologjinë 4G ku kërkesa për internet është më e lartë. Konkretisht janë ndërtuar 23 stacione të reja *macro* dhe *micro* (*small cell* dhe *remote cell*), që shërbejnë aktualisht në akset e reja rrugore, pikat turistike dhe vijën bregdetare, si dhe janë rritur kapacitetet e transmetimit LTE për 168 stacione në breza të ndryshëm frekuencorë 900/1800/2100 dhe 2600 MHz.

Për vitin 2026-2029 janë parashikuar investime të reja veçanërisht në ndërtimin e stacioneve të reja të transmetimit në zona bregdetare (si Palasë, Sarandë, Kepi Rodonit), malore (si Grykë Nokë, Lurë) dhe akse rrugore (si lumi i Vlorës- Qeparo, By Pas Vlorë- Orikum, rruga e Arbërit, aksi rrugor Vlorë, Kuç, Gusmar, Tepelenë, Ura Laskos Qeparo, Kardhiq Delvinë, Qukës- Qafë Plloçë).

Ndërkohë, operatori Vodafone Albania gjatë vitit 2025 ka instaluar 130 stacione të reja në brezin 3.5 GHz dhe aktualisht mbulohen me shërbim 42.2% e popullsisë dhe 15.3% e territorit të vendit në këtë brez frekuencor. Por, përveç brezit 3.5 GHz, Vodafone Albania përdor edhe brezin 1800 MHz për mbulimin me shërbimet 5G në disa qytete kryesore të vendit dhe mbulimi aktual i popullsisë, i llogaritur në mënyrë të kombinuar për të dyja bandat frekuencore, arrin mbi 60%.

Në kuadër të investimeve të kryera për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonave turistike bregdetare/malore, operatori Vodafone Albania gjatë vitit 2025 ka aktivizuar 12 stacione të përhershme dhe 8 stacione të përkohshme. Gjithashtu është përmirësuar mbulimi me sinjal i akseve rrugore kombëtare problematike, duke aktivizuar stacionet në Tunelin e Murrizit, Skuraj Rep, Skërfica, Dedaj, Bradashesh. Sa i takon akseve të reja rrugore, operatori ka ndërmarrë

investime për implementimin e një stacioni të ri në rrugën e Arbërit i cili ende nuk ka përfunduar.

Për aksin Kardhiq-Delvinë është aktivizuar një stacion dhe aktualisht Vodafone Albania është në negociata me ARRSH për instalimin e një stacioni që do të mundësojë mbulimin e Tunelit të Skërficës si edhe një pjesë të rrugës. Aktualisht mbetet problem furnizimi me energji elektrike.

Aksi rrugor Qukës-Qafë Plloçë është pjesërisht i mbuluar pasi nga operatori është bërë upgrade në stacionin ekzistues Slabinjë. Gjithashtu është duke u vlerësuar ndërtimi i një stacioni të ri, pjesë e planit të investimeve të përbashkëta me One Albania.

Në aksin Vlorë-Kuç-Gusmar-Tepelenë – aksi Vlorë-Kuç është aktualisht i mbuluar me aktivizimin e stacioneve të përkohshëm. Zgjidhja e përhershme do të jetë me aktivizimin e stacionit të ri Lumi i Vlorës. Aktualisht, në pritje për zbardhjen e lejes së ndërtimit nga AZHT.

Për aksin Kuç-Gusmar-Tepelenë është planifikuar një stacion i ri i përbashkët, aktualisht është në fazën e prokurimit.

Aksi Ura Laskos-Qeparo mbulohet në pjesën më të madhe nga tre stacione të aktivizuara më parë. Pjesa e mbetur do të mbulohet me aktivizimin e stacionit të ri Lumi i Vlorës, aktualisht në pritje për zbardhjen e lejes së ndërtimit.

Për shkak të vonesave në marrjen e lejeve të ndërtimit të stacioneve të reja, gjatë vitit raportues, AKEP ka vijuar bashkëpunimin me autoritetet kompetente si AZHT, ARRSH, Bashki, MIE me qëllim përshpejtimin e këtyre procedurave.

Implementimi i teknologjisë së re 5G, ka sjellë nevojën për investime të reja në AKEP, lidhur me përditësimin e sistemit të monitorimit të treguesve të cilësisë për matjen e performancës së këtyre rrjeteve. Ky investim, i cili është parashikuar në buxhetin e vitit 2026, do të ndikojë në përmirësimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullatore të Autoritetit, duke siguruar zbatim më efektiv të detyrimeve ligjore të operatorëve për cilësinë e shërbimit dhe transparencën ndaj publikut sa i takon shërbimeve 5G.

Paralelisht, AKEP-i ushtron kompetencat e tij për garantimin e konkurrencës efektive në treg, përmes analizave të tregut, vendosjes së detyrimeve rregullatore proporcionale ndaj operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg dhe monitorimit të vazhdueshëm të sjelljes së tregut, me synim mbrojtjen e interesave të përdoruesve fundorë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Në drejtim të mbrojtjes së përdoruesve, AKEP ka forcuar monitorimin e cilësisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike, transparencën e ofertave dhe respektimin e të drejtave kontraktore të përdoruesve, si dhe ka vijuar trajtimin e ankesave dhe ndërhyrjet rregullatore kur konstatohet mosrespektim i detyrimeve ligjore nga operatorët.

AKEP vlerëson se masat dhe aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit 2025 kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e rekomandimit të Kuvendit dhe ndërkohë mbetet i angazhuar për të vijuar përmirësimin e kuadrit rregullator dhe zbatimin e tij efektiv, në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe aktorët e tregut, me synim zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të komunikimeve elektronike dhe përshejtimin e transformimit digjital të vendit.

11. Të vijojë monitorimet e treguesve të cilësisë së shërbimit QoS (*Quality of service*) të telefonisë së lëvizshme në të gjitha zonat e Republikës së Shqipërisë, përfshi akset rrugore të vendit dhe zonat turistike, duke kërkuar nga dy operatorët në treg vendosjen e stacioneve provizore apo optimizimin e antenave ekzistuese në zonat ku mbulimi me sinjal nuk i përmbush parametrat KPI (*key Performance Indicators-Indikatorët Kyç të Performancës*).

Statusi: Monitorimi dhe vlerësimi është i vazhdueshëm

AKEP, në zbatim të rekomandimit të Kuvendit për vijimin e monitorimit të treguesve të cilësisë së shërbimit (QoS) të telefonisë së lëvizshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë akset rrugore dhe zonat turistike, informon se monitorimi i cilësisë së shërbimit përbën një komponent thelbësor të veprimtarisë së tij mbikëqyrëse dhe rregullatore.

Në këtë kuadër, gjatë periudhës raportuese AKEP-i ka vijuar realizimin e matjeve sistematike të treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe standardet përkatëse evropiane, duke përfshirë matje në zona urbane dhe rurale, përgjatë akseve rrugore kombëtare, si dhe në zonat turistike. Raportet e monitorimit të përgatitura nga ekspertët e AKEP-it i janë përcjellë për njohje edhe operatorëve celularë, duke i kërkuar marrjen e masave konkrete për mbulimin e tyre me shërbim cilësor.

Bazuar në rezultatet e monitorimeve dhe analizën e përmbushjes së indikatorëve kyç të performancës (KPI), AKEP ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me operatorët e telefonisë së lëvizshme, duke kërkuar marrjen e masave korrigjuese në zonat ku janë evidentuar mangësi në mbulim ose cilësi shërbimi. Këto masa kanë përfshirë, sipas rastit, optimizimin e konfigurimit të antenave ekzistuese, rritjen e kapaciteteve të rrjetit, si dhe vendosjen e stacioneve provizore të transmetimit për të përballuar ngarkesën e shtuar të trafikut.

Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë kryer matje në qytetet Burrel, Klos, Laç, Peshkopi, Bulqizë, Fier, Selenicë, Korçë, Liqenas; në zonat turistike Bylis, Dardhë-Voskopojë; në akset rrugore Rruga e Arbrit, Lis-Lapidar-Klos, Ura e Qerenecit-Klenjë, Qafë Bualli-Krastë, akset e qarkut Korçë, Aksi Korçë-Voskopojë, aksi Qukës-Qafë Plloçë, aksi Lumi i Vlorës, Aksi Kotë-Sevaster-Kalivaç, aksi Tiranë-Dogana, Pustec-Dogana, Kapshticë-Korçë-Ersekë-Leskovik-Përmet-Tepelenë.

Në mënyrë të veçantë, AKEP ka kryer verifikime të detajuara mbi nivelin e mbulimit me sinjal celular të tre akseve të rëndësishme kombëtare: “Bylis” dhe aksin rrugor drejt tij në bashkinë Mallakastër, aksin rrugor “Lumi i Vlorës” dhe aksin rrugor “Qukës–Qafë Plloçë”, sipas kërkesës së deputetëve të Kuvendit, të cilët më pas janë informuar nga AKEP mbi rezultatet e monitorimit të kryer.

Zonat ku janë përmirësuar niveli i sinjalit celular si dhe transmetimi i të dhënave (internetit) janë qyteti Burrel, zona turistike Dardhë dhe aksi rrugor drejt kësaj zone, zona turistike Voskopojë dhe aksi rrugor drejt saj, aksi Rruga e Arbrit dhe aksi Lumi i Vlorës.

Përveç monitorimeve të kryera, AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me operatorët celular për përmirësimin e sinjalit me shërbim në zonat turistike gjatë sezonit veror duke siguruar optimizimin e antenave ekzistuese si dhe vendosjen e stacioneve provizore (referojuni informacionit në pikën 10 më sipër).

AKEP i kushton vëmendje të veçantë zonave të rëndësishme strategjike, si akset rrugore kryesore, pikat turistike dhe zonat me fluks të lartë përdoruesish, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimit dhe përmbushjen e parametrave minimalë të cilësisë së shërbimit për përdoruesit fundorë.

AKEP do të mbetet i angazhuar për të garantuar mbrojtjen e interesave të përdoruesve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve të telefonisë së lëvizshme edhe gjatë vitit 2026, duke i nxitur operatorët e telefonisë së lëvizshme për mbulimin me shërbim cilësor të akseve rrugore të vendit, zonave turistike malore dhe bregdetare apo zonave rurale me densitet të ulët popullsie.

KAPITULLI II: KOMUNIKIMET ELEKTRONIKE

2.1 Akte rregullatore në plotësim të kuadrit ligjor

Ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, që ka hyrë në fuqi më 20 dhjetor 2024, ka transpozuar pjesërisht Direktivën (EU) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11.12.2018, “Për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike”. Në zbatim të nenit 191, të ligjit nr. 54/2024, AKEP ka detyrimin të miratojë paketën e akteve nënligjore, të cilat sigurojnë zbatimin e plotë dhe efektiv të dispozitave të ligjit.

Neni 44 i ligjit organik, përcakton se, kur AKEP synon të marrë masa në përputhje me këtë ligj, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në tregun përkatës, përgjatë procesit të përgatitjes së dokumenteve rregullatore për tregun e komunikimeve elektronike dhe përpara marrjes së vendimeve, AKEP merr dhe vlerëson mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet procesit të Këshillimit Publik. Projektaktet rregullatore të miratuara nga institucioni i janë nënshtruar një procesi të gjerë Këshillimi Publik, jo më pak se 30 ditë përpara miratimit të tyre nga Këshilli Drejtues.

Në kuadër të këtij procesi, AKEP ka organizuar disa tryeza/takime diskutimi për aktet si më poshtë:

- Në datat 12.9.2025 dhe 16.12.2025, lidhur me miratimin e rregullores, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, janë zhvilluar dy takime me përfaqësues të sipërmarrësve “Vodafone Albania” sh.a., dhe “One Albania” sh.a., me qëllim diskutimin dhe qartësimin e ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe komenteve të dërguara nga palët e interesuara, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB (Data Baza Qendrore e Portabilitetit të Numrit);
- Në datën 16.12.2025, lidhur me miratimin e rregullores, “Për përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, me përfaqësues të sipërmarrësve “Vodafone Albania” sh.a., dhe “One Albania” sh.a.;
- Në datën 18.2.2026, lidhur me miratimin e rregullores, “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, është organizuar një takim në nivel teknik, me përfaqësues teknik të sipërmarrësve “Vodafone Albania” sh.a., dhe “One Albania” sh.a., ku është diskutuar lidhur me parashikimet e reja të rregullores në kuadër të ndryshimeve të ligjit nr.54/2024, harmonizimit me detyrimet ndërkombëtare sa i përket sigurisë së rrjeteve, marrjes së propozimeve dhe vlerësimeve nga ana e operatorëve dhe arritjes së dakordësisë përpara miratimit të saj.

Pas finalizimit të procesit të këshillimit publik dhe shqyrtimit të komenteve, sugjerimeve e propozimeve të palëve të interesuara, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar aktet rregullatore si më poshtë:

1. *Rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.*

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 12, datë 27.8.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik, projektregullore, “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”. Dokumenti për Këshillim Publik, projektregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, u publikua në faqen e internetit të AKEP më datë 26.8.2025, dhe periudha e Këshillimit Publik përfundoi më datë 26.9.2025, duke ofruar mundësinë për komente dhe propozime nga operatorët dhe palët e tjera të interesuara të tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurës për mënyrën e llogaritjes dhe kryerjes së pagesës vjetore në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar. Qëllimi i rregullores është garantimi i plotësimit të nevojave për financimin e AKEP për ushtrimin e veprimtarisë si organ kompetent në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, nëpërmjet pagesave për mbikëqyrjen e tregjeve respektive, që duhet të kryejnë sipërmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve postare në përputhje me përcaktimet ligjore. *Kjo rregullore është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 22, datë 3.11.2025.*

2. *Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.*

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 14, datë 25.9.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Dokumentu u publikua në faqen zyrtare të AKEP më datë 26.9.2025, ndërsa periudha e Këshillimit Publik zgjati deri më datë 27.10.2025, duke ofruar mundësinë për komente dhe propozime nga operatorët dhe palët e tjera të interesuara të tregut të komunikimeve elektronike.

Qëllimi kryesor i saj është vendosja e rregullave për mbledhjen, raportimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave statistikore dhe financiare nga operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, në mënyrë që të krijohet një kuadër i qëndrueshëm, i besueshëm dhe i harmonizuar me praktikat më të mira evropiane.

Rregullorja siguron krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të dhënash statistikore të integruar dhe periodike, e cila është e përditësuar dhe e përdorshme për qëllime rregullatore. Kjo bazë të dhënash mundëson që AKEP të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke analizuar tendencat, duke vlerësuar konkurrencën dhe identifikuar

nevojat për ndërhyrje rregullatore. Përveç kësaj, ajo siguron standardizim të të dhënave, formatet dhe afatet e raportimit, si dhe mekanizmat për verifikimin dhe korrigjimin e informacionit të dorëzuar nga operatorët, duke garantuar cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave në periudha të ndryshme.

Përmes kësaj baze të dhënash, AKEP-i mund të kryejë analizat e tregut dhe të përgatisë publikime periodike për treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të shërbimeve të komunikimeve elektronike. Të dhënat gjithashtu përdoren për plotësimin e kërkesave të institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare që monitorojnë zhvillimin e tregut, si dhe për përmbushjen e pyetësorëve apo kërkesave specifike për informacion nga aktorë të ndryshëm të sektorit. *Kjo rregullore është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 23, datë 3.11.2025.*

3. Rregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 15, datë 25.9.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik, projektregullore “Për Monitorimin e Spektrit të Frekuencave”. Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AKEP, me datë 25.9.2025, dhe periudha e Këshillimit Publik përfundoi në datën 25.10.2025. Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik, pranë AKEP-it u depozituan në rrugë elektronike komentet nga palët e interesuara.

Synimi i projektaktit është të përcaktojë procedurat dhe mekanizmat teknikë dhe administrativë për monitorimin e spektrit të frekuencave, duke forcuar mekanizmat mbikëqyrës të AKEP-it në rast të përdorimeve të paautorizuara ose interferencave të dëmshme si dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional në këtë fushë. *Rregullorja “Për monitorimin e spektrit të frekuencave” është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP, VKD nr. 26, datë 14.11.2025.*

4. Rregullore “Për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 01, datë 19.3.2025, ka miratuar dokumentin për Këshillim Publik, “Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

Dokumenti “Rregullore për Përcaktimin e Modelit të Përmbledhjes së Kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike - Dokument për Këshillim Publik”, u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 26.3.2025, dhe periudha e Këshillimit Publik përfundoi më datë 26.4.2025. Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik në AKEP u depozituan komente nga palët e interesuara, e në kuadër të këtij procesi, më datë 16.12.2025 është zhvilluar dhe një seancë diskutimi/sqarimi me palët e interesuara në lidhje me komentet e depozituara sa më sipër për *Projektregulloren për Modelin e Përmbledhjes së Kontratës*.

Dokumenti “*Projektregullore për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”, përmban modelin që të gjithë ofruesit e shërbimeve të komunikimit elektronik të disponueshme për publikun, përveç

shërbimeve të transmetimit të përdorura për ofrimin e shërbimeve makinë-makinë duhet të përdorin për dokumentin e përmbledhjes së kontratës me pajtimtarin, i cili është një dokument me informacion parakontraktor, që përmban informacion në lidhje me elementet kryesore të kontratës së pajtimit që do të lidhë pajtimtari me sipërmarrësin përkatës. Këto elemente informacioni përfshijnë ndër të tjera emrin, adresën dhe detajet e kontaktit të ofruesit të shërbimit; karakteristikat kryesore të shërbimit/paketës së shërbimeve të ofruara dhe çmimet përkatëse të tyre, përfshirë të gjitha tarifat fikse periodike ose në bazë të konsumit të njërive; kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet për rinovimin dhe përfundimin e saj, dhe penaltetet e aplikueshme për përfundimin para afatit të caktuar të kontratës; shpejtësitë minimale, normalisht të disponueshme dhe maksimale realisht të arritshme në raport me shpejtësinë e deklaruar të shërbimit të aksesit në internet nga rrjete fikse dhe shpejtësinë maksimale të vlerësuar dhe të deklaruar për rrjetet celulare (sipas përcaktimeve të nenit 178, të ligjit 54/2024 dhe udhëzimeve të AKEP për Internetin e Hapur).

Dokumenti “*Projektregullore për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*”, u hartua nga AKEP në përafrim të plotë me *Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243 të datës 17 dhjetor 2019*,³ e cila zbatohet në të gjitha vendet e BE-së. Versioni final i Rregullores për modelin e përmbledhjes së kontratës u miratua nga Këshilli Drejtues i AKEP me VKD nr.1, datë 2.2.2026. Efektet e zbatimit të “*Rregullore për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike*” nga të gjithë sipërmarrësit fillojnë më datë 1.5.2026.

5. Rregullore “Për zbatimin e portabilitetit të numrit”.

Këshilli Drejtues me vendimin nr.7, datë 12.6.2025, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “*Projektregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”. Gjatë procesit të Këshillimit Publik, nga data 18.6.2025 deri në 18.7.2025, në AKEP u depozituan komente nga palët e interesuara.

Pas përfundimit të procesit të Këshillimit AKEP-i ka zhvilluar dy takime, në datat 12.9.2025 dhe 16.12.2025, me qëllim diskutimin dhe qartësimin ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe komenteve të dërguara nga palët e interesuara, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB (Data Baza Qendrore e Portabilitetit të Numrit). Ndryshimet dhe përcaktimet e reja kryesore të propozuara nga AKEP në projektregullore, përfshijnë:

- Masa për implementimin e së drejtës së përdoruesit fundor për portimin e numrit të një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës ekzistuese

³ Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2019/2243 e datës 17 dhjetor 2019 që përcakton modelin për përmbledhjen e kontratës për t’u përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun në përputhje me Direktivën (BE) 2018/1972 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

- me operatorin/ofruesin dhënës (Sipas Rregullores 43/2016 një numër (i çaktivizuar) nuk mund të portohet pas përfundimit të kontratës/çaktivizimit të numrit);
- Masa/procedura për zbatimin e detyrimit të operatorit dhënës për rimbursim, sipas kërkesës, të konsumatorëve për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim (më parë pajtimtari i humbiste/nuk kishte të drejtë të sanksionur për të kërkuar kompensimin dhe kreditet e papërdorura me parapagim te operatori i mëparshëm në rast portimi numri);
 - Vendosjen e detyrimit për ODH celular për njoftimin me SMS të pajtimtarit në rast refuzimi të kërkesës për portim, përfshirë informimin për arsyen e refuzimit dhe veprime të mëtejshme me qëllim realizimin me sukses të portimit të numrit si saktësim të të dhënave apo pagesë të detyrimeve përkatëse kontraktuale (Në Rregulloren 43/2016 ky detyrim ishte vetëm për OM);
 - Krijimin e një statusi të ri në CRDB për kërkesat për portim numri celular me plan tarifar me paspagim, me qëllim dhënien e kohës së arsyeshme pajtimtarit për shlyerjen e detyrimeve kontraktuale me ODH (Sipas Rregullores 43/2016 kërkesat në këto refuzoheshin automatikisht nga ODH).

Ky akt ka reflektuar përcaktimet e reja të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me portabilitetin e numrit, si dhe adresimin e problematikave të evidentuara në vitet e fundit në lidhje me refuzimet e kërkesave për portim të numrit celular. Ndryshimet në rregulloren e re, reflektojnë përcaktimet e reja të ligjit nr. 54/2024, që përfshijnë ndër të tjera, të drejtën e pajtimtarit/përdoruesit fundor për portimin e numrit të një operatori tjetër deri në një muaj nga data e përfundimit të kontratës ekzistuese me operatorin aktual/dhënës, si dhe detyrimet e operatorit dhënës për rimbursim, sipas kërkesës, të konsumatorëve për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim. Ky akt është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2, datë 2.2.2026, ndërsa afati për implementimin teknik nga sipërmarrësit të disa prej përcaktimeve të reja të rregullores (që kërkojnë ndërhyrje në sistemet e brendshme të operatorëve dhe/ose sinkronizim të proceseve me CRDB) është data 1.8.2026.

6. Rregullore “Për analizën e tregut”

Këshilli Drejtues me vendimin nr. 27, datë 14.11.2025, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit “Projektregullore për analizën e tregut”, së bashku me Aneksin I, e në kuadër të procesit të Këshillimit Publik; janë publikuar në faqen zyrtare të AKEP për një periudhë 30-ditore, nga data 17.11.2025 deri më datë 16.12.2025.

Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik, u depozituan në AKEP komente nga palë të interesuara, konkretisht nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), përcjellë me shkresën nr.1030, prot., datë 26.11.2025, si dhe nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a, përcjellë me shkresën nr.2499, prot., datë 16.12.2025.

Ky akt synon të krijojë një kuadër të qëndrueshëm rregullator për tregjet e komunikimeve elektronike dhe të monitorojë zhvillimin e këtyre tregjeve për t'u siguruar që ato veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi, nxitjen e konkurrencës dhe përfitimet konsumatore.

Kjo rregullore përcakton mënyrën e zbatimit të procesit të analizës së tregut, të përkufizimit të tregjeve përkatëse, identifikimin e sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) dhe vendosjen e masave rregullatore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Kjo rregullore mban në konsideratë ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Rekomandimet e Komisionit Evropian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit *ex-ante* (EU) 2020/2245, Udhëzuesin e Komisionit Evropian mbi analizat e tregut, si dhe vlerësimet e fuqisë së ndjeshme në treg sipas rregullores së BE-së për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (C/2018/2374). Ky akt është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 7, datë 13.3.2026.

7. Rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 24, datë 3.11.2025, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit Projektregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Procesi i Këshillimit Publik për projektregulloren “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, u zhvillua për një periudhë 30-ditore, nga data 4.11.2025 deri më 3.12.2025. Gjatë këtij procesi, pranë AKEP-it janë depozituar komente nga palë të interesuara, e në kuadër të procesit të Këshillimit Publik me qëllim diskutimin dhe qartësimin përcaktimeve të reja të projektregullores “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, AKEP ka realizuar një takim me përfaqësues teknikë të grupeve të interesit.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave teknike dhe organizative që sipërmarrësit e komunikimeve elektronike publike duhet të ndërmarrin për të garantuar sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve të tyre, parandalimin e incidenteve të sigurisë, si dhe raportimin e tyre pranë AKEP. Rregullorja përcakton detyrimet për operatorët, mënyrën e raportimit të incidenteve, kriteret e vlerësimit të impaktit, si dhe masat organizative dhe teknike që duhet të zbatohen për mbrojtjen kibernetike. Kjo rregullore synon të krijojë një standard të unifikuar për të gjithë operatorët, në përputhje me praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar mbrojtjen e përdoruesve dhe funksionimin e qëndrueshëm të rrjeteve kombëtare. Akti është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 8, datë 13.3.2026.

8. Rregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 31, datë 22.12.2025, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit projektregullore, “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”. Ky akt përbën një nga aktet kryesore rregullatore që përcakton kushtet e hyrjes dhe operimit në tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri. Procesi i Këshillimit Publik për projektregulloren, “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, u zhvillua për një periudhë 45 ditore, nga data 23.12.2025 deri më 4.2.2026, periudhë gjatë së cilës pranë AKEP janë depozituar komente nga palë të interesuara.

Projektakti “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”, merr në konsideratë rekomandimet e BEREC, parashikimet e akteve të tjera ligjore e nënligjore që prekin apo ndërthuren me fushën e komunikimeve elektronike, lidhur me formën, përmbajtjen e njoftimit, dokumentacioni mbështetës, konfirmimi i regjistrimit të njoftimit, etj.

Nëpërmjet këtij akti përcaktohen rregullat dhe procedurat për hyrjen dhe operimin në tregun e komunikimeve elektronike; saktësohen të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime; vendosen kërkesa ligjore, teknike dhe financiare të standardizuara për të gjithë operatorët; forcohen mekanizmat mbikëqyrës dhe instrumentet e autoritetit për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe mbrojtjen e të dhënave të përdoruesve.

Rregullorja synon të krijojë një mjedis rregullator të qëndrueshëm, transparent dhe të parashikueshëm, duke kontribuar në zhvillimin e një tregu konkurrues dhe funksional të komunikimeve elektronike.

Në mënyrë të veçantë, ajo mundëson hyrjen në treg të formave të reja të ofrimit të shërbimeve, vendos kushte të barabarta për të gjithë sipërmarrësit që operojnë ose synojnë të operojnë në këtë treg si dhe synon rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e përdoruesve fundorë.

Në zbatim të këtij akti, subjektet që aktualisht janë të regjistruara në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe subjektet që synojnë të hyjnë në treg, duhet të paraqesin një njoftim pranë AKEP, në përputhje me kërkesat dhe procedurat e reja të përcaktuara.

Zbatimi i kësaj rregulloreje pritet të sjellë rritje të konkurrencës në sektor, përmirësim të cilësisë së shërbimeve për përdoruesit fundorë, rritje të sigurisë juridike dhe rregullatore duke qenë se rishikohen disa kërkesa për hyrjen në treg për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, përafrim me standardet e BE-së. Akti është miratuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 10, datë 31.3.2026.

Gjithashtu, AKEP ka miratuar edhe disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 22, datë 24.6.2011, “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kabllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrbane të komunikimeve elektronike”, të ndryshuar” (miratuar me

VKD nr. 9, datë 23.7.2025) si dhe ka vendosur miratimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, (miratuar me VKD nr. 13, datë 27.8.2025);

Ndërkohë, ka përfunduar procesi i Këshillimit Publik dhe është në proces miratimi përfundimtar projektregullorja e mëposhtme:

1. *Projektregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, miratuar për Këshillim Publik me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 28, datë 14.11.2025; pas finalizimit të procedurës së Këshillimit Publik dhe vlerësimit të komenteve të palëve pritet miratimi i aktit nga AKEP.*

Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 28, datë 14.11.2025, ka miratuar nxjerrjen në Këshillim Publik të dokumentit projektregullore “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

Procesi i Këshillimit Publik për projektregulloren “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, u zhvillua për një periudhë 30-ditore, nga data 17.11.2025 deri më 16.12.2025, dhe gjatë këtij procesi pranë AKEP janë depozituar komente nga palë të interesuara.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave të veprimtarisë inspektuese sipas legjislacionit për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në kushtet specifike teknike dhe metodike të fushës ku ushtrohet veprimtaria, të parashikuara në ligjin nr. 54/2024, dhe akteve nënligjore dhe rregullatore të nxjerrë në zbatim të tij. Dokumenti standardizon procedurat e veprimtarisë inspektuese, vendimmarrjes dhe ankimit administrativ, duke siguruar respektimin e parimeve të transparencës, pavarësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të subjekteve të inspektimit. Rregullorja është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe garanton mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që inspektohen, në mënyrë që dënimi administrativ të jetë proporcional me shkeljen e konstatuar, dhe të sigurohet një trajtim i drejtë dhe i barabartë për subjektet e inspektimit dhe njëkohësisht të shmangë rreziqet që mund t’u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë të parashikuara me ligj.

2.2 Ecuria e tregut të Komunikimeve Elektronike 2025

Tregu i Komunikimeve Elektronike 2025

Gjatë vitit 2025, tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka vijuar të luajë një rol thelbësor në lehtësimin e komunikimit midis përdoruesve fundorë, institucioneve qeveritare, bizneseve dhe palëve të tjera të interesuara. Ky treg paraqet një strukturë të ndarë kryesisht në dy segmente: rrjetet celulare dhe rrjetet fikse, të cilat kanë ndikuar dhe janë ndikuar nga zhvillimet teknologjike, konsolidimi i operatorëve dhe rritja e kërkesës për shërbime *broadband* dhe komunikime digjitale. Në vitet e fundit ky treg ka evoluar drejt një modeli më të integruar, ku operatorët kryesorë ofrojnë shërbime të konvergjuara celulare dhe fikse, duke reflektuar trendet ndërkombëtare të teknologjive dhe ofertave të integruara.

Segmenti i rrjeteve celulare është karakterizuar nga një strukturë e përqendruar, ku operojnë dy operatorë kryesorë me rrjet të integruar, One Albania sh.a., dhe Vodafone Albania sh.a. Kjo ka rezultuar në një strukturë duopol, ku roli i monitorimit rregullator është bërë më i rëndësishëm për të garantuar konkurrencë efektive dhe për të mbrojtur interesat e përdoruesve fundorë. Gjatë periudhës 2023 - 2025 tregu celular ka shfaqur një rritje të vazhdueshme të përdorimit të shërbimeve të të dhënave celulare, duke reflektuar një transformim gradual të strukturës së konsumit nga shërbimet tradicionale të zërit dhe SMS-ve drejt shërbimeve të të dhënave (internet). Ky zhvillim lidhet ngushtë me rritjen e penetrimit të telefonave inteligjentë, përmirësimin e kapaciteteve të rrjeteve dhe zgjerimin e ofertave të paketave të integruara. Operatorët kanë vazhduar të investojnë në modernizimin dhe zgjerimin e rrjeteve 4G dhe 5G, si dhe në përgatitjen e infrastrukturës për teknologjitë e ardhshme, duke mbështetur kërkesën në rritje për shërbime *broadband* celulare dhe garantuar cilësinë e shërbimeve për përdoruesit.

AKEP monitoron tregun celular duke analizuar tregues të ndryshëm si numri i pajtimtarëve dhe kartave SIM, volumi i trafikut të zërit dhe të dhënave, të ardhurat e operatorëve, mbulimi dhe cilësia e shërbimit, struktura e ofertave dhe niveli i çmimeve, me qëllim evidentimin e tendencave të zhvillimit, identifikimin e problematikave dhe ndërmarrjen e masave rregullatore për garantimin e funksionimit të drejtë dhe transparent të tregut.

Segmenti i rrjeteve fikse ka kaluar gjithashtu një proces transformimi strukturor, ku roli i shërbimeve *broadband* është rritur në raport me telefoninë tradicionale fikse. Gjatë periudhës 2020 – 2025, tregu ka reflektuar ndryshime të ndjeshme në pronësi, konsolidim të operatorëve dhe zhvillime teknologjike, të cilat kanë ndikuar në mënyrën e ofrimit të shërbimeve për përdoruesit fundorë. Një nga zhvillimet kyçe ka qenë blerja e operatorit ABCom nga Vodafone Albania në vitin 2020, e cila ka kontribuar në konsolidimin e një prej operatorëve kryesorë të tregut fikse dhe rritjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve të mëdhenj. Transformimet në strukturën e Albtelecom, përfshirë përfshirjen e grupit 4iG, kanë sjellë gjithashtu ndryshime të rëndësishme në organizimin e tregut dhe strategjitë e operatorëve. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ka qenë konvergjenca e tregjeve fikse dhe celulare që nga 1 janari 2023, ku operatorët kryesorë ofrojnë portofol të integruar shërbimesh për abonentët individualë dhe biznes, duke përfshirë internet *broadband*, televizion dhe shërbime komunikimi.

Në këtë kontekst, përdorimi i rrjeteve fikse është orientuar gjithnjë e më shumë drejt ofrimit të shërbimeve *broadband* me kapacitet të lartë, ndërsa rëndësia e telefonisë tradicionale fikse ka ardhur gradualisht në rënie. Operatorët me infrastrukturë të avancuar rrjetesh fikse vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shërbimeve *broadband* dhe në mbështetjen e transformimit digjital të ekonomisë dhe shoqërisë.

Ndryshimet strukturore dhe zhvillimet teknologjike në të dy segmentet, te celularet dhe fikset, nënvizojnë nevojën për një rol aktiv dhe efektiv rregullator. Kjo kërkon një balancim të kujdesshëm midis kërkesës dhe ofertës, mbështetjen e zhvillimeve të reja, garantimin e konkurrencës efektive dhe ruajtjen e cilësisë së shërbimeve për përdoruesit fundorë. Investimet e vazhdueshme të operatorëve në kapacitete teknologjike dhe sigurinë e rrjeteve mbeten thelbësore për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe për të adresuar kërkesat gjithnjë në rritje që sjellin inovacioni dhe përparimi teknologjik.

2.2.1 Tregues të rrjetit dhe shërbimeve celulare

Në tabelën në vijim paraqiten disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare përgjatë periudhës 2021 – 2025, bashkë me normën e ndryshimit vjetor të dy viteve të fundit.

Tabela 3: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2021-2025

Viti	2021	2022	2023	2024	2025	Ndryshimi 2025/2024
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:						
– <i>sipas kartave SIM</i>	3,484,158	3,771,419	3,863,435	3,399,173	3,147,188	-7.41%
– <i>Përdorues aktivë</i>	2,635,466	2,782,226	2,614,764	2,488,380	2,480,153	-0.33%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:						
– <i>Totali</i>	2,789,023	2,794,443	2,796,271	2,793,308	2,083,621	-25.41%
– <i>Përdorues aktivë</i>	2,056,444	2,140,180	2,082,525	2,091,266	2,083,621	-0.37%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	5,602,663,590	5,006,718,174	4,286,805,307	4,080,504,358	4,066,591,687	-0.34%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	2,501,744,337	2,159,758,675	1,649,113,325	1,628,806,950	1,483,636,393	-8.91%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	144,033,382	119,836,468	101,253,187	84,957,388	71,629,263	-15.69%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	555,701,627	553,607,871	412,566,297	384,719,599	366,515,526	-4.73%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	155,585,664	184,480,857	193,620,759	223,432,669	259,598,178	16.19%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Gjatë vitit 2025, tregu celular në Shqipëri paraqitet i konsoliduar dhe në fazë maturimi, si pasojë edhe e bashkimit të operatorëve One Albania dhe Albtelecom. Ky zhvillim ka çuar në krijimin e një strukture tregu të përqendruar me dy operatorë, ku konkurrenca zhvillohet kryesisht përmes ofertave tarifore, paketave të integruara, cilësisë së rrjetit dhe shërbimeve *broadband* celulare. Pjesët e tregut pasqyrojnë këtë balancë, ku Vodafone Albania zotëron rreth 49.8% të përdoruesve aktivë, ndërsa One Albania rreth 50.2%, duke reflektuar një nivel të lartë përqendrimi.

Numri total i kartave SIM ka vijuar një trend rënës gjatë viteve të fundit, duke zbritur nga rreth 3.86 milionë në vitin 2023, në 3.40 milionë në vitin 2024 dhe në rreth 3.15 milionë në vitin 2025. Kjo rënie lidhet me maturimin e tregut, konsolidimin e bazës së përdoruesve dhe reduktimin e përdorimit të shumëfishtë të SIM-ve nga i njëjti përdorues. Megjithatë, në raport me popullsinë, niveli i penetrimit mbetet i lartë, me rreth 1.33 karta SIM për banor, mbi mesataren rajonale dhe globale. Ndërkohë, numri i përdoruesve aktivë është stabilizuar në rreth 2.5 milionë, duke treguar një qëndrueshmëri në përdorimin e shërbimeve celulare.

Struktura e pajtimtarëve ka vijuar të ndryshojë, duke reflektuar një zhvendosje graduale nga përdoruesit me parapagim drejt kontratave me paspagim. Në vitin 2025, përdoruesit me parapagim përbëjnë rreth 53% të totalit, nga 58% në vitin 2024, ndërsa përdoruesit me kontrata paspagimi janë rritur në 47%, nga 42% një vit më parë. Ky zhvillim është në linjë me trendet në vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian dhe tregon një orientim drejt shërbimeve më të qëndrueshme dhe paketave të integruara.

Në aspektin e përdorimit të shërbimeve, trafiku i të dhënave celulare ka shënuar rritje të ndjeshme, mbi 16% krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar rritjen e përdorimit të internetit për komunikim, argëtim dhe shërbime digjitale. Në të kundërt, përdorimi i shërbimeve tradicionale si thirrjet zanore dhe SMS ka pësuar një rënie të lehtë, duke treguar një transformim të qartë drejt konsumit të shërbimeve *broadband* dhe aplikacioneve të bazuara në internet.

Në tërësi, tregu celular shqiptar po kalon nga një fazë zgjerimi, drejt një faze stabilizimi dhe transformimi, ku roli kryesor po kalon nga shërbimet tradicionale, drejt internetit mobil dhe paketave të integruara, duke reflektuar ndryshimet në sjelljen e përdoruesve dhe zhvillimet teknologjike.

Akresi *broadband* në rrjetet celulare 3G/4G/5G

Numri i pajtimtarëve aktivë që kanë përdorur shërbimin internet celular në fund të vitit 2025 rezultoi rreth 2.1 milionë pajtimtarë, pothuajse në të njëjtat nivele krahasuar me vitin pararendës.

Tabela 4: Numri i pajtimtarëve aktivë me akses broadband 3G/4G (2021-2025)

Viti	One Albania	Vodafone Albania	Albtelecom	Total	Norma e penetrimit për popullsi
2021	825,707	925,967	304,770	2,056,444	73%
2022	836,931	1,033,888	269,361	2,140,180	77%
2023	916,755	1,165,770		2,082,525	75%
2024	893,505	1,197,761		2,091,266	87%
2025	906,924	1,170,115		2,077,039	88%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Penetrimi për popullsi i përdoruesve aktivë celularë të aksesit *broadband* nga rrjetet 3G/4G/5G në fund të vitit 2025⁴ arriti në 88%, tregues ky në rritje krahasuar me vitin 2024 me rreth 1pp. Ky trend pozitiv tregon se shërbimet e internetit celular janë bërë pjesë integrale e jetës së përditshme të përdoruesve, duke e konsoliduar internetin celular si një mjet kryesor të komunikimit dhe konsumit të informacionit digjital. Rritja e penetrimit reflekton gjithashtu përmirësimin e kapaciteteve të rrjeteve, zgjerimin e ofertave të paketave integruese dhe adoptimin e smartphone-ve dhe pajisjeve të tjera të lidhura në rrjet.

Shpërndarja sipas operatorëve tregon se Vodafone Albania vazhdon të ketë një pjesë të madhe të përdoruesve të *broadband* celular, me rreth 1.17 milionë pajtimtarë, ndërsa One Albania ka rreth 906 mijë pajtimtarë aktivë, duke reflektuar balancën relativisht të qëndrueshme të tregut pas integritimit të rrjeteve dhe bazës së klientëve të Albtelecom.

Ndryshimi gradual nga thirrjet tradicionale dhe SMS, drejt përdorimit të të dhënave, nënvizon rëndësinë e investimeve të operatorëve në infrastrukturën 3G/4G/5G dhe nevojën e vazhdueshme për të siguruar cilësi dhe kapacitet të mjaftueshëm. Për më tepër, niveli i lartë i penetrimit sugjeron se konsumatorët janë tashmë të gatshëm të adoptojnë shërbime të avancuara të internetit celulare, duke krijuar një bazë solide për zhvillimin e aplikacioneve digjitale, shërbimeve fintech, edukimit *online* dhe konsumit të mediave digjitale.


Trafiku telefonik dalës

Volumi i thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, rezulton se gjatë vitit 2025, rreth 39% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë ‘off-

⁴ Popullsia sipas INSTAT në 1 janar 2025 ishte 2,363,314 banorë.

net’ dhe rreth 59% brenda rrjetit ‘on-net’, duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin e kaluar për të dy treguesit

Figura 1: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2021-2025



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP

Siç vërehet nga të dhënat e grafikut sa më sipër, edhe përgjatë vitit 2025 ka vijuar një rënie e lehtë e volumit total të thirrjeve dalëse, duke mbetur në të njëjtat nivele krahasuar me periudhën pararendëse.

Pjesët e tregut e dy sipërmarrësve të ofrimit të shërbimeve celulare

Në lidhje me pjesët e tregut të operatorëve celularë, gjatë vitit 2025, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për disa nga treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike celulare. Ndërkohë, sipërmarrësi One Albania ka shënuar gjithashtu rritje në disa tregues gjatë vitit 2025.

Konkretisht, pjesët e tregut e të dy sipërmarrësve për vitin 2025, për treguesit kryesorë të tregut celular, janë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela 5: Pjesët e tregut të operatorëve celularë (2025)

	One Albania	Vodafone Albania
Përdoruesit e SIM card aktive	52%	48%
Përdoruesi aktivë të shërbimeve celulare	50%	50%
Përdoruesit aktivë të internetit (<i>broadband</i>)	44%	56%
Thirrje dalëse	44%	56%
SMS dalëse	39%	61%
Volumi i të dhënave (internetit)	46%	54%
Të ardhurat totale dhe nga shërbimet me pakicë	42%	58%

Gjatë vitit 2025, tregu celular në Shqipëri ka ruajtur një strukturë relativisht të qëndrueshme në drejtim të trafikut të thirrjeve, ku rreth 59% e tyre realizohen brenda rrjetit të të njëjtit operator (on-net) dhe rreth 39% drejt rrjeteve të tjera kombëtare (off-net). Ky raport mbetet i pandryshuar krahasuar me vitin 2024 dhe reflekton stabilitet në sjelljen e përdoruesve, megjithëse volumi total i thirrjeve ka shënuar një rënie të lehtë, si pasojë e rritjes së përdorimit të shërbimeve të bazuara në internet.

Në aspektin e konkurrencës, tregu paraqitet i balancuar ndërmjet dy operatorëve kryesorë. One Albania dhe Vodafone Albania ndajnë në mënyrë pothuajse të barabartë përdoruesit aktivë (nga 50% secili), ndërsa në tregues të tjerë vërehen diferenca. One Albania ka një epërsi të vogël në numrin e SIM-ve aktive, ndërsa Vodafone mban avantazh në përdorimin e *broadband*-it celular, trafikun e thirrjeve, SMS-ve dhe volumet e të dhënave, si dhe në të ardhurat totale, ku zotëron rreth 58% të tregut kundrejt 42% të One Albania. Një ndryshim i rëndësishëm gjatë këtij viti lidhet me mënyrën e konsumit të shërbimeve. Përdoruesit me kontrata *postpaid* gjenerojnë pjesën më të madhe të trafikut zanor, me rreth 3.2 miliardë minuta thirrje dalëse, krahasuar me rreth 0.89 miliardë minuta nga përdoruesit *prepaid*. Kjo tregon një orientim të qartë drejt paketave të integruara dhe shërbimeve më të strukturuar.

Vihet re një rënie e vazhdueshme e shërbimeve tradicionale. Thirrjet dalëse kanë rënë nga rreth 5 miliardë minuta në vitin 2022, në 4.09 miliardë minuta në vitin 2025, ndërsa SMS-të nga 553 milionë, në 366 milionë. Në të kundërt, trafiku i të dhënave ka shënuar rritje të fortë, duke arritur në rreth 260 milionë GB, si rezultat i përdorimit në rritje të aplikacioneve digjitale, rrjeteve sociale dhe platformave video.

Ky transformim reflektohet edhe në shërbimet e interkoneksionit. Trafiku i terminimit ka rënë ndjeshëm, nga 2.28 miliardë minuta në vitin 2022, në 1.56 miliardë minuta në vitin 2025, ku pjesa më e madhe, rreth 94%, vijon të jetë trafik kombëtar. Dy operatorët kryesorë ndajnë në mënyrë të balancuar terminimin kombëtar, ndërsa terminimi ndërkombëtar ka pësuar rënie për

shkak të zhvendosjes së komunikimeve drejt platformave OTT. Nga ana ekonomike, të ardhurat totale të rrjeteve celulare arritën rreth 28.95 miliardë lekë në vitin 2025, nga të cilat vetëm rreth 17% vijnë nga shërbimet me shumicë. Kjo tregon se, ndonëse interkoneksioni mbetet i rëndësishëm për funksionimin e tregut, pesha kryesore e të ardhurave tashmë vjen nga shërbimet *broadband* dhe përdorimi i të dhënave.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vijim është dhënë një tabelë me të dhëna për përdorimin mesatar mujor të thirrjeve telefonike dhe mesazheve SMS për përdorues celularë në 2021 deri në 2025, sipas treguesit të përdoruesve aktiv. Përdorimi mesatar mujor për përdorues është llogaritur sipas thirrjeve dalëse (thirrje që gjenerohen nga një përdorues) dhe thirrjeve hyrëse (thirrjet e marra nga një përdorues), të matura në minuta. Njëkohësisht tabela përmban dhe përdorimin mesatar mujor për SMS-të dalëse, si dhe për përdorues aktivë *broadband*.

Tabela 6: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2021	2022	2023	2024	2025	Ndryshimi 2025/2024
Thirrje dalëse	178	154	132	133	136	2%
Thirrje të marra	182	157	135	138	134	-3%
MOU	360	311	268	271	270	0%
SMS Dalëse	18	17	13	13	12	-8%
Trafik Data (GB)	6.39	7.30	7.64	8.92	10.38	16%

Burimi: Të dhëna të ardhura nga operatorët, përpunimi AKEP.

Bazuar në të dhënat e vitit 2025, një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht rreth 136 minuta thirrje dalëse në muaj, ka dërguar rreth 12 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 10.38 GB internet *broadband*. Krahësuar me vitin e mëparshëm, përdorimi i thirrjeve ka shënuar një rritje të lehtë prej rreth 2%, ndërsa trafiku i të dhënave është rritur ndjeshëm me rreth 16%.

Ky zhvillim tregon një transformim të qartë në mënyrën e përdorimit të shërbimeve celulare. Ndërsa thirrjet zanore dhe SMS-të mbeten ende pjesë e rëndësishme e komunikimit, pesha kryesore po kalon gjithnjë e më shumë te përdorimi i internetit. Përdoruesit po orientohen drejt shërbimeve digjitale, aplikacioneve të komunikimit dhe platformave video, ndërkohë që rritja e kapaciteteve të rrjeteve dhe përdorimi i pajisjeve më të avancuara po nxit më tej këtë tendencë.

Tarifimi i produkteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe transparenca e tyre

AKEP monitoron në mënyrë të vazhdueshme ndryshimet në planet tarifore dhe siguron transparencë për konsumatorët duke publikuar informacion të krahasueshëm mbi ofertat celulare dhe tarifat *roaming*. Gjatë vitit 2025, tregu i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka ruajtur një strukturë relativisht të qëndrueshme të planeve tarifore, me dallime të qarta ndërmjet segmenteve *prepaid* dhe *postpaid*.

Planet *prepaid* mbeten zgjedhja kryesore për përdoruesit me konsum të ulët dhe mesatar, duke ofruar paketa bazike me çmime që variojnë nga rreth 600 deri në 1,600 lekë. Në të njëjtën kohë, tarifat jashtë paketave (Pay As You Go) mbeten relativisht të larta, çka i orienton përdoruesit drejt konsumit të paketave të strukturuar.

Segmenti *postpaid* paraqitet më i zhvilluar dhe më konkurrues, me tarifa më të favorshme për njësi konsumi dhe oferta të lidhura me kontrata afatmesme ose afatgjata. Gjatë vitit 2025 janë prezantuar edhe paketa të avancuara, përfshirë ofertat për përdorim 5G dhe paketa të dedikuara për turistët, duke reflektuar rritjen e kërkesës për internet dhe shërbime me kapacitet të lartë. Ky segment kontribuon gjithashtu në stabilitetin e të ardhurave të operatorëve dhe në rritjen e përdorimit të të dhënave.

Zhvillimet e tregut, përfshirë konsolidimin e operatorëve, kanë sjellë një reduktim të numrit dhe larmishmërisë së paketave, veçanërisht në segmentin *prepaid*. Megjithatë, shumica e ofertave vazhdojnë të jenë të integruara, duke kombinuar shërbimet e telefonisë, SMS-ve dhe internetit, me periudha vlefshmërie që variojnë nga ditore deri në mujore. Në krahasim me rajonin, analiza e përballueshmërisë, bazuar në metodologjitë ndërkombëtare, tregon se përdoruesit shqiptarë paguajnë relativisht më shumë për shërbimet bazike dhe mesatare, ndërsa ofertat për përdorim të lartë janë më konkurruese.

Në tregun e rrjeteve fikse, oferta vijon të përqendrohet kryesisht në shërbimet *broadband* dhe paketat e integruara që kombinojnë internetin, televizionin dhe telefoninë. *Broadband*-i mbetet komponenti kryesor i përdorimit, ndërsa telefonia fikse ka një rol më të kufizuar, kryesisht në segmentin e biznesit. Tregu karakterizohet nga një nivel relativisht i mirë konkurrence ndërmjet operatorëve kryesorë dhe ofruesve alternativë, duke kontribuar në rritjen e zgjedhjeve për konsumatorët dhe në përmirësimin gradual të cilësisë së shërbimeve.

Mbulimi me rrjetet e teknologjisë 3G/4G dhe 5G

Bazuar në raportimet e operatorit One Albania rezulton se mbulimi i popullsisë me rrjet 3G në rang kombëtar ka arritur në nivelin rreth 99%. Ndërkohë operatori Vodafone Albania ka vijuar, gjatë vitit 2025, mbylljen e shërbimeve në teknologjië 3G dhe ka njoftuar se ky proces do të përfundojë brenda 6 muajve të parë të vitit 2026. Për sa i përket mbulimit të territorit dhe popullsisë me rrjet LTE (4G), bazuar në raportimet e kryera për vitin 2025 rezulton se, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., ka mbulimin më të gjerë me këtë teknologji, duke arritur

nivelin e rreth 97% të mbulimit të territorit me rrjet 4G dhe rreth 100% të mbulimit të popullsisë. Ndërsa, sipërmarrësi One Albania sh.a., ka mbulimin të territorit me rrjet 4G rreth 96% dhe mbulim të popullsisë rreth 99%.

Përsa i përket rrjetit 5G, bazuar në raportimet e operatorëve mbulimi i popullsisë me 5G arrin në nivele mbi 60% për një operator dhe mbi 70% për operatorin tjetër, ndërsa mbulimi territorial, deri në 36%.

2.2.2 Shërbimet dhe rrjetet fikse

Në vitin 2025, tregu i komunikimeve elektronike të ofruara përmes rrjeteve fikse në Shqipëri ka vijuar të evoluojë drejt shërbimeve *broadband* dhe paketave të integruara, ndërsa rëndësia relative e telefonisë fikse tradicionale ka ardhur në rënie. Nga regjistri përkatës i autorizimeve në AKEP, rezulton se në fund të vitit 2025, numri i sipërmarrësve të autorizuar për rrjete dhe shërbime fikse arrin në 281 të cilët ofrojnë shërbime interneti, telefoni fikse dhe paketë të integruar shërbimesh që mund të përfshijnë internet, IPTV, telefoni fikse dhe konkretisht sipas llojeve të shërbimeve të autorizuara, klasifikimi i tyre është si më poshtë:

- 30 sipërmarrës telefoni fikse;
- 3 sipërmarrës kartë me parapagim;
- 247 sipërmarrës që ofrojnë shërbim interneti;
- 42 sipërmarrës që ofrojnë transmetim të dhënash;
- 18 sipërmarrës që ofrojnë linja me qira.

Pjesa më e madhe e operatorëve janë të vegjël dhe me prani të kufizuar në zona urbane apo rurale pranë qendrave urbane, ndërsa pjesa kryesore e tregut *broadband* përqendrohet te disa operatorë kryesorë si One Albania, Vodafone Albania, Abissnet, ASC, Digicom dhe Nisatel, të cilët përfaqësojnë rreth 67% të tregut, ndërsa pjesa tjetër ndahet mes operatorëve lokalë dhe ISP-ve më të vegjël.

Tregu ka pësuar ndryshime të rëndësishme gjatë viteve të fundit, kryesisht për shkak të përqendrimeve dhe konvergjencës së shërbimeve fikse dhe celulare. Përftimi i ABCom nga Vodafone Albania në vitin 2020 rriti praninë e operatorit në tregun *broadband*, ndërsa ndryshimet në pronësinë e Albtelcom përmes përqendrimit nga kompania 4iG Nyrt dhe Albania Telecom Invest, si dhe kalimi gradual i operatorëve kryesorë drejt ofrimit të shërbimeve të integruara fikse dhe celulare, kanë reflektuar trendin e konvergjencës së shërbimeve dhe kanë ndikuar në përcaktimin e operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg.


Telefonia fikse

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2025 ishte rreth 149 mijë, duke shënuar një rënie prej rreth 10% krahasuar me vitin 2024. Si rrjedhojë, norma e penetrimit arriti në rreth 6%, dukshëm më e ulët se mesatarja evropiane (rreth 27%) dhe ajo botërore (rreth 10%), duke reflektuar tkurrjen graduale të këtij segmenti në treg.

Në fund të vitit 2025, numri total i linjave fikse ishte 149,056 nga të cilat, pjesa më e madhe, rreth 118 mijë, i përkisnin përdoruesve familjarë, ndërsa rreth 31 mijë përdoruesve biznes. Përdorimi i telefonisë fikse për thirrje drejt rrjeteve celulare mbetet më i lartë se drejt rrjeteve fikse, ndërsa përhapja e trafikut VoIP tregon orientimin e përdoruesve drejt teknologjive IP.

Në të njëjtën kohë, shërbimet e internetit përmes rrjeteve fikse kanë vijuar të rriten, si në numër pajtimtarësh, ashtu edhe në shpejtësitë e ofruara. Ky zhvillim konfirmon transformimin e rrjeteve fikse nga një platformë tradicionale e telefonisë zanore, në një infrastrukturë kryesore për akses *broadband*, në përputhje me trendet globale dhe kërkesën në rritje për shërbime të integruara.

Figura 2: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të Telefonisë Fikse, 2021-2025



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 55 % e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun Tiranë. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe. Rënia e përdorimit të shërbimeve të telefonisë fikse vihet re edhe në reduktimin e sasisë totale të thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse.


Akresi *broadband* nga rrjete fikse

Numri i pajtimtarëve

Në ndryshim nga shërbimet e telefonisë nga rrjetet fikse, numri i pajtimtarëve të shërbimit të aksesit *broadband* nga rrjete fikse kanë shënuar rritje të vazhdueshme, duke u bërë një mbështetje mjaft e rëndësishme në lehtësimin e komunikimit për përdoruesit fundor.

Në fund të vitit 2025, numri i pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fikse raportohet në mbi 733 mijë, e thënë ndryshe rreth 6% më shumë se vitit i kaluar. Norma e penetrimit të aksesit *broadband* nga rrjetet fikse për familje në fund të vitit 2025 arriti në 97%, duke shënuar rritje me rreth 5pp krahasuar me periudhën pararendëse.

Figura 3: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve, 2021-2025



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët dhe INSTAT.

Bazuar në të dhënat rajonale në 2025 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit për popullsi janë Tirana, Vlora, Shkodra dhe Durrësi. Përsa i përket penetrimit sipas numrit të familjeve në qarqe, normën më të lartë e ka qarku i Tiranës dhe Vlorës dhe normën më të ulët qarku i Lezhës.


Bazuar në të dhënat e raportuara, për vitin 2025 operatorët me pjesët më të mëdha të tregut *broadband* fiks për sa i përket treguesit të numrit të pajtimtarëve paraqiten si më poshtë vijon:

- Vodafone Albania zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- One Albania zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- A.S.C zotëron rreth 8% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 6% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 5% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me rreth 34% të tregut.

Paketat e integruara (Bundles)

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2025 arriti në rreth 295 mijë, rreth 2% më pak se në vitin 2024.

Figura 4: Numri i pajtimtarëve me akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhënat e ardhura nga operatorët.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën më sipër, vërehet se përdorimi i shërbimeve të integruara (internet dhe TV) është më i përdoruri ndër tre klasifikimet, i shoqëruar me një rritje prej rreth 5% krahasuar me vitin 2024.

Përgjatë viteve të fundit, nga dy sipërmarrësit që ofrojnë shërbime në tregjet fikse dhe atë celulare, është vënë re promovimi i ofrimit të paketave që përmbajnë shërbime të kombinuara të rrjeteve fikse dhe celulare, me përmbajtje shërbim interneti fiks, njësi komunikimi celulare (internet, minuta, sms), si edhe kanale TV.


Lidhjet internet fiks sipas shpejtësive

Rritja e vullshme e përdorimit të marrjes së shërbimeve nëpërmjet rrjetit të internetit, ka sjellë gjithnjë e më shumë nevojën për lidhje që mundësojnë transmetim të dhënash *broadband* me shpejtësi dhe cilësi të lartë. Të dhënat e raportuara nga sipërmarrësit e ofrimit të rrjeteve fikse tregojnë se, përveç rritjes së numrit të pajtimtarëve, zhvillim mjaft pozitiv ka pasur edhe në drejtim të zhvendosjes drejt shpejtësive më të larta, duke i ofruar këto shërbime me rrjet teknologjik të aftë që mundësojnë transmetim me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë (kryesisht nëpërmjet fibrave).

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara

në planin kombëtar të *broadband* për infrastrukturë digjitale *broadband* të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.

Figura 5: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses *broadband* fiks sipas shpejtësisë, 2021-2025




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët dhe përpunuar në AKEP.

Nga të dhënat e paraqitura në grafikun sa më sipër, vihet re se në fund të vitit 2025 numri i pajtimtarëve që kanë akses me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbën rreth 89% të totalit të numrit të pajtimtarëve me akses *broadband* nga rrjetet fiks, duke shënuar rritje me periudhën pararendëse ku pajtimtarët me shpejtësi më shumë se 30 Mbps përbënin rreth 84% të totalit. Ndërkaq, numri i pajtimtarëve të shërbimeve *broadband* nga rrjetet fikse me akses mbi 100 Mbps është 387,184 (rreth 54% e pajtimtarëve) duke shënuar rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me vitin pararendës (rreth 42% të totalit të pajtimtarëve për 2024).

Bazuar në të dhënat e raportuar lidhur me teknologjinë e ofrimit të shërbimit *broadband* fikse vërehet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë këto shërbime po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet tradicionale me DSL (dhe kombinimet me të) drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB, të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se DSL.

Figura 6: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë në Shqipëri, 2025



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Nga të dhënat e raportuara rezulton se teknologjia kryesore mbi të cilën mundësohet akses internet në rrjete fikse është FTTH/FTTB në rreth 75%, e ndjekur nga Modem kabllor koaksial me rreth 13%. Ndërsa pjesa tjetër mundësohet nga teknologji mikse, bakër dhe DSL.

Gjatë vitit 2025, trafiku i internetit *broadband* nga rrjete fikse arriti në rreth 2.08 miliardë GB, ose rreth 17% më shumë se viti 2024, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre financiare, informative, sociale, shëndetësore, etj.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë një ndryshim të dukshëm në mënyrën se si operatorët përdorin dhe ofrojnë infrastrukturën me shumicë në rrjetet fikse. Në përgjithësi, vihet re një ulje e fortë e kapaciteteve të dhëna me qira, veçanërisht në linjat ndërkombëtare, ku rënia arrin rreth 87%, si dhe një rritje e përgjithshme prej rreth 96% e kapacitetit total.

Tabela 7: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira, 2021-2025

	2021	2022	2023	2024	2025	Ndryshimi 2025/2024
Ofrim akses në infrastrukturë aktive						
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	1,018	1,291	1,450	2,047	2,154	5%
Kombëtare	991	1,228	1,382	1,960	2,077	6%
Ndërkombëtare	27	63	68	87	77	0
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	197,912	299,622	276,960	375,854	736,289	96%
Kombëtare	195,360	291,910	184,060	257,004	720,261	180%
Ndërkombëtare	2,552	7,712	92,900	118,850	16,028	-87%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)						
Dark fiber	2,634	2,943	2,373	2,323	6,507	180%
Akses në tubacione	76	73	111	106	126	19%
Aksesin në rrjetin ajror	367	266	191	212	1,432	575%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët në AKEP.

Në nivel kombëtar, ndonëse numri i lidhjeve të dhëna me qira ka shënuar një rritje të lehtë, kapaciteti total ka mbetur pothuajse i pandryshuar, duke reflektuar një përdorim më efikas dhe më të fragmentuar të burimeve ekzistuese.

Në aspektin e infrastrukturës pasive, aksesin në “dark fiber” ka rritje me rreth 180%, ndërsa aksesin në tubacione është rritur me rreth 19%, duke treguar një preferencë të operatorëve për të investuar në vendosjen e kabllave të tyre mbi infrastrukturën fizike ekzistuese. Gjithashtu, rritja e ndjeshme e përdorimit të rrjetit ajror tregon një zgjerim të shpejtë të rrjeteve, sidomos në zona ku ndërtimi nëntokësor është më i kushtueshëm ose më kompleks.

Në këtë treg, One Albania vijon të mbetet aktori kryesor në ofrimin me shumicë të aksesit si në elementët aktivë, ashtu edhe në ato pasivë të infrastrukturës fikse, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mundësimin e konkurrencës.

Në tërësi, këto zhvillime tregojnë një zhvendosje të tregut drejt përdorimit më të madh të infrastrukturës fizike dhe investimeve direkte nga operatorët, duke reflektuar një fazë më të avancuar të zhvillimit të rrjeteve.

2.2.3 Të ardhurat dhe investimet e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike 2025

Sipas të dhënave të raportuara nga operatorët gjatë vitit 2025, janë realizuar në total rreth 40.15 miliardë lekë të ardhura nga komunikimet elektronike, nga të cilat 28.95 miliardë lekë në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare dhe 11.2 miliardë lekë nga ofruesit e shërbimeve në rrjetet fikse. Krahasuar me vitin 2024, të ardhurat e shërbimeve celulare u rritën me rreth 4%, duke reflektuar një dinamizëm të vazhdueshëm në ofrimin e shërbimeve dhe rritjen e kërkesës për shërbime *broadband* dhe të dhëna celulare. Në të njëjtën kohë, të ardhurat nga rrjetet fikse paraqesin një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2024, kur niveli ishte rreth 11.6 miliardë lekë, duke reflektuar kryesisht presionin konkurrues dhe zhvendosjen graduale të konsumit drejt shërbimeve mobile


dhe platformave alternative të komunikimit. Edhe në tregun e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike të rrjeteve fikse, dy operatorët kryesorë të tregut janë One Albania dhe Vodafone Albania, ku së bashku përbëjnë rreth 52% të të ardhurave të këtij tregu, dhe rreth 87% të të ardhurave totale të komunikimeve elektronike nëse mblidhen së bashku të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet celulare dhe ato fikse.

Tregu celular vijon të karakterizohet nga një strukturë duopolistike, ku dy operatorët kryesorë, One Albania dhe Vodafone Albania, ndajnë pothuajse në mënyrë të barabartë pjesën më të madhe të tregut. Nga të ardhurat totale të gjeneruara nga shërbimet celulare, rreth 83% rrjedhin nga tregu me pakicë, i cili përfshin paketat mujore të komunikimit, internetin mobil, thirrjet dhe SMS-të kombëtare, si dhe shërbimet *roaming* për përdoruesit fundorë. Pjesa tjetër, rreth 17%, lidhet me shërbimet me shumicë, kryesisht terminimin e thirrjeve dhe interkoneksionin ndërmjet operatorëve. Në këtë strukturë, Vodafone Albania mban një avantazh të lehtë me rreth 58% të të ardhurave, ndërsa One Albania përfaqëson rreth 42%, reflektim i diferencave në strukturën e abonentëve dhe portofolin e shërbimeve. Analiza e tregut sipas indikatorëve kryesorë, duke përfshirë trafikun e thirrjeve dhe të dhënave, konfirmon përqendrimin e lartë dhe natyrën duopolistike të tregut, me indekse HHI mbi 5,000.

Në tregun e rrjeteve fikse, të ardhurat gjatë vitit 2025 rezultojnë në rreth 11.2 miliardë lekë, duke shënuar një rënie krahasuar me nivelin prej rreth 11.6 miliardë lekë në vitin 2024. Kjo dinamikë reflekton kryesisht presionin konkurrues, migrimin gradual të përdoruesve drejt shërbimeve mobile dhe platformave OTT, si dhe optimizimin e portofolit të shërbimeve fikse. Megjithatë, struktura e tregut mbetet e përqendruar te operatorët kryesorë dhe të mesëm, të cilët përbëjnë rreth 76% të totalit të të ardhurave. Në këtë segment, sipas volumit të të ardhurave, One Albania mban pjesën më të madhe të tregut me rreth 26%, e ndjekur nga Vodafone Albania me rreth 24%, ndërsa operatorët e tjerë kryesorë luhaten në intervalin 3–8%.

Në vijim janë të dhënat mbi të ardhurat në 2025, sipas grafikut:

Figura 7: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike 2021-2025 (milion lekë)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Të ardhurat nga shërbimet celulare

Zhvillimet për vitin 2025 konfirmojnë më tej këtë trend rritës të tregut celular. Të ardhurat totale nga shërbimet celulare arritën në rreth 28.95 miliardë lekë, duke shënuar një rritje të moderuar krahasuar me vitin 2024 dhe duke konsoliduar rolin dominues të këtij segmenti në tregun e komunikimeve elektronike, pasi edhe përgjatë vitit 2024, tregu i shërbimeve celulare shënoi një rritje të të ardhurave, të cilat arritën në rreth 28 miliardë lekë, duke qenë rreth 2.5 miliardë lekë më të larta krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2024, struktura e tregut karakterizohej nga dominimi i operatorit Vodafone Albania, i cili zotëronte rreth 58% të të ardhurave totale, ndërsa One Albania mbante pjesën e mbetur të tregut, gjithashtu në aspektin e përbërjes së të ardhurave, shërbimet me pakicë përbënin rreth 82% të totalit, ndërsa ato me shumicë rreth 18%, duke reflektuar një orientim të qartë drejt tregut të shërbimeve të pakicës. Konfigurimi i tregu dhe struktura e të ardhurave krijuan bazën mbi të cilën u mbështetën zhvillimet e mëtejshme gjatë vitit 2025, veçanërisht në drejtim të konsolidimit të tregut dhe rritjes së rolit të shërbimeve të të dhënave.


Pra, edhe gjatë vitit 2025, struktura e tregut mbetet pothuajse e pandryshuar, me Vodafone Albania që ruan epërsinë me rreth 58% të të ardhurave totale, ndërsa One Albania zotëron rreth 42%. Edhe në vitin 2025, tregu vijon të dominohet nga shërbimet me pakicë, të cilat përbëjnë rreth 83% të totalit, ndërsa shërbimet me shumicë rreth 17%.

Një zhvillim i rëndësishëm strukturor në vitin 2025 është thellimi i orientimit drejt shërbimeve të të dhënave dhe paketave të integruara (*bundle*). Të ardhurat nga paketat *bundle* përbëjnë mbi 90% të të ardhurave me pakicë brenda vendit, ku pothuajse e gjithë kjo vlerë lidhet me paketa që përfshijnë akses në internet. Në të kundërt, të ardhurat nga shërbimet tradicionale standalone (thirrje dhe SMS) vijojnë të zënë një peshë gjithnjë e më të vogël, duke konfirmuar transformimin e tregut drejt përdorimit të internetit si shërbim bazë. Gjithashtu, vihet re një dominim i qëndrueshëm i segmentit *postpaid*, i cili përbën rreth 62% të të ardhurave me pakicë, kundrejt 38% të segmentit *prepaid*, duke reflektuar një maturim të mëtejshëm të tregut dhe rritje të bazës së klientëve me kontratë.

Në segmentin ndërkombëtar, të ardhurat nga *roaming* (si me pakicë ashtu edhe me shumicë) mbeten të rëndësishme, me një peshë të konsiderueshme të shërbimeve të të dhënave *roaming*, çka lidhet me rritjen e përdorimit të internetit nga përdoruesit gjatë lëvizjeve jashtë vendit dhe hyrjes së turistëve.

Në vijim një ilustrim grafikor i të ardhurave të operatorëve celularë (në milion lekë), e cila reflekton periudhën 2022-2025.

Figura 8: Të ardhurat totale të operatorëve celularë, 2022-2025 (në milion lekë)⁵



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Të ardhurat nga shërbimet fikse


Struktura e të ardhurave në vitin 2025 vijon të dominohet nga segmenti me pakicë (*retail*), i cili përbën rreth 91% të totalit, ndërsa të ardhurat nga segmenti me shumicë (*wholesale*) zënë rreth 9%. Ky konfigurim konfirmon orientimin e tregut drejt ofrimit të shërbimeve për përdoruesit fundorë dhe një nivel ende të kufizuar të zhvillimit të tregut të aksesit dhe ndërveprimit ndërmjet operatorëve në nivel infrastrukture. Në vlerësim më të detajuar të segmentit me pakicë për vitin 2025, evidentohet se shërbimet standalone vijnë të zënë peshën kryesore me rreth 78% të të ardhurave të pakicës, ku brenda tyre akseset në internet fiks përbëjnë burimin dominues, me mbi 85% të kësaj kategorie. Në të kundërt, të ardhurat nga telefonja fikse kanë një peshë minimale, duke konfirmuar trendin e rënies strukturore të këtij shërbimi. Ndërkohë, shërbimet IPTV dhe TV kabllor mbajnë një rol të rëndësishëm plotësues në strukturën e të ardhurave. Të ardhurat nga paketat e integruara (*bundle*) në vitin 2025 përbëjnë rreth 18% të të ardhurave të pakicës (*retail*). Brenda kësaj kategorie, paketat që përfshijnë shërbime televizive dominojnë dukshëm ndaj atyre pa TV, çka tregon rëndësinë e përmbajtjes audiovizive në strategjitë komerciale të operatorëve.

⁵ Bazuar në rregulloren “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, të ardhurat për vitin 2025 raportohen nga operatorët deri në datën 10 prill (të ardhurat në rrjete celulare dhe fikse).

Segmenti i të ardhurave me shumicë paraqitet relativisht i përqendruar dhe i kufizuar në volum, brenda tij, të ardhurat nga linjat me qira dhe kapacitetet përbëjnë pjesën më të madhe, ndërsa të ardhurat nga interkoneksioni (terminimi dhe tranzitimi i thirrjeve) vijnë të kenë një rol në rënie, në përputhje me tkurrjen e përdorimit të telefonisë fikse tradicionale.


Nga këndvështrimi i strukturës së tregut, edhe për vitin 2025 evidentohet një përqendrim relativisht i lartë i të ardhurave, ku një numër i kufizuar sipërmarrësish gjenerojnë pjesën më të madhe të tregut, ndërsa operatorët e tjerë paraqiten me pjesë të vogla. Ky konfigurim është në linjë me zhvillimet e vitit 2024, ku sipërmarrësit e mëdhenj dhe të mesëm përbënin rreth 76% të totalit të të ardhurave, dhe ku tregu dominohej nga operatorët kryesorë. Në vitin 2025, sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut për sa i përket të ardhurave ishte One Albania me rreth 27%, i ndjekur nga Vodafone Albania me rreth 25%, ndërsa operatorët e tjerë kryesorë zotëronin pjesë tregu në intervalin 3% – 9% dhe operatorët e tjerë alternativë zënë rreth 23% të totalit të të ardhurave të këtij tregu. Rënia e të ardhurave në vitin 2024 (rreth 2% krahasuar me 2023) ishte ndikuar kryesisht nga ulja e të ardhurave të One Albania nga rrjetet fikse, trend i cili duket se ka vijuar edhe gjatë vitit 2025, megjithëse me intensitet më të moderuar.

Figura 9: Të ardhurat totale të operatorëve të rrjeteve fikse (në milion lekë)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Figura 10: Pjesët e tregut për të ardhurat sipas operatorëve kryesorë fiks në 2025



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Analiza e tregut të telefonisë fikse 2025

Gjatë vitit 2025, AKEP zhvilloi analizën e tregjeve me shumicë të telefonisë fikse në përputhje me ligjin nr. 54/2024. Ky proces përfshiu disa hapa kyç, duke filluar me publikimin e dokumentit për Këshillim Publik në muajin gusht 2025, analizën e konkurrencës në tregjet e terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve, si dhe identifikimin e operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT).

Pas përfundimit të këtij procesi, Këshilli Drejtues i AKEP miratoi me VKD nr. 19/2025 dokumentin final. Nga përfundimet e arritura në dokumentin e analizës së tregut të telefonisë fikse, u miratua në vijim, VKD nr. 20/2025, e cila përcakttoi One Albania si operator me FNT dhe përcakttoi masat rregulluese për të, ndërsa VKD nr. 21/2025 shpalli operatorët alternativë me FNT për tregun e terminimit të thirrjeve të ofruara nga rrjetet me vendndodhje fikse.

Tarifat e terminimit të thirrjeve fikse u përcaktuan me objektiv uljen graduale të kostove dhe rritjen e konkurrencës në tregun me pakicë. Tarifa aktuale prej 0.7 lek/min do të ulet në 0.3 lek/min më 1 mars 2026, në 0.15 lek/min më 1 shtator 2026 dhe në 0.07 lek/min më 1 mars 2027. Ky reduktim harmonizohet me praktikën e BE-së dhe BEREC, duke siguruar ulje të kostove të interkoneksionit dhe përmirësim të konkurrencës në treg. Nga ana tjetër, analiza tregoi se tregu i tranzitimit të thirrjeve fikse nuk plotëson kriteret për të konsideruar një operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg. Si rezultat, AKEP vendosi heqjen e detyrimeve rregulluese për këtë

treg, duke e fokusuar rregullimin vetëm tek tregjet me ndikim konkurrues. Konstatimet kryesore të analizës së tregut të telefonisë fikse të vitit 2025, tregojnë se, telefonja fikse tradicionale është në rënie graduale, ndërsa shërbimet VoIP dhe *broadband* po rriten ndjeshëm.

Vendimet e AKEP për shpalljen e operatorëve me FNT, për tarifat e terminimit dhe për derregullimin e tregut të tranzitimit, janë në përputhje me zhvillimet reale të tregut dhe me praktikatat e rregullimit të këtij tregu në vendet e Bashkimit Evropian.

2.2.4 Statusi i Shërbimit Universal për komunikimet elektronike (2025)

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, më datë 20.12.2024, shënon një ndryshim tjetër me vlerë në kuadrin rregullator të shërbimit universal në Shqipëri, duke e përafuar plotësisht atë me kërkesat e European Electronic Communications Code. Në dallim nga kuadri i mëparshëm ligjor, i cili bazohej në konceptin e aksesit funksional në internet, ligji i ri e zgjeron objektin e shërbimit universal duke përfshirë aksesin *broadband* në internet nga vendndodhje fikse si një shërbim bazë që duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë përdoruesit fundorë, me cilësi të përshtatshme dhe çmim të përballueshëm.

Sipas përkufizimit në ligjin 54/2024, citohet se: “*Shërbimi universal*” është një minimum i përcaktuar shërbimesh publike të komunikimeve elektronike, të një cilësie të caktuar, me çmime të përballueshme për të gjithë përdoruesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga vendndodhja gjeografike”.

Në këtë kontekst të ri ligjor, vlerësimi i Statusit të Shërbimit Universal për vitin 2025 mbështetet si në të dhënat më të fundit të disponueshme për mbulimin dhe përdorimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ashtu edhe në analizën e përputhshmërisë së tregut me kërkesat e reja ligjore. Kërkesat e ligjit 54/2024 për ofrimin e shërbimit universal në tregun e komunikimeve elektronike, në tërësinë e tyre, referojnë një qasje e cila përcaktohet në funksion të vlerësimit të statusit të Shërbimit Universal (SHU) për vitin 2025, e cila mbështetet në dy shtylla kryesore:

- (i) kuadrin ligjor të përcaktuar nga ligji nr. 54/2024, dhe
- (ii) treguesit faktikë të zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

Në këtë kuadër, SHU nuk kufizohet më vetëm në ofrimin e shërbimeve bazë të telefonisë, por përfshin edhe aksesin në internet *broadband* nga vendndodhje fikse, me parametra të caktuar të cilësisë dhe shpejtësisë. Theksi vendoset tek “akses *broadband* funksional”, i cili duhet të mundësojë pjesëmarrjen efektive të përdoruesve në jetën ekonomike dhe shërbimet digjitale.

Në këtë kontekst, vlerësimi për vitin 2025 është mbështetur në një tërësi indikatorësh që pasqyrojnë jo vetëm disponueshmërinë e shërbimeve, por edhe përdorimin real dhe

përballueshmërinë e tyre. Ky vlerësim, në funksion të analizës së ofrimit dhe përdorimit të SHU për vitin 2025, synon të reflektojë realitetin e tregut, duke u fokusuar në pesë elementë thelbësorë të lidhura me aksesin dhe cilësinë e tij, përdorimin real, përballueshmërinë, zbatimin rregullator dhe monitorimin efektiv, duke krijuar bazën për një vlerësim të balancuar të statusit të shërbimit universal në Shqipëri për vitin 2025, ku konkretisht do të vlerësohen:

- Dimensionin e aksesit dhe të mbulimit i cili mbetet themelor në vlerësimin e tyre, pasi të dhënat tregojnë shkallën e mbulimit nga rrjetet celulare, si dhe shkallën e mbulimit të rrjeteve fikse *broadband*, në terma infrastrukture.
- Vlerësimin e indikatorëve kryesorë në raport me cilësinë minimale të shërbimit (shpejtësitë e aksesit), të cilat duhet të përcaktohen dhe monitorohen në përputhje me nenin 110, të ligjit 54/2024, pasi kërkohet që ky akses të mos vlerësohet vetëm në terma mbulimi.
- Vlerësimin e indikatorëve kryesorë të dimensionit të përdorimit, si mundësi konkrete për të identifikuar një pasqyrë reale mbi efektivitetin SHU-së. Nivelet e përdorimit të internetit nga individët, familjet dhe ndërmarrjet, të disponueshmërisë, funksionalitetit në aktivitetet e përditshme për përdoruesit fundore. Ky është një element thelbësor, pasi SHU, sipas logjikës së re të ligjit, nuk matet vetëm me akses fizik, por me mundësinë reale të përdorimit të shërbimeve digjitale.
- Përballueshmëria përbën një nga shtyllat më kritike të vlerësimit. Referencat ndërkombëtare, si shportat TIK të International Telecommunications Union, treguesi ARRP, në vlerësimin e niveleve të përballueshmërisë, duke krahasuar me vendet e rajonit dhe të BE-së, në referencë me pragun 2% të të ardhurave për frymë. Në këtë aspekt, ligji nr. 54/2024 (neni 112) kërkon një analizë më të thelluar të përballueshmërisë për grupet vulnerabël, duke e zhvendosur fokusin tek nevojat bazike për përdorimin e shërbimeve digjitale të lidhura me shërbimet bazë të përdoruesit.
- Në të njëjtën kohë, dimensionin rregullator lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në nenet 111–128 të ligjit, të cilat përfshijnë përcaktimin e parametrave të shërbimit, identifikimin e nevojave për ndërhyrje, si dhe mekanizmat për garantimin e ofrimit të SHU-së në mënyrë efektive dhe të përballueshme, pra nënkupton rolin e autoritetit rregullator në monitorim, analizë dhe, kur është e nevojshme, ndërhyrje në treg.
- Ligji nr. 54/2024 ka në fokus ndër të tjera cilësinë e shërbimit dhe mekanizmat e raportimit, të cilët përbëjnë elementë mbështetës të vlerësimit në ofrimin e shërbimit universal. Shpejtësia reale e aksesit, besueshmëria e rrjetit dhe transparenca e të dhënave janë thelbësore për të siguruar që standardet e përcaktuara në ligj reflektohen në përvojën konkrete të përdoruesve.

Dimensioni i mbulimit dhe përdorimit të shërbimeve celulare

Për vitin 2025, zhvillimet në mbulimin me rrjetet celulare, konfirmojnë vijimësinë e rolit dominues të këtyre teknologjive në sigurimin e shërbimit universal, duke reflektuar një nivel të lartë të disponueshmërisë së shërbimeve në shkallë kombëtare dhe një përmirësim të mëtijshëm në raport me vitin 2024. Në linjë me situatën e evidentuar për vitin 2024, ku rrjetet celulare përbënin teknologjinë kryesore për garantimin e aksesit universal me mbulim pothuajse total të popullsisë (rreth 99%) dhe mbulim territorial rreth 96%, të dhënat për vitin 2025 tregojnë se ky nivel është ruajtur në mënyrë të qëndrueshme, duke konfirmuar maturitetin e kësaj infrastrukture si bazë për akses minimal në shërbimet bazë. Mbulimi me rrjetet 4G vijon të mbetet në nivele shumë të larta, ku për vitin 2025, të dy operatorët kryesorë kanë raportuar mbulim të popullsisë në nivele 99–100%, ndërsa mbulimi territorial paraqitet shumë pranë niveleve të vitit 2024 (rreth 96–97%).

Risi kryesore për vitin 2025 paraqet zhvillimi i rrjeteve 5G, të cilat, ndonëse ende në faza fillestare, tregojnë një zgjerim të ndjeshëm të mbulimit si në aspektin territorial ashtu edhe në atë të popullsisë. Konkretisht, mbulimi i popullsisë me 5G arrin në nivele mbi 60% për një operator dhe mbi 70% për operatorin tjetër, ndërsa mbulimi territorial, deri në 36%. Këto zhvillime përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të cilësisë së aksesit *broadband* dhe krijojnë bazën për përmbushjen progresive të kërkesave të ligjit nr. 54/2024 në lidhje me “aksesin *broadband* adekuat”.

Në tërësi, krahasuar me vitin 2024, tregu për vitin 2025 karakterizohet nga një stabilitet në mbulimin me rrjetet ekzistuese dhe një zgjerim i dukshëm i teknologjisë 5G, duke forcuar më tej kapacitetet e rrjeteve celulare për të mbështetur ofrimin e shërbimit universal, si në aspektin e aksesit, ashtu edhe të cilësisë së shërbimit.

Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se tregu celular në Shqipëri ka hyrë në një fazë të konsoliduar dhe maturimi, ku niveli i përdorimit mbetet i lartë dhe relativisht i qëndrueshëm. Numri i përdoruesve aktivë rreth 2.5 milionë dëshmon për një bazë të stabilizuar përdoruesish, ndërkohë që penetrimi i kartave SIM, megjithëse në rënie për shkak të reduktimit të përdorimit të shumëfishtë, vijon të mbetet në nivele të larta (rreth 1.33 SIM për banor). Ky zhvillim, në raport me vitin 2024, tregon një kalim nga faza e zgjerimit sasior drejt një përdorimi më racional dhe efikas të shërbimeve celulare.

Në aspektin e strukturës së tregut, konsolidimi pas bashkimit të operatorëve ka krijuar një balancë të qëndrueshme midis dy operatorëve kryesorë, duke reflektuar një konkurrencë të fokusuar më shumë në cilësi shërbimi, oferta të integruara dhe kapacitete *broadband*. Kjo dinamikë ndikon drejtpërdrejt në përmirësimin e përvojës së përdoruesit dhe në rritjen e përdorimit të shërbimeve të avancuara.

Një nga treguesit më domethënës për vitin 2025 është rritja e vazhdueshme e përdorimit të të dhënave celulare, me një rritje mbi 16% krahasuar me vitin 2024. Ky trend konfirmon transformimin e sjelljes së përdoruesve, nga përdorimi tradicional i shërbimeve zanore dhe SMS drejt konsumit të shërbimeve *broadband* dhe aplikacioneve të bazuara në internet. Në të kundërt,

rënia e lehtë e thirrjeve dhe SMS-ve përforcon këtë zhvendosje strukturore në mënyrën e përdorimit të rrjeteve celulare. Në fund të vitit 2025, numri i pajtimtarëve aktivë që përdorin internetin celular rezultoi rreth 2.07 milionë, me një nivel penetrimi prej 88% të popullsisë, në rritje krahasuar me vitin 2024. Krahasuar me vitin 2024, kjo situatë reflekton një konsolidim të rolit të internetit mobil si mjet mjaft i rëndësishëm për akses në shërbimet digjitale, duke mbuluar në mënyrë efektive nevojat bazë të përdoruesve për komunikim, informacion dhe ndërveprim ekonomik e social.

Dimensioni i mbulimit dhe përdorimit shërbimeve nga rrjetet fikse

Zhvillimet në rrjetet fikse *broadband* gjatë vitit 2025 kanë vijuar në të njëjtën trajektore pozitive, duke reflektuar rritjen e qëndrueshme të kërkesës për shërbime me kapacitet të lartë dhe përmbajtje digjitale. Përqindja e familjeve me akses *broadband* fiks ka arritur në rreth 95% të totalit, duke shënuar një përmirësim të mëtijshëm krahasuar me nivelin prej rreth 92% në vitin 2024. Ky progres tregon një zgjerim të vazhdueshëm të aksesit dhe një afrim drejt mbulimit pothuajse tërësor në nivel familjeje.

Ky zhvillim është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 54/2024, i cili vendos theks të veçantë mbi sigurimin e aksesit *broadband* nga vendndodhje fikse si një komponent thelbësor i shërbimit universal.

Tregu i rrjeteve fikse karakterizohet nga një numër i konsiderueshëm sipërmarrësish të autorizuar (në total 281), ku pjesa më e madhe ofrojnë shërbime interneti dhe paketa të integruara, ndërsa struktura e tregut mbetet e përqendruar në disa operatorë kryesorë, të cilët mbulojnë pjesën më të madhe të kërkesës për shërbime *broadband*. Ky konfigurim reflekton një kombinim midis konkurrencës lokale dhe konsolidimit të tregut, në linjë me zhvillimet e viteve të fundit dhe konvergjencën e shërbimeve fikse dhe celulare. Në aspektin e përdorimit, trendi i rënies së telefonisë fikse tradicionale vijon edhe në vitin 2025, me një reduktim të numrit të pajtimtarëve në rreth 149 mijë (rreth -10% krahasuar me vitin 2024) dhe një penetrim relativisht të ulët prej rreth 6%. Ky zhvillim konfirmon zhvendosjen e përdoruesve drejt shërbimeve alternative, kryesisht atyre mobile dhe komunikimeve të bazuara në internet (VoIP), duke zbehur rolin tradicional të telefonisë fikse në kuadër të shërbimit universal.

Në të kundërt, shërbimet *broadband* nga rrjetet fikse kanë vijuar një trajektore të qartë rritjeje, duke u shndërruar në komponentin kryesor të kontributit të këtyre rrjeteve në shërbimin universal. Në fund të vitit 2025, numri i pajtimtarëve me akses *broadband* fiks ka arritur në mbi 733 mijë, me një rritje prej rreth 6% krahasuar me vitin pararendës. Paralelisht, është evident një përmirësim i ndjeshëm në cilësinë e aksesit *broadband*, i reflektuar në rritjen e shpejtësive të ofruara. Në vitin 2025, rreth 89% e pajtimtarëve kanë akses në shpejtësi mbi 30 Mbps (nga rreth 84% në 2024), ndërsa lidhjet me shpejtësi mbi 100 Mbps përbëjnë rreth 54% të totalit (nga rreth 42% në vitin pararendës). Ky zhvillim lidhet ngushtë me zgjerimin e përdorimit të teknologjive me fibra optike (FTTH/FTTB), të cilat përbëjnë tashmë rreth 75% të lidhjeve *broadband* fikse, duke zëvendësuar gradualisht teknologjitë tradicionale.

Në aspektin e përdorimit, rritja e trafikut të internetit fiks me rreth 17% krahasuar me vitin 2024 tregon një intensifikim të ndjeshëm të konsumit të shërbimeve digjitale për qëllime komunikimi, edukimi, informacioni dhe argëtimi. Kjo konfirmon se rrjetet fikse po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mbështetjen e nevojave në rritje për kapacitet dhe cilësi të lartë të lidhjes.

Në tërësi, krahasuar me vitin 2024, zhvillimet gjatë vitit 2025 tregojnë se rrjetet fikse po konsolidohen si një shtyllë thelbësore për ofrimin e aksesit *broadband* në kuadër të shërbimit universal. Ndërsa roli i telefonisë fikse tradicionale vijon të zbehet, rrjetet fikse po përmbushin në mënyrë gjithnjë e më efektive funksionin e tyre në sigurimin e aksesit me cilësi të lartë, duke plotësuar dhe forcuar rolin e rrjeteve celulare në garantimin e një aksesit gjithëpërfshirës në shërbimet e komunikimeve elektronike në Shqipëri për vitin 2025.

Nga anketat e zhvilluara nga INSTAT, të cilat reflektojnë të dhëna që shërbejnë për vlerësimin e përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në kuadrin e vlerësimit të statusit të shërbimit universal, sipas të cilave në vlerësimin e shërbimit universal për vitin 2025, të dhënat e INSTAT ofrojnë një panoramë të përditësuar dhe shumë domethënëse mbi nivelin e përhapjes dhe përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në familje dhe nga individët, duke shërbyer si një referencë e rëndësishme plotësuese ndaj treguesve të referuar nga AKEP. Nga ana e përdorimit, rezultatet e anketës për vitin 2025 konfirmojnë një nivel shumë të lartë të penetrimit të internetit në popullsi dhe një intensitet të lartë përdorimi. Rreth 87,2% e individëve të moshës 16–74 vjeç përdorin internetin, në rritje krahasuar me vitin 2024, ndërsa pothuajse të gjithë përdoruesit (97,3%) e përdorin atë disa herë gjatë ditës. Ky nivel i lartë përdorimi dëshmon për rolin tashmë thelbësor të internetit në jetën e përditshme dhe për një kërkesë të qëndrueshme për akses cilësor dhe të përballueshëm *broadband*.

Në nivel familjar, 97,7% e njësive ekonomike familjare kanë akses në internet, duke reflektuar një mbulim pothuajse universal. Brenda këtij treguesi, 92,1% e familjeve kanë akses në rrjet fiks *broadband*, ndërsa 99,3% kanë akses përmes rrjeteve mobile *broadband*, çka tregon një komplementaritet të fortë midis infrastrukturave fikse dhe atyre mobile në sigurimin e aksesit universal.

Përdorimi i pajisjeve për akses në internet mbetet i dominuar nga telefonat inteligjentë (99,9%), por njëkohësisht evidentohet përdorim i konsiderueshëm i pajisjeve të tjera si laptop, pajisjet smart dhe kompjuterët desktop, duke reflektuar diversifikimin e mënyrave të aksesit dhe përdorimit të shërbimeve digjitale. Të dhënat tregojnë gjithashtu një thellim të përdorimit të shërbimeve digjitale. Pothuajse e gjithë popullsia (99,1%) përdor internetin për komunikim (thirrje dhe video-thirrje), ndërsa vihet re rritje e ndjeshme në aktivitete si kërkimi i informacionit për mallra dhe shërbime, përdorimi i shërbimeve bankare *online* dhe pjesëmarrja në rrjetet sociale. Në të njëjtën kohë, 99,5% e individëve kanë një llogari në platformën e-albania, duke dëshmuar për një nivel shumë të lartë të ndërveprimit me shërbimet publike digjitale dhe për rëndësinë kritike të aksesit në internet për përfitimin e tyre.

Treguesit mbi tregtinë elektronike konfirmojnë më tej këtë trend, ku 45,4% e popullsisë kanë kryer blerje *online* gjatë 12 muajve të fundit, në rritje krahasuar me vitin paraardhës, duke

reflektuar zgjerimin e ekonomisë digjitale dhe nevojën për infrastrukturë të besueshme dhe me kapacitet të lartë.

Në tërësi, këta tregues për vitin 2025 përforcojnë konkluzionin se aksesit në internet *broadband* – si fiks ashtu edhe mobil – ka arritur nivele të larta mbulimi dhe përdorimi në Shqipëri, duke mbështetur vlerësimin se objektivat bazë të shërbimit universal në aspektin e aksesit janë në masë të madhe të përmbushura. Njëkohësisht, intensiteti i përdorimit dhe zgjerimi i shërbimeve digjitale sugjerojnë se fokusi rregullator duhet të zhvendoset gjithnjë e më shumë drejt cilësisë së shërbimit, përbalueshmërisë dhe përfshirjes digjitale, si elementë kyç për garantimin efektiv të shërbimit universal në praktikë.

Tabela 8: Përdorimi i TIK në Njësi Ekonomike Familjare, 2025

Treguesi	Vlera 2024 (%)	Vlera 2025 (%)	Shënime
Përdorues aktivë të internetit (16–74 vjeç)	86.2	87.2	+1.0 p.p krahasuar me 2024
Përdorues të shpeshtë / çdo ditë	96.4	97.3	Nga përdoruesit e internetit
Familje me akses në internet (NjEF)	97.1	97.7	Nivel pothuajse universal
Akses në broadband fiks	91.5	92.1	Nga familjet
Akses në broadband mobil	99.3	99.3	Nga familjet
Përdorimi i smartphone për internet	99.9	99.9	Pajisja kryesore
Përdorimi i desktopëve	29.2	20.9	
Përdorimi i laptopëve	28.5	41.2	
Përdorimi i tabletëve / pajisje të tjera smart	19.4	59	Pajisje të tjera smart përfshi ora, Smart TV
Përdorimi për thirrje/video-thirrje	98.9	99.1	Skype, WhatsApp, etj.
Blerje online	42.4	45.4	+3.0 p.p (12 muajt e fundit)
Popullsia me llogari e-Albania	99.4	99.5	Shërbime publike digjitale
Përdorimi për marrje informacioni (e-qeverisje)	54.8	57	+2.2 p.p
Përdorimi për shkarkim/printim formularësh	64	64.5	+0.5 p.p

Burimi: Publikim i INSTAT datë më 11 dhjetor 2025, bazuar në rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Ndërmarrje; përpunimi dhe krahasimi me 2024 nga AKEP.

Sipas anketës së kryer nga INSTAT më 19 shtator 2025, përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit vazhdon të jetë shumë i përhapur në ndërmarrjet shqiptare me 10 e më shumë të punësuar. Në vitin 2025, 99,4% e ndërmarrjeve kanë përdorur kompjuter me akses në internet për qëllime pune, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me 99,3% në vitin 2024. Po ashtu, ndërmarrjet që kanë specialistë TIK u rritën në 31,8% nga 29,7% në vitin 2024.

Sektori më i përqendruar në përdorimin e kompjuterëve me internet është Informacioni dhe Komunikimi (79,7%), i ndjekur nga aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe Teknike (70,3%) dhe Shërbimet Administrative dhe Mbështetëse (65,4%). Nga aspekti i madhësisë së ndërmarrjeve, ato me më shumë se 250 të punësuar përdorin 100% kompjuter me internet. Lidhjet fikse në internet janë të përdorura nga 100% e ndërmarrjeve, me 91,8% që kanë shpejtësi shkarkimi mbi 30 Mbit/s dhe 50,4% mbi 100 Mbit/s, duke treguar një përmirësim të konsiderueshëm krahasuar me vitin 2024. Rreth 61% e ndërmarrjeve kanë faqe interneti, ndërsa 28% shesin produkte ose shërbime *online*, me pjesën më të madhe në sektorin e Akomodimit dhe Shërbimit Ushqimor (48,2%), Profesionale, Shkencore dhe Teknike (44,8%) dhe Informacioni dhe Komunikimi (43,3%). Vlera e xhiros nga shitjet *online* për vitin 2025 ishte 10,1%, me aktivitetin e Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë që kontribuon 46,1% dhe sektorin Informacioni dhe Komunikimi 16,5%. Përdorimi i medias sociale vazhdon të jetë i lartë (86,5% e ndërmarrjeve), ndërsa shërbimet cloud janë përdorur nga 33,8% e ndërmarrjeve, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2024 (30%).

Tabela 9: Përdorimi i TIK në Ndërmarrje, 2024 – 2025

Indikator	2024 (%)	2025 (%)
Ndërmarrjet me kompjuter dhe internet	99,3	99,4
Ndërmarrjet me specialistë TIK	29,7	31,8
Përdorimi i kompjuterit me internet sipas aktivitetit:		
– Informacion dhe Komunikim	74,8	79,7
– Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe Teknike	65,7	70,3
– Shërbime administrative dhe mbështetëse	65,4	65,4
Përdorimi i kompjuterit sipas madhësisë së ndërmarrjes:		
– 10-49 të punësuar	99,3	99,3
– 50-249 të punësuar	99,5	99,5
– 250+ të punësuar	100	100
Ndërmarrjet me lidhje fikse në internet	99,3	100
Shpejtësia shkarkimi >30 Mbit/s	88,8	91,8
Shpejtësia shkarkimi >100 Mbit/s	40,9	50,4
Ndërmarrjet me faqe interneti	57,7	61,0
Ndërmarrjet që shesin online	24,5	28,0
Pjesa e shitjeve online nga total xhiro	9,5	10,1
Përdorimi i medias sociale	83,1	86,5
Përdorimi i shërbimeve cloud	30,0	33,8

Burimi: Publikim i INSTAT datë më 19 shtator 2025; përpunimi dhe krahasimi me 2024 nga AKEP.

Të dhënat e mësipërme në lidhje me shkallën e mbulimit të territorit dhe popullsisë dhe përdorimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, dëshmojnë se rrjetet celulare dhe fikse mundësojnë akses në rrjet publik të komunikimeve elektronike dhe akses *broadband* në internet për pothuajse të gjitha familjet dhe popullsinë e Shqipërisë, pra pavarësisht vendndodhjes gjeografike të përdoruesit.

Përballueshmëria e shërbimeve të komunikimeve elektronike

Vlerësimi i përballueshmërisë së shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri është kryer në përputhje me metodologjinë e Bashkimit të Përbotshëm të Telekomunikacionit (International Telecommunication Union), e cila mat koston e shportave standarde të TIK në raport me të ardhurat kombëtare bruto për frymë (GNI/banorë). Pragu prej 2% i GNI/banorë shërben si kufi referues për përcaktimin e përballueshmërisë së shërbimeve bazë.

Të dhënat për periudhën 2023–2025 tregojnë se, në përgjithësi, shërbimet e komunikimeve elektronike në Shqipëri mbeten brenda kufijve të përballueshmërisë, megjithëse me diferencime ndërmjet segmenteve. Shërbimet mobile paraqiten në një situatë më të favorshme, ku të gjitha shportat, si ato me konsum të ulët, vetëm për internet, ashtu edhe ato me konsum të lartë, rezultojnë nën ose shumë pranë pragut prej 2% të GNI për frymë. Konkretisht, shporta me konsum të ulët (70 minuta, 50 SMS dhe 1 GB) vlerësohet në rreth 1.3% në vitin 2025, ndërsa shporta vetëm për internet dhe ajo me konsum të lartë mbeten respektivisht në nivele rreth 1.69% dhe 1.95%.

Nga ana tjetër, shporta e *broadband*-it fiks ka paraqitur një përmirësim gradual, duke zbritur nga 2.31% në vitin 2024 në rreth 2.08% në vitin 2025, duke kaluar kështu nga një nivel mbi prapun e përballueshmërisë në një nivel më të pranueshëm.

Një tregues plotësues i rëndësishëm për analizën e përballueshmërisë është niveli i të ardhurave mesatare për përdorues (ARRPU) në tregun celular. Në vitin 2025, ARRPU mesatare në Shqipëri arrin rreth 7.28 euro, me një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2024. Operatorët One Albania dhe Vodafone Albania, shfaqin rritje të moderuar të këtij treguesi, ndërsa niveli i përgjithshëm mbetet dukshëm më i ulët se mesatarja e vendeve të BE/EEA, e cila është mbi 12 euro.

Në një këndvështrim krahasimor rajonal për vitin 2025, përballueshmëria në Shqipëri paraqet një situatë të ndërmjetme. Për shportën e *broadband*-it fiks (5 GB), Shqipëria qëndron nën mesataren rajonale dhe atë globale, duke reflektuar një nivel relativisht të pranueshëm të koston. Për shportën me konsum të ulët, Shqipëria rezulton në nivelin 1.3% të GNI për frymë, në linjë me mesataren globale, por më pak konkurruese krahasuar me vende si Serbia dhe Mali i Zi, të cilat ofrojnë nivele më të larta përballueshmërie. Në të njëjtën kohë, Shqipëria paraqitet në nivele të përafërta ose disi më të favorshme krahasuar me Bosnje dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut. Për shportat vetëm për internet dhe ato me konsum të lartë, në disa raste vihet re se

përdoruesit shqiptarë përballen me një kosto relativisht më të lartë krahasuar me disa tregje të rajonit, duke reflektuar një diferencë në strukturën e çmimeve dhe në dinamikat konkurruese të tregut.

Tabela e mëposhtme paraqet informacion sipas të dhënave më të fundit të publikuar nga ITU⁶ mbi përballueshmërinë e çmimeve të TIK, duke bërë një krahasim të përballueshmërisë së shpenzimeve për shportat përkatëse të ITU-së për Shqipërinë në krahasimin me vendet e rajonit për vitin 2025.

Tabela 10: Krahasimi rajonal i përballueshmërisë (2025)

	Fixed - broadband shporta me 5GB	Shporta me përdorim të ulët thirrjet voice dhe internet (70 min + 50 SMS + 1 GB)	Mobile- broadband (vetëm data) shporta me 5 GB	Shporta me përdorim të lartë thirrjet voice dhe internet (140 min +20 SMS +5 GB)
<i>Shqipëria</i>	2.08	1.3	1.69	1.95
<i>Bosnje Hercegovina</i>	1.93	1.45	1.17	1.86
<i>Maqedonia Veriut</i>	2.15	1.43	1.31	2.1
<i>Mali i Zi</i>	2.41	1.01	1.01	1.01
<i>Serbia</i>	2.1	0.44	0.96	1.49
<i>Mesatare botërore</i>	2.53	1.3	1.38	1.54

Burimi: AKEP sipas të dhënave të publikuara nga ITU (Të dhënat janë në përqindje (shpenzim/GNI për frymë)).

Në kontekstin e shërbimit universal, rëndësi të veçantë kanë shportat me konsum të ulët, pasi ato përfaqësojnë nivelin minimal të aksesit në shërbime. Në këtë drejtim, Shqipëria siguron një nivel të pranueshëm përballueshmërie dhe përmbush objektivat bazë të aksesit universal, pavarësisht se nuk renditet ndër vendet më të favorshme në rajon.

Interpretimi i këtyre treguesve duhet të marrë në konsideratë edhe ndryshimet metodologjike në përbërjen e shportave të International Telecommunication Union. Shportat aktuale janë përshtatur me modelet reale të konsumit, duke përfshirë volume më të larta të të dhënave (deri në 5 GB për shportat mobile), rritje të elementeve bazë si SMS për shportat me konsum të ulët, si dhe përcaktimin e parametrave minimalë të cilësisë për *broadband*-in fiks.

Tabela 11: Përmbajtja e shportave dhe profili i konsumatorit sipas metodologjisë së ITU

⁶ <https://datahub.itu.int/data/?i=38968>

Shporta ICT	Lloji i përdoruesit	Përmbajtja
Mobile broadband low-consumption	Përdorues me konsum të ulët	70 min, 50 SMS, 1 GB
Mobile broadband high-consumption	Përdorues me konsum të lartë	140 min, 70 SMS, 5 GB
Mobile broadband data-only	Përdorues vetëm internet	5 GB
Fixed broadband	Përdorues broadband fiks	5 GB

Burimi: AKEP mbi profilin e përdoruesit sipas të dhënave të metodologjisë ITU.

Në tërësi, zhvillimet e tregut gjatë vitit 2025 konfirmojnë një orientim drejt shërbimeve mobile *broadband*, të cilat luajnë një rol kyç në sigurimin e aksesit të përballueshëm dhe të gjerë në shërbime digjitale. Nga ana tjetër, segmenti i *broadband*-it fiks mbetet më sfidues dhe kërkon vëmendje të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit të përballueshmërisë dhe nxitjes së investimeve në infrastrukturë, çfarë nënkupton se Shqipëria paraqet nivele të kënaqshme të përballueshmërisë për shërbimet mobile dhe një situatë në përmirësim për *broadband*-in fiks, duke reflektuar një treg relativisht të aksesueshëm për përdoruesit, por me hapësira të mëtejshme për zhvillim dhe ndërhyrje rregullatore. Bazuar në të dhënat më të fundit të publikuara nga ITU⁷, AKEP në tabelën në vijim ka paraqitur ecurinë e shpenzimeve për pesë shportat TIK të ITU në raport me GNI për frymë për Shqipërinë për periudhën 2023-2025 (është referuar versioni i fundit i shportave dhe jo shportat e viteve të mëparshme, duke qenë se përmbajtja e tyre ka ndryshuar).

Tabela 12: Përballueshmëria e shpenzimeve për shportat TIK të ITU (Shqipëria 2023-2025)

Viti	Broadband fiks (5 GB)	Mobile low-consumption (70 min + 50 SMS + 1 GB)	Mobile data-only (5 GB)	Mobile high-consumption (140 min + 70 SMS + 5 GB)
2023	2.07%	–	2.07%	–
2024	2.31%	–	1.88%	–
2025	2.08%	1.30%	1.69%	1.95%

Burimi: AKEP sipas të dhënave të publikuara nga ITU.

⁷ <https://datahub.itu.int/data/?i=38965&e=ALB>

Aksesi dhe shpejtësia minimale e *broadband*-it si pjesë e shërbimit universal

Për vitin 2025, zhvillimet që lidhen me shpejtësinë e aksesit *broadband* (BB) nuk paraqesin ndryshime thelbësore krahasuar me raportimin pararendës, por konfirmojnë konsolidimin e një qasjeje të harmonizuar për përcaktimin e standardeve minimale të këtij shërbimi.

Referuar praktikave të vendeve anëtare të BEREC, të reflektuara në raportet më të fundit mbi përcaktimin e shërbimit adekuat të aksesit *broadband* në kuadër të shërbimit universal, vihet re se procesi i përfshirjes së *broadband*-it në objektin e SHU-së është tashmë në një fazë të avancuar. Në vijim të transpozimit të European Electronic Communications Code në legjislacionet kombëtare, shumica e vendeve të BE/EEA kanë përcaktuar parametrat bazë të aksesit *broadband* si pjesë integrale e shërbimit universal, duke kaluar nga një fazë tranzitore drejt një kuadri më të qëndrueshëm rregullator.

Në këtë kontekst, shpejtësia minimale e aksesit *broadband* mbetet një nga elementët kryesorë për vlerësimin e “shërbimit adekuat”. Analiza e praktikave evropiane tregon se nuk ka pasur rritje të ndjeshme të këtyre pragjeve gjatë periudhës së fundit, çka sugjeron një stabilizim të pritshmërive rregullatore. Shumica e vendeve që kanë përfshirë *broadband*-in në SHU vijojnë të aplikojnë pragje minimale të shpejtësisë së shkarkimit në intervalin 10 Mbps, ndërsa një numër më i kufizuar vendesh kanë vendosur nivele më të ulëta (6–8 Mbps) ose janë duke kaluar gradualisht drejt pragjeve më të larta, si 30 Mbps, në përputhje me objektivat afatmesëm të zhvillimit digjital.

Në mënyrë të ngjashme, për shpejtësinë e ngarkimit (upload), ku shumica e vendeve kanë përcaktuar një prag minimal rreth 1 Mbps. Vetëm në disa raste janë vendosur nivele më të larta (1.5–2 Mbps), ndërsa një pjesë e vendeve nuk kanë përcaktuar ende një standard të detyrueshëm për këtë parametër. Kjo tregon se, ndonëse rëndësia e shërbimeve simetrike dhe aplikacioneve që kërkojnë kapacitete më të larta upload po rritet, rregullimi vijon të mbështetet në kërkesat minimale funksionale për përfshirje bazë digjitale.

Nga një këndvështrim interpretues, mungesa e ndryshimeve të theksuara në pragjet e shpejtësisë nuk duhet parë si stagnim, por si reflektim i një balancimi të kujdesshëm midis:

- garantimit të një niveli minimal të aksesit për të gjithë përdoruesit, dhe
- shmangies së vendosjes së detyrimeve disproporcionale për operatorët, veçanërisht në zonat rurale apo me kosto të lartë zhvillimi.

Për Shqipërinë kjo panoramë evropiane është veçanërisht e përshtatshme në kontekstin e zbatimit të kuadrit të ri ligjor dhe përafrimit me *acquis* të BE-së. Edhe në mungesë të ndryshimeve të mëdha në pragjet e shpejtësisë, fokusi i politikave publike duhet të zhvendoset gjithnjë e më shumë drejt:

- garantimit të mbulimit efektiv me *broadband* në të gjithë territorin,
- përmirësimit të cilësisë reale të shërbimit, dhe
- rritjes së përdorimit nga popullsia, përtej thjesht disponueshmërisë së aksesit.

Në këtë kuadër, për vitin 2025, mund të konkludohet se standardet minimale të shpejtësisë për aksesin *broadband* si pjesë e shërbimit universal janë tashmë të konsoliduara, por sfida kryesore për rregullatorët, përfshirë edhe Shqipërinë, lidhet me zbatimin efektiv të tyre dhe sigurimin e një aksesit real, cilësor dhe të përballueshëm për të gjithë përdoruesit.

2.3 Roaming Like at Home

Paralelisht me zhvillimet në kuadrin nënligjor, AKEP ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përgatitjen e kuadrit ligjor dhe rregullator që lidhet me realizimin e iniciativës strategjike për zbatimin e modelit “*Roam Like At Home*” (RLAH) ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), AKEP ka kontribuar në hartimin e një draft pakete të plotë rregullatore, e cila synon të krijojë bazën e nevojshme ligjore dhe teknike për eliminimin e tarifave shtesë të *roaming* ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të BE-së.

Në këtë kuadër, një komponent thelbësor ka qenë kontributi teknik për amendimin e ligjit nr.54/2024, me qëllim krijimin e hapësirës së nevojshme ligjore për miratimin e akteve nënligjore specifike për *roaming*-un dhe për forcimin e kompetencave të AKEP në drejtim të monitorimit dhe zbatimit të regjimit RLAH. Ky proces është zhvilluar në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe në reflektim të modeleve të vendeve të tjera në proces integrimi.

AKEP ka kontribuar në hartimin e disa akteve që do të mundësojnë zbatimin praktik të RLAH (ne dy versionet shqip dhe anglisht) të cilat në vijim kërkojnë miratimin e tyre nga Parlamenti, Këshilli i Ministrave, si dhe Këshilli Drejtues i AKEP (në varësi të dokumentit dhe përgjegjësisë).


Në tërësi, paketa rregullatore e propozuar për RLAH përfshin një kombinim të ndryshimeve ligjore dhe miratimeve të akteve nënligjore (ligj/VKM/VKD), të cilat do të mundësojnë transpozimin dhe zbatimin e rregulloreve kryesore të Bashkimit Evropian në fushën e *roaming*-ut, përfshirë Rregulloren (BE) 2022/612. Kjo qasje e integruar synon të sigurojë jo vetëm përputhshmëri ligjore, por edhe zbatueshmëri efektive në praktikë, duke vendosur një balancë midis mbrojtjes së konsumatorit dhe qëndrueshmërisë ekonomike të operatorëve.

Tregues të *Roaming* në Ballkanin Perëndimor

Pas zbatimit të marrëveshjes historike mes vendeve të Ballkanit Perëndimor për eliminimin e tarifave *roaming* që nisi më 1 korrik 2021, dhe marrëveshjes së mëvonshme për uljen graduale të tarifave midis rajonit dhe vendeve të Bashkimit Evropian që hyri në fuqi më 1 tetor 2023, përdorimi i shërbimeve *roaming* nga pajtimtarët shqiptarë ka shënuar ndryshime të dukshme. Numri i përdoruesve që përdorin *roaming* në vendet e Ballkanit Perëndimor arriti në rreth 835 mijë në vitin 2025, duke reflektuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me periudhën para marrëveshjes rajonale, edhe pse me një rënie të lehtë prej 3% krahasuar me vitin 2024.

Grafiku në vijim paraqet informacion mbi ecurinë e numrit të përdoruesve të shërbimeve *roaming* dhe volumet e komunikimeve elektronike (voice, data dhe sms) gjatë qëndrimit të tyre në vendet e rajonit.

Figura 11: Numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet roaming në BP, (2021-2025)




Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Nga grafiku i mësipërm numri i pajtimtarëve që kanë përdorur shërbimet *roaming* gjatë qëndrimit të tyre në një nga vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar rënie me rreth 3 % nga viti pararendës, duke arritur rreth 835 mijë pajtimtarë.

Figura në vijim paraqet ecurinë e volumit të konsumit të shërbimit të internetit të pajtimtarëve të operatoreve celulare të Shqipërisë gjatë qëndrimit të tyre në vendet e rajonit pjesë e marrëveshjes së *roaming*.

Figura 12: Të dhënat e përdorimit të internetit në roaming në BP (në GB)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga sipërmarrësit. Përpunimi AKEP.

Ndërkohë, përdorimi i internetit në *roaming* ka vijuar të rritet, duke arritur një nivel rreth 35% më të lartë në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024. Në një perspektivë më afatgjatë, trafiku i internetit mobil në *roaming* ka shënuar një rritje shumë të ndjeshme, nga rreth 25,487 GB në vitin 2020, në rreth 1.62 milionë GB në vitin 2025.

Në të kundërt, trafiku i SMS-ve ka pësuar rënie të fortë, nga 19.4 milionë mesazhe në vitin 2023 në rreth 2.95 milionë në vitin 2025, ndërsa trafiku i thirrjeve ka mbetur relativisht i balancuar, me thirrjet dalëse që përbëjnë rreth 55% të totalit.

Këto zhvillime reflektojnë një ndryshim strukturor në mënyrën e përdorimit të shërbimeve në *roaming*, ku komunikimi po zhvendoset drejt aplikacioneve dhe shërbimeve të bazuara në internet, duke reduktuar rolin tradicional të SMS-ve dhe, në një masë më të vogël, të thirrjeve zanore. Ky trend lidhet gjithashtu me politikat rajonale si “*Roam Like at Home*”, rritjen e përdorimit të shërbimeve digjitale dhe zgjerimin e lëvizshmërisë së përdoruesve.

Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritetit digjital rajonal dhe afrimit gradual me tregun digjital të Bashkimit Evropian.

2.4 Infrastruktura e rrjeteve të komunikimeve elektronike

2.4.1 Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike (ATLAS)

Sistemi ATLAS i AKEP është një regjistër elektronik që menaxhon dhe evidenton të dhënat mbi rrjetet fizike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë. Ai shërben si platformë qendrore për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe operatorëve të faciliteteve të këtyre rrjeteve për të raportuar dhe ndarë informacione mbi infrastrukturën e tyre duke përfshirë hartat gjeografike dhe të dhënat gjeohapsinore për infrastrukturën e tyre me qëllim optimizimin, bashkëpërdorimin dhe transparencën.

Ky sistem është vënë për herë të parë në punë në vitin 2015 dhe, duke patur parasysh ndryshimet dinamike teknologjike në fushën e komunikimeve elektronike, ka dalë e nevojshme prej kohësh zëvendësimi i tij me një sistem sipas kërkesave aktuale, përvojave më të mira në vendet anëtare të BEREC si dhe standardeve ndërkombëtare të vendosura nga ITU.

Pavarësisht kufizimeve aktuale gjatë kësaj periudhe, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike që mbështet sistemin ATLAS, përfshirë rritjen e kapaciteteve të pajisjeve (serverë, storage dhe burime përpunimi), si dhe optimizimin e performancës së aplikacionit dhe bazës së të dhënave. Këto ndërhyrje kanë sjellë rritje të ndjeshme të performancës së sistemit, duke përmirësuar kohën e përgjigjes, stabilitetin dhe aftësinë për të përballuar volume të mëdha të dhënash dhe kërkesash nga përdoruesit.

Aktualisht AKEP ka përfituar studimin e fizibilitetit nëpërmjet programit të investimeve në Ballkanin Perëndimor si dhe dokumentin e kërkesave funksionale nëpërmjet financimit nga ITU. Në kuadër të implementimit të projektit është koordinuar me programin EU4Digital të menaxhuar nga GIZ për përgatitjen e dokumentit të kërkesave teknike të projektit si dhe përgatitjen e dokumentit të tenderimit. Ajo që vlen për t'u theksuar është mungesa e financimit për këtë projekt pasi sipas studimit të fizibilitetit vetëm vlera e implementimit të këtij projekti shkon rreth 600 mijë Euro dhe, me gjithë mirëmbajtjen për 4 vjet, rreth 960 mijë Euro. Në kushtet aktuale të buxhetit të AKEP ky financim kërkon patjetër një mbështetje financiare jashtë këtij buxheti. Duke qenë se ky sistem nuk është si sistemet e tjera në përdorim të AKEP, por përdoret nga shumë aktorë të tjerë ku një rol të veçantë kanë MIE, bashkitë, ARRSH, FSHZH dhe operatorë të tjerë të faciliteteve për rrjetet e komunikimeve elektronike është parë e arsyeshme të kërkohet ndihma e MIE dhe donatorëve ndërkombëtare për financimin e këtij projekti të rëndësishëm.

Gjithashtu transpozimi në legjislacionin shqiptar i GIA (Gigabit Infrastructure ACT), me të cilin pritet ndryshimi i ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” kërkon domosdoshmërisht implementimin e këtij sistemi, duke mundësuar zbatimin e plotë të kuadrit ligjor.

2.4.2 Standardizimi i rrjeteve kabllore

AKEP në zbatim të kompetencave dhe detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, gjatë vitit 2025, ka zhvilluar takime takime/tryeza pune më të ngushta me përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Bashkisë Tiranë, Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP).

Në këto takime janë diskutuar problematikat e tregut që lidhen me bashkëpërdorimin e infrastrukturës pasive publike dhe private, zbatimin e kriterëve dhe standardeve teknike në ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me zhvillimin e rrjeteve *broadband* dhe sigurimin e të drejtës së kalimit e më gjerë, sistemimin e rrjeteve ajrore të cilët sjellin shqetësim jo vetëm nga pamja vizuale, por edhe nga pikëpamja e sigurisë dhe standardeve teknike, si dhe çështje të tjera.

AKEP ka hartuar një plan veprimi për sistemimin e kabllave ajrore, duke identifikuar dhe përcaktuar në këtë dokument masat administrative, teknike si dhe veprimet në terren që duhet të përmbushen nga palët e përfshira në këtë proces.

Kuadri ligjor ku mbështetet ky plan janë ligji nr. 107/2014 “Për zhvillimin e territorit”, ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe

sigurimin e së drejtës së kalimit”, ligji nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 55/2025 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa” si dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi.

Për të siguruar një ecure të qëndrueshme, me ndikim minimal në shërbimet ekzistuese, si dhe për të mundësuar një menaxhim të balancuar të burimeve teknike dhe njerëzore të përfshira në proces, plani i veprimit parashikon një periudhë zbatimi deri në 3 vjet, duke u ndarë në faza të njëpasnjëshme sipas zonave urbane të përcaktuara.

Plani i veprimit propozohet të realizohet me 2 faza:

- faza përgatitore, ku në fokus do të jetë koordinimi dhe bashkëpunimi midis aktorëve të përfshirë,
- faza implementuese, ku në fokus do të jetë zbatimi i planit të veprimit në terren.

Fillimisht plani i veprimit planifikohet të implementohet në qendrat e qyteteve, zonat me karakter turistik, zonat e rëndësisë së veçantë e duke u shtrirë gradualisht në të gjithë zonat urbane të bashkisë.

Implementimi në terren i planit të rrjeteve kabllore, kërkon domosdoshmërisht bashkëpunimin dhe ndarjen e përgjegjësisë të aktorëve dhe palëve të përfshira (bashki, operatorë, institucione publike etj.), sipas kompetencave përkatëse. Bashkitë si njësi të qeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm për shtrirjen dhe mbarëvajtjen e rrjeteve të telekomunikacioneve, konkretisht për shqyrtimin dhe miratimin ose refuzimin e kërkesave për dhënien e së të drejtës së kalimit dhe lejeve të ndërtimit për rrjetet e komunikimeve elektronike në pronat që janë nën administrimin e saj, si edhe për mbikëqyrjen dhe inspektimin e çdo ndërhyrjeje ndërtimore me leje ose pa leje në territorin publik lokal.


Në kuadër të masave të planit të sistemit, AKEP në muajin dhjetor 2025 ka zhvilluar një takim pune me përfaqësues të Bashkisë Tiranë, me fokus koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, ka përcjellë planin për sistemin dhe standardizimin e rrjeteve ajrore në zonat urbane të bashkisë dhe aktualisht jemi në proces koordinimi me këtë bashki për masat paraprake për implementimin e tij.

Më poshtë paraqitet lista e aktiviteteve të përcaktuara në planin e veprimit si dhe institucionet përgjegjëse për implementimin e tij.

AKTIVITETE NË FAZËN PËRGATITORE		
	Aktivitetet	Institucione përgjegjëse
1.	Institucioni për ndjekjen e procesit.	AKEP

2.	Përcaktimi nga bashkia i zonave ku do të zbatohet plani i veprimit duke filluar me qendrat e qyteteve, zonat me karakter turistik, zonat e rëndësisë së veçantë, e duke u shtrirë gradualisht në të gjithë bashkinë.	Bashki
3.	Evidentim i infrastrukturës pasive (kanale, tubacione, shtylla).	Bashki/ISP/AKEP
4.	Krijimi i tre grupeve teknike ad-hoc, për të ndjekur procesin	AKEP
5.	Njoftimi i operatorëve për fillimin e procesit dhe caktimin e personave të kontaktit.	AKEP

AKTIVITETET E FAZËS IMPLEMENTUESE		
	Aktivitetet	Institucionet përgjegjëse
1.	Heqja e shtyllave të vendosura pa leje dhe/ose jashtë kushteve teknike nga operatorët.	Bashki/ISP
2.	Heqja e kablllove ajrore nga shtyllat e OSSH, shtyllat e ndriçimit të vendosura pa leje/marrëveshje dhe/ose jashtë kushteve teknike nga operatorët.	OSSH/Bashki/ISP
3.	Sistemimi i kablllove ajrore në infrastrukturën nëntokësore ekzistuese të ndërtuar nga bashkitë, operatorët.	Bashki/ ISP/AKEP
4.	Sistemimi i kablllove aktive me anë të tubave/kanalinave në fasadat/pjesët e brendshme të pallateve.	Bashki/ ISP/AKEP
5.	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore, pikave të aksesit në godina aty ku mungon infrastruktura.	Bashki/ISP
6.	Sistemimi i kablllove në shtyllat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).	OSSH/ ISP/AKEP



KAPITULLI III: TREGU POSTAR

3.1 Ecuria e tregut postar. Panoramë e treguesve statistikore

Ecuria e tregut të ofrimit të shërbimeve postare në Shqipëri, është në linjë me ecurinë e zhvillimit në tregjet rajonale dhe ato të vendeve të BE-se, ku evidentohet se është bërë përmirësim në fushën e përafrimit të legjislacionit me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Spektori i shërbimeve postare rregullohet në bazë të ligji 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe rregullatore në zbatim të tij, si dhe merr në konsideratë aktet rregullatore të UPU-së, udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në dokumentet e politikave postare të hartuara dhe miratuara nga qeveria.

Bazuar në të dhënat e regjistrimit të autorizimeve për ofrimin e shërbimeve postare në Shqipëri përgjatë vitit 2025 rezultojnë 25 subjekte të pajisur me Autorizim të Përgjithshëm ku bën pjesë edhe Posta Shqiptare e cila është pajisur me Autorizim Individual për ofrimin e shërbimit universal në Shqipëri për një periudhë tjetër 5 vjeçare.

Spektori postar është një ndër sektoret e rëndësishëm të ekonomisë shqiptare dhe ndikon drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve jo vetëm në aspektin e marrjes dhe shpërndarjes së objekteve postare, por shërben edhe si një nga sektoret me numër të konsiderueshëm të punonjësve në vend, me rreth 3296.

Numri total i objekteve postare të pranuar gjatë vitit 2025 nga Posta Shqiptare sh.a., dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve postare ishte rreth 26.8 milionë, me një rritje me 6% krahasuar me vitin 2024.

Posta Shqiptare që është dhe operatori postar më i madh në vend, njëkohësisht ofrues i shërbimit universal postar, përgjatë vitit 2025 ka shënuar një rënie në volumin e zërit ‘Shërbim Universal’ me 10%, sikundër për zërin ‘Shërbimin Jo Universal’ është rritur me rreth 7% dhe po ashtu rritje ka shënuar edhe në zërin ‘Shërbimin Ekspres’ me rreth 17% krahasuar me vitin 2024.

Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura sa më poshtë, totali i objekteve postare për vitin 2025 është rritur në masën rreth 6% krahasuar me vitin pararendës, e ndikuar kjo nga rritja e konsiderueshme e objekteve postare të ofruesve të tjerë të shërbimit postar, ndërkohë Posta Shqiptare ka shënuar ulje të numrit të total të objekteve postare, e ndikuar kryesisht nga ulja në zërin ‘Shërbim Universal Postar’.

Tabela 13: Të dhëna përmblledhëse të volumit të shërbimeve postare (2020-2025)

Shërbime postare të ofruara		Objekte postare 2020	Objekte postare 2021	Objekte postare 2022	Objekte postare 2023	Objekte postare 2024	Objekte postare 2025	Ndryshim 2025/2024
Posta Shqiptare sh.a.								
1	Shërbim Universal Postar							
1.1	<i>Postë brenda vendit</i>	17,487,538	20,219,877	21,229,943	17,652,148	18,321,381	16,511,358	-10%
1.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	903,336	662,949	729,430	743,008	977,951	789,585	-19%
1.3	Totali 1.1+1.2	18,390,874	20,882,826	21,959,373	18,395,156	19,299,332	17,300,943	-10%
2	Shërbim JoUniversal postar							
2.1	<i>Postë brenda vendit</i>	873,512	301,052	406,700	402,014	366,523	391,816	7%
2.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	2,344	2,762	3,149	3,320	623	997	60%
2.3	Totali 2.1+2.2	875,856	303,814	409,849	405,334	367,146	392,813	7%
3	Shërbim ekspres							
3.1	<i>Ekspres brenda vendit</i>	486,531	669,874	541,210	491,782	473,872	554,350	17%
3.2	<i>Ekspres ndërkombëtar</i>	12,874	18,902	15,177	12,400	15,562	20,489	32%
3.3	Totali 3.1+3.2	499,405	688,776	556,387	504,182	489,434	574,839	17%
Ofruesit e shërbimeve postare								
4	Shërbim JoUniversal Postar							
4.1	<i>Postë brenda vendit</i>	1,914,761	1,757,313	956,465	457,644	746,641	746,998	0%
4.2	<i>Postë ndërkombëtare</i>	45,036	77,419	45,072	21,847	6,441	280,697	4258%
4.3	Totali 4.1+4.2	1,959,797	1,834,732	1,001,537	479,491	753,082	1,030,695	37%
5	Shërbim ekspres							
5.1	<i>Ekspres brenda vendit</i>	2,796,387	3,240,553	2,867,337	2,883,871	3,702,691	4,065,717	10%
5.2	<i>Ekspres</i>	272,860	268,528	267,416	442,779	814,684	3,473,143	326%

	ndërkombëtar							
5.3	Totali 5.1+5.2	3,069,247	3,509,081	3,134,753	3,326,650	4,517,375	7,538,860	67%
6	Totali 1.3+2.3.3.3+4.3+5.3	24,795,179	27,219,229	27,061,899	23,110,813	25,426,369	26,838,150	6%

Në totalin e objekteve të të gjithë ofruesve postarë për vitin 2025 zëri ‘Shërbimi Jo Universal Postar’ ka një rritje me 37%, i ndikuar kryesisht nga shërbimi ‘Postë Ndërkombëtare’ i cili ka njohur një rritje të konsiderueshme rreth 40 fish krahasuar me vitin 2024 (në 2024 janë raportuar 6441 objekte, në 2025 është 280,697 objekte), ndërsa shërbimi “Postë brenda vendit” është thuajse në të njëjtat shifra me vitin 2024. Edhe Shërbimi Ekspres ka rritje me 67% krahasuar me vitin 2024, ku ndikimin më të madh në këtë rritje e ka pasur zëri “Ekspres Ndërkombëtar” me një rritje të konsiderueshme prej 326% krahasuar me vitin 2024, kurse zëri “Ekspres brenda vendit”, ka një rritje me 10% krahasuar me vitin 2024.

3.2 Të ardhurat dhe investimet e tregut postar

Bazuar në raportimet e kryera nga ofruesit e shërbimeve postare që kanë ushtruar aktivitetet përgjatë vitit 2025, rezulton se këta sipërmarrës kanë gjeneruar rreth 4.1 miliardë lekë të ardhura nga këto shërbime, e cila përbën një rritje me rreth 48% krahasuar me periudhën pararendëse.

Në një vlerësim të integruar të volumit të shërbimeve postare në tregun shqiptar për vitin 2025, i mbështetur në kombinimin e të dhënave financiare me ato operationale mbi numrin e objekteve postare, vihet në pah një transformim strukturor i sektorit në raport me përdorimin e shërbimeve postare. Rritja e ndjeshme e të ardhurave nuk buron nga zgjerimi i shërbimeve tradicionale postare, por nga një zhvendosje graduale e aktivitetit drejt shërbimeve ekspres dhe atyre me vlerë të shtuar, të cilat lidhen ngushtë me zhvillimin e tregtisë elektronike, si dhe rritjen e kërkesës për shërbime të shpejt dhe të gjurmueshme. Kjo dinamikë shoqërohet me një ndryshim në strukturën e tregut, e cila në periudhat e mëparshme paraqitej relativisht më e përqendruar tek Posta Shqiptare, ndërsa sipas të dhënave të vitit 2025, struktura e shërbimit postar bëhet më konkurruese, ku operatorët e tjerë postarë arrijnë të përfaqësojnë rreth 66% të tregut, ndërsa Posta Shqiptare zbret në rreth 34%, duke mbetur megjithatë aktori kryesor si ofrues i shërbimit universal. Ky ndryshim nuk është vetëm një zhvendosje reale e pjesëve të tregut, por edhe një reflektim i realitetit konkurrues dhe i rolit në rritje të operatorëve të specializuar në shërbimet ekspres dhe përmirësimit të logjistikës së ofrimit të shërbimeve postare.

Figura 13: Pjesët e tregut të ofruesve të shërbimeve postare 2025 (Posta Shqiptare dhe ofruesit e tjerë postar)




Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare.

Struktura e tregut postar sipas të ardhurave dhe investimeve

Referuar të dhënave të raportuara për vitin 2025 nga ofruesit e shërbimeve postare, tregu i shërbimeve postare ka gjeneruar rreth 4,09 miliardë lekë, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2024. Peshën kryesore në këtë treg e mban Posta Shqiptare, me rreth 1,38 miliardë lekë, ndërsa pjesa tjetër prej rreth 2,71 miliardë lekësh i përket operatorëve të tjerë postarë.

Një analizë më e detajuar e strukturës së tregut për vitin 2025, e paraqitur në figurën në vijim, evidenton një shpërndarje të përqendruar të të ardhurave ndërmjet disa operatorëve kryesorë. Posta Shqiptare dominon me rreth 33,7% të tregut, duke reflektuar rolin e saj si ofrues i shërbimit universal dhe praninë e gjerë territoriale. Ndër operatorët privatë, DHL International (Albania) ka shënuar një rritje të konsiderueshme dhe për vitin 2025 zë një peshë të konsiderueshme prej rreth 28,2% të të ardhurave, çka tregon zhvillimin e segmentit të shërbimeve ekspres dhe ndërkombëtare, të lidhura ngushtë me rritjen e tregtisë dhe logjistikës. Operatorë të tjerë si Ultra C.E.P. (7,6%) dhe United Transport (Uni Trans) (7,5%) mbajnë një pozicion të ndërmjetëm në treg, ndërsa Albanian Delivery Express sh.p.k., me 5,2% përfaqëson një pjesë më të kufizuar, por gjithsesi të qëndrueshme. Pjesa e mbetur prej 17,8% i përket operatorëve më të vegjël, duke treguar se, megjithëse tregu dominohet nga disa aktorë kryesorë, ekziston ende një nivel i caktuar fragmentimi në segmentet periferike. Kjo strukturë tregon një treg në fazë konsolidimi, ku operatorët me kapacitete më të mëdha dhe rrjete më të zhvilluara po rrisin gradualisht pjesën e tyre.

Figura 14: Pjesët e tregut sipas të ardhurave ndërmjet disa operatorëve kryesorë




Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare.

Nga këndvështrimi operativ, të dhënat mbi volumin e objekteve postare e mbështesin plotësisht këtë interpretim. Volumi i shërbimit universal postar ka pësuar rënie, me një tkurrje rreth 10% në total, ku posta brenda vendit dhe ajo ndërkombëtare shënojnë rënie respektivisht rreth 10% dhe 19%. Kjo tendencë reflekton ndikimin e drejtpërdrejtë të digjitalizimit dhe zëvendësimit të komunikimit tradicional fizik me forma elektronike. Në të njëjtën kohë, shërbimet ekspres kanë shënuar rritje të qëndrueshme, me rreth 17% në total dhe me një performancë edhe më të fortë në segmentin ndërkombëtar, duke arritur deri në 32%. Kjo tregon qartë se kërkesa po zhvendoset drejt shërbimeve me kohë të shpejtë dorëzimi dhe me vlerë më të lartë për njësi shërbimi.

Në këtë kontekst, rritja e të ardhurave është drejtpërdrejt e lidhur me këtë ndryshim të strukturës së volumit. Edhe pse numri i objekteve në segmentin tradicional është në rënie, të ardhurat rriten për shkak të peshës në rritje të shërbimeve ekspres dhe pakove postare, të cilat kanë çmime më të larta dhe krijojnë më shumë vlerë të shtuar. Pra, tregu po kalon nga një model i bazuar në volum të lartë dhe të ardhura të ulëta për njësi, drejt një modeli ku edhe me volum relativisht më të moderuar, gjenerohen të ardhura më të larta për shkak të natyrës së shërbimeve.

Ilustrimi për sa më sipër, reflektohet me figurën në vijim, ku pasqyrohen pjesët e tregut të shërbimeve postare në raport me volumin e të ardhurave në vitin 2025.

Figura 15: Pjesët e tregut sipas të ardhurave të shërbimeve postare 2025




Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare.

Posta Shqiptare ka shënuar një rënie të lehtë me 1.85% krahasuar me vitin 2024, gjithsesi vazhdon të jetë sipërmarrësi me pjesën më të madhe të të ardhurave në fushën e ofrimit të shërbimeve postare. Duhet theksuar se Posta Shqiptare është përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP edhe si ofrues i Shërbimit Universal Postar, shërbim nga i cili gjeneron edhe pjesën më të madhe të të ardhurave të saj. Ndërsa shërbimi universal, që përbën bazën tradicionale të aktivitetit të saj, është në rënie, shërbimet ekspres dhe ato jo-universale po rriten, duke treguar një orientim gradual drejt segmenteve më dinamike të tregut. Megjithatë, kjo zhvendosje nuk ka arritur ende të kompensojë plotësisht rënien e volumit tradicional, çka shpjegon edhe rënien e të ardhurave dhe humbjen e peshës relative në treg. Ndërkohë, operatorët e tjerë postarë kanë zgjeruar ndjeshëm aktivitetin në segmentin e shërbimit jo-universal dhe ekspres, duke rritur volumin e dërgesave të pakove postare, veçanërisht atyre të lidhura me tregtinë elektronike. Ky zgjerim është shoqëruar edhe me zhvillimin e rrjeteve të shpërndarjes, përmirësimin e kapaciteteve logjistike dhe rritjen e efikasitetit operacional, duke rritur ndjeshëm aftësinë e tregut për të përballuar kërkesën në rritje për shërbime të shpejta dhe fleksibël.

Përgjatë vitit 2025, sipërmarrësit e ofrimeve postare kanë raportuar se kanë investuar rreth 326 milionë lekë në përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit të shërbimeve postare, dhe që përbën një rritje me rreth 9% krahasuar me vitin 2024. Pjesa më e madhe e investimeve është kryer nga sipërmarrësi Posta Shqiptare me rreth 30.7%.

Në tabelën në vijim paraqitet vlera e investimeve të kryera nga Posta Shqiptare kundrejt investimeve të raportuara nga ofruesit e tjerë të shërbimeve postare.

Figura 16: Investimet në vite nga Posta Shqiptare dhe Ofruesit e tjerë (2021-2025)



Burimi: Të dhëna të raportuara në AKEP nga ofruesit e shërbimeve postare.

3.3 Statusi i Shërbimit Universal Postar

AKEP si organ rregullator në fushën e shërbimeve postare, ndër të tjera, ka detyrimin për të përcaktuar ofruesin e shërbimit universal postar në përputhje me ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore dhe rregullat për ofrimin e shërbimit postar dhe shërbimit universal postar.

Duke qenë se autorizimi 5-vjeçar i Postës Shqiptare sh.a., i dhënë në vitin 2020, përfundonte më 7 korrik 2025, AKEP nisi procedurat ligjore për vlerësimin e tregut që në fillim të vitit 2025. Ky proces u bazua në një metodologji rigoroze që vlerëson jo vetëm performancën e deritanishme, por edhe kapacitetet tekniko-ekonomike të të gjithë operatorëve të licencuar në vend, për të evidentuar mundësinë e ofrimit të shërbimit universal nga operatorë të tjerë potencial pjesë e tregut. Dokumenti "Analizë e Tregut të shërbimeve postare" shërbeu si baza për të përcaktuar nëse tregu ishte gati për të mbajtur më shumë se një ofrues të shërbimit universal. Analiza mori në konsideratë përcaktimet ligjore si edhe parashikimet që lidhen me densitetin e rrjetit të kërkuar nga VKM nr. 239/2018, kërkesat për mbulim territorial dhe aftësinë financiare për të përballuar ofrimin e shërbimit universal postar edhe në zonat jo-fitimprurëse.

Në zbatim të përcaktimeve ligjore AKEP me Vendimit nr. 6, datë 19.5.2025, miratoi dhe nxori për Këshillim Publik dokumentin “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal”. Miratimi i këtij dokumenti iu njoftua palëve të interesuara kryesore, sipërmarrësve të shërbimeve postare, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetit të Konkurrencës, si dhe u publikua në faqen e internetit të AKEP për këshillim publik për një periudhë 30 ditore, në datat 19 maj – 18 qershor 2025.

Në përfundim të procesit të Këshillimit Publik, si edhe vlerësimeve të AKEP, rezultoi se Posta Shqiptare sh.a., mbetet i vetmi operator që plotëson kushtet ligjore dhe teknike për të mundësuar ofrimin e shërbimit universal postar. Si rrjedhojë, Këshilli Drejtues i AKEP, duke marrë në konsideratë edhe të gjithë faktorët e analizuar në dokumentin e analizës, miratoi dokumentin përfundimtar nëpërmjet të cilit miratoi zgjatjen e afatit të autorizimit ekzistues dhe lëshimin e autorizimit të ri individual për subjektin Posta Shqiptare sh.a. Kështu AKEP me VKD nr.17, datë 14.10.2025, ka pajisur Postën Shqiptare me Autorizim Individual, “Për ofrimin shërbimit Universal Postar” për një periudhë 5-vjeçare, akt nëpërmjet të cilit sigurohet vazhdimësia e shërbimit pa ndërprerje të shërbimit universal postar pas datës 7 korrik 2025. Autorizimi i ri nuk është thjesht një formalitet, por përmban detyrime të qarta për modernizimin e rrjetit, rritjen e cilësisë së shpërndarjes dhe mbajtjen e tarifave në nivele të përballueshme, duke synuar formalizmin e mëtejshëm të tregut dhe mbrojtjen e plotë të nevojave të përdoruesve shqiptarë në epokën digjitale.

Treguesit kryesorë të Shërbimit Universal Postar


Posta Shqiptare sh.a., është ofruesi i vetëm i Shërbimit Universal Postar. Pikat e kontaktit që Posta Shqiptare ka në dispozicion të publikut për ofrimin e shërbimit universal përgjatë vitit 2025 paraqiten si më poshtë:

- 530 Zyra postare të hapura për publikun;
- 668 Sportele, nga të cilët 598 të automatizuar/kompjuterizuar;
- 740 Kuti postare për pranimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve;
- 286 Kuti postare për dorëzimin e objekteve postare, në dispozicion të përdoruesve.

Nëse flasim për infrastrukturën e automjeteve postare, Posta Shqiptare ka në përdorim 181 mjete transporti. Këto mjete përfshijnë motoçikleta (105), furgona (67), vetura (9), etj.

Gjatë viti 2025, numri total i objekteve postare të shërbimit universal pati rënie me 10%, duke shkuar në 17.3 milionë objekte. Peshën më të madhe në këtë shërbim e zë Postë Brenda Vendit me 95%, ndërsa Postë Ndërkombëtare zë 5% të totalit.

Figura 17: Ecuria e numrit të objekteve të Shërbimit Universal Postar (2021-2025)



Burimi: Të dhënat nga “Posta Shqiptare” sh.a. (2025)

Cilësia e shërbimit universal postar të Posta Shqiptare

Në lidhje me realizimin vjetor, treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar brenda qytetit për periudhën janar-dhjetor 2025 është realizuar 96.6% në D+1, nga 95% që është standardi i miratuar nga AKEP. Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar ndërmjet qyteteve për periudhën janar-dhjetor 2025 është realizuar 97% në D+1, nga 85% që është standardi i miratuar nga AKEP. Treguesi i performancës së cilësisë së shërbimit universal postar ndërmjet fshatrave për periudhën janar-dhjetor 2025 është realizuar 83.5% në D+2, nga 60% që është standardi i miratuar nga AKEP.

Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të Autorizimit Individual për ofrimin e shërbimit universal postar

Në kuadër të detyrimeve të përcaktuara në Autorizimin Individual, në muajin dhjetor 2025 AKEP i kërkoi Postës Shqiptare informacion mbi përmbushjen e parashikimeve të Autorizimit Individual për ofrimin e Shërbimit Universal dhe ecurinë e plotësimit të rekomandimeve të lëna nga AKEP në inspektimet e mëparshme. Në përgjigjen e saj, PSH ka paraqitur informacion mbi realizimin e treguesve të cilësisë së shërbimit, si edhe informacion mbi statusin e realizimit të rekomandimeve për dorëzimin e pakove në adresë dhe ndarjen e llogarive.

- Në përgjigjen e saj, ashtu si edhe në takimet dhe korrespondenca të mëparshme, Posta Shqiptare ka sjellë në vëmendje shqetësimin që lidhet me tarifat e ofrimit të shërbimit universal postar, të cilat janë miratuar me VKM nr.446, datë 22.9.2002, “Për miratimin e tarifave postare të shërbimeve bazë”. Këto tarifa kanë qenë objekt i rishikimeve dhe ndryshimeve të pjesshme në vitin 2014 (vetëm për objektet postare për jashtë shtetit që dërgohen me rrugë ajrore, si edhe shërbimet e veçanta kombëtare dhe ndërkombëtare të miratuara me VKM nr.24, datë 17.6.2014, të Këshillit Mbikëqyrës të PSH. Ndërkohë tarifat e shërbimit universal postar brenda vendit janë të pandryshuara që nga viti 2002.

- b. Për sa i përket shpërndarjes së pakove në adresën e marrësit, evidentohet se dorëzimi mbetet në të njëjta nivele me periudhat e mëparshme rreth 41%, ku impaktin më të madh e jep mosdorëzimi në adresë në Tiranë dhe në Vlorë. Dhe arsyeja kryesore sipas Postës Shqiptare mbetet problematika e sistemit të adresave dhe mungesa e kontaktit të klientit mbi objektin postar. Gjithashtu, sipas Postës Shqiptare vërehet edhe rritje e kërkesës së klientëve për tërheqjen e pakove pranë zyrave postare, si një alternativë më fleksibël në kushtet e mungesës së disponibilitetit të tyre në momentin kur korrieri tenton shpërndarjen. Një faktor tjetër përmendet edhe mungesa e mjeteve të transportit për vitin 2025, e ndikuar nga përfundimi i kontratës së leasing për automjetet dhe motorët e shpërndarjes.
- c. Për sa i përket detyrimit të ndarjes së llogarive, Posta Shqiptare informon se në programin financiar të saj 'Eterna' është arritur të identifikohen dhe regjistrohen të gjitha zërat e SHU, përfshirë edhe objektet e thjeshta të ndara sipas grup-peshave dhe të ardhurave për secilin zë. Ka filluar gjenerimi i raporteve mujore nga programi 'Eterna' dhe aktualisht është realizuar përlllogaritja e pagave të punonjësve sipas vendit të punës në të gjitha degët dhe filialet e shoqërisë, duke qenë se shpenzimet e pagave dhe sigurimet zënë peshën kryesore në totalin e shpenzimeve dhe që do të jenë të domosdoshme për llogaritjet në përputhje me rregulloren 41/2016 të AKEP. Gjithashtu, i është kërkuar firmës zhvilluese (Helius) që të identifikojë të ardhurat nga të gjitha zërat e shërbimit postar universal duke i lidhur me llogaritë përkatëse sipas listës së paraqitur në udhëzim. Është dakordësuar me firmën zhvilluese Helius që shpenzimet e amortizimit të llogariten direkt nga sistemi dhe PSH është në pritje të realizimit të kërkesës duke konsideruar që shpenzimet e amortizimit zënë një peshë të rëndësishme në shpenzimet totale.

AKEP gjatë vitit 2025 ka zhvilluar disa takime dhe diskutime me Postën Shqiptare. Në cilësinë e ofruesit të Shërbimit Universal Postar, AKEP i kushton rëndësi të veçantë plotësimit të detyrimeve që ka Posta Shqiptare për të mundur garantimin e shërbimit universal postar të përballueshëm dhe me cilësi për të gjithë qytetarët e Shqipërisë.

Një nga rekomandimet kryesore të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për veprimtarinë e AKEP gjatë vitit 2025 është monitorimi i ecurisë së përmirësimit të shërbimit dhe përmbushjes së detyrimit të Postës Shqiptare për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit.

Në muajin korrik 2025 pranë ambienteve të AKEP u mbajt një takim konsultativ, me pjesëmarrës nga AKEP, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Posta Shqiptare, ku fokusi kryesor konsistonte në përmbushjen e detyrimeve rregullatore të vendosura në Autorizimin Individual dhe hapësirat për rishikimin e tarifave të shërbimit universal postar në RSH.

Takim i cili u pasua nga një takim tjetër në muajin shkurt 2026, në të cilin u risoll në vëmendje shqetësimi i mosndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit universal postar, duke sjellë efekte të drejtpërdrejta negative në financat e Postës Shqiptare, dhe aftësive të saj për të kryer investimet e nevojshme.

Në vijim të shqetësimeve për mungesën e ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit universal postar, Posta Shqiptare nëpërmjet një shkrese drejtuar AKEP ka kërkuar rishikim të tarifave për një pjesë të shërbimeve postare universale duke evidentuar se rritja e këtyre tarifave të bëhet së paku duke u bazuar në një pjesë të efektit të inflacionit që nga periudhat e mëparshme.

Në këtë kuadër, me shkresën nr. 763, datë 3.4.2026, Posta Shqiptare ka njoftuar në AKEP se Këshilli Mbikëqyrës i Postës Shqiptare ka miratuar me vendim indeksimin e inflacionit për disa nga tarifat e shërbimeve postare universale dhe jouniversale për brenda vendit dhe jashtë vendit.

AKEP, ka administruar informacionin e ardhur nga Posta Shqiptare lidhur me njoftimin e miratimit të këtyre tarifave, dhe në përputhje me ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë” është në proces të vlerësimit të tyre në përputhje me përcaktimet e ligjit 46/2015 dhe akteve nënligjore për këtë shërbim.

3.4 Transparenca në tarifat e pakove postare ndërkufitare

Në kuadër të rritjes së transparencës mbi tarifat që aplikojnë ofruesit e shërbimeve ndërkufitare, duke lehtësuar proceset dhe kostot e tregtisë elektronike midis vendeve të rajonit të CEFTA dhe BE-së, AKEP është angazhuar në mbledhjen e informacionit nga ofruesit e shërbimeve postare ndërkufitare, si edhe publikimin në faqen e internetit të raporteve me përmbledhjen e tarifave të ofruesve të këtyre shërbimeve. Procesi i evidentimit dhe vlerësimit të tarifave të shërbimeve të dorëzimit të pakove postare ndërkufitare ka ardhur si kërkesë dhe nevojë e përafrimit të legjislacionit vendas me atë të BE-së në këtë fushë. Në këtë kuadër MIE ka nxjerrë dy udhëzime, Udhëzimi nr. 5, datë 25.6.2021, i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, “*Për miratimin e rregullave mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare*” dhe Urdhri nr.425, datë 12.11.2021, “*Për “Miratimin e metodologjisë për vlerësimin e tarifave të dërgesave të pakove ndërkufitare*”, që transpozojnë përkatësisht direktivat e BE, Nr. 2018/644/EU, datë 18.4.2018, “*Mbi shërbimet e dërgesave të pakove postare ndërkufitare*” dhe 2018/1263 të Komisionit Evropian.

Sipas përcaktimeve të Udhëzimit të MIE nr. 5/2021, në funksion të transparencës dhe informacionit për konsumatorët/përdoruesit e shërbimit postar, AKEP në muajt janar - shkurt 2026 ka mbledhur dhe publikuar raportin e katërt radhazi për tarifat e shpërndarjes së pakove postare ndërkufitare të cilat gjenden në linkun <https://akep.al/publikime/tarifa/>. Ky proces është i rëndësishëm, pasi plotëson jo vetëm detyrimin për harmonizim të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Evropian, por njëkohësisht ndihmon në rritjen e transparencës dhe mundësisë së krahasimit të tarifave për marrjen e shërbimit postar ndërkombëtar.

Gjithashtu, në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit të MIE nr. 5/2021, AKEP ka përgatitur dhe përcjellë në MIE raportin e vlerësimit për tarifat e pakove postare ndërkufitare për vitin 2025, mbi bazën e të cilit nuk janë evidentuar tarifa ekseseve të larta të cilat mund të jenë objekt i shqyrtimit për rishikim nga institucionet e fushës së shërbimit postar. Krahasimi i tarifave të

Postës Shqiptare si ofrues i Shërbimit Universal Postar është bërë me tarifat e operatorëve postarë që ofrojnë shërbimin universal në vendet e rajonit.

Vlen të theksohet, se gjatë takimeve të zhvilluara dhe koordinuara nga CEFTA, është evidentuar se vetëm Shqipëria ka përparuar dhe ka kryer transpozimin e direktivave të BE-së (direktivat Nr. 2018/644/EU dhe 2018/1263 të Komisionit Evropian), gjë për të cilën AKEP, në përputhje me udhëzimet e MIE ka ndërmarrë masat për evidentimin e ofruesve të shërbimeve postare të pakove postare ndërkufitare të cilët përmbushin kriteret e përcaktuara në udhëzimin e MIE dhe më pas ka vijuar me publikimin e tarifave të tyre në ëeb faqen e AKEP-it.

Duke marrë në konsideratë se procesi i vlerësimit të tarifave të pakove postare ndërkufitare në vetvete është një proces me komponentë kompleks, gjatë takimeve me ekspertë të CEFTA dhe GIZ, nga përfaqësuesit e institucionit të AKEP është kërkuar asistencë dhe trajnim për vlerësimin e një procesi të tillë, si edhe përcjellja nga ana e tyre e praktikave më të mira të ngjashme.

KAPITULLI IV: LICENCIMI, AUTORIZIMI DHE ADMINISTRIMI/MENAXHIMI I BURIMEVE TË FUNDME

4.1 Administrimi dhe menaxhimi i frekuencave

Administrimi dhe menaxhimi i frekuencave radio është një nga shtyllat kryesore të veprimtarisë së AKEP-it. Spektri radio është një burim i kufizuar me vlerë ekonomike, ku mbështeten shërbime të komunikimeve elektronike, si shërbimet e lëvizshme, aeronautike, detare, satelitore, radioamatore etj.

Edhe gjatë vitit 2025, AKEP ka ndjekur praktikat dhe aplikimet *online* për pajisje me Autorizime Individuale për përdorimin e frekuencave, modifikime dhe revokime.

Gjatë vitit raportues kanë ofruar shërbime telefonike të lëvizshme dhe shërbime *broadband* në rrjetet mobile 2 operatorë: Vodafone Albania sh.a., dhe One Albania sh.a., (operatori i ri i krijuar pas bashkimit të Albtelecom me One Telecommunications), të pajisur nga AKEP me Autorizime Individuale për përdorim frekuencash në brezat GSM/UMTS/IMT/LTE/5G (800/900/1800/2100/2600/3400-3800 MHz), të njohura si teknologjitë 2G/3G/4G/5G.

Bazuar në vlefshmërinë e Autorizimeve Individuale të lëshuara nga AKEP ndër vite, gjatë vitit 2025 është administruar kërkesa e Vodafone Albania për rinovimin e brezit 2100 MHz, me sasi 2x15 MHz.

Konkretisht, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a. është autorizuar nga AKEP me VKD nr. 1453, datë 12.1.2010, "Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave në brezin 1920-1935 MHz çiftuar me 2110-2125 MHz dhe 1900-1905 MHz spektër i pa çiftuar për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, për të ofruar shërbime të lëvizshme tokësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë", me afat vlefshmërie deri më 31.12.2025, i ndryshuar.

Duke qenë se në dhjetor 2025 përfundonte afati i vlefshmërisë së këtij autorizimit, sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., në zbatim të akteve ligjore në fuqi, më datë 15.10.2025 ka shprehur interes për rinovimin e të drejtave të përdorimit të spektrit në brezin 2100 MHz (2x 15 MHz) dhe më datë 31.10.2025 ka depozituar në AKEP aplikimin me dokumentacionin përkatës lidhur me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Autorizimin Individual të sipërcituar.

Në vijim, titullari i AKEP, mbështetur në nenin 67 dhe 70 e në vijim të Kreut IX – Qasja në Spektrin e Radiofrekuencave të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM nr. 496, datë 22.7.2014 për "Miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim", ngriti Grupin e Punës me urdhër nr. 315, datë 4.11.2025, me qëllim zhvillimin e procedurës për

vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a.

Me vendim nr. 25, datë 14.11.2025, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar Raportin Përmbledhës të vlerësimit mbi përmbushjen e të gjitha kushteve të përdorimit të frekuencave të brezit 2100 MHz, nga sipërmarrësi “Vodafone Albania” sh.a., shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual.

Në zbatim të pikës 7, të Kreut II, të VKM nr. 496/2014, i ndryshuar, Raporti Përmbledhës i Vlerësimit të Grupit të Punës, shoqëruar me propozimin mbi çmimin referencë minimal për rinovimin e Autorizimit Individual, i është dërguar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, për vijimin e procedurave të mëtejshme, të përcaktuara në këtë VKM.

Me vendim nr. 32, datë 22.12.2025, Këshilli Drejtues i AKEP ka miratuar “Shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së autorizimit individual të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar)”, deri në përfundimin e procesit të negociimit.

Me Urdhrin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 18, datë 13.1.2026, është ngritur Komisioni *ad-hoc* për negociimin dhe rinovimin e autorizimit individual të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “Vodafone Albania” sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz. Bazuar në negociimet e zhvilluara, në takimet negociatore të datës 21 janar dhe 27 janar 2026, palët nënshkruan Aktin Përfundimtar me nr. 343/6, datë 4.2.2026, për mbylljen e procesit të negociimit midis Komisionit *Ad Hoc* dhe sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., pa Akt Dakordësie, pasi palët nuk kanë arritur marrëveshje mbi çmimin minimal të propozuar.

Në zbatim të pikës 1 të Kreut IV, të VKM-së nr. 496, datë 22.7.2014, “Për miratimin e rregullave e të procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”, AKEP me vendimin nr. 6, datë 13.3.2026, procedoi me mosrinovimin e Autorizimit Individual për sipërmarrësin “Vodafone Albania” sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar). KD i AKEP në këtë vendim gjithashtu vendosi lirimin e brezit të frekuencave 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar dhe 5 MHz, i paçiftuar), miratuar me VKD nr. 1453, datë 12.1.2010, të ndryshuar, nga ana e sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., brenda një periudhe kohore prej 6 muaj nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

AKEP, në zbatim të nenit 75, të ligjit nr. 54/2024 dhe VKM nr. 70, datë 6.2.2026 “Për miratimin e rregullave mbi procedurën e konkurrimit publik për dhënien e autorizimeve individuale”, në vijim do të kryejë një proces Këshillimi Publik me palët e interesuara për kushtet e përdorimit të këtij brezi frekuencash dhe procedurën që do të zbatohet për alokimin e brezit 2100 MHz.

Sa i takon **përdorimit të frekuencave në lidhje fikse (pikë-pikë)**, për operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2025 janë lëshuar Autorizime Individuale për 32 lidhje fikse të reja dhe 74 lidhje fikse të ndryshuara (në total 106 lidhje fikse). Janë revokuar Autorizimet Individuale për 122 lidhje fikse.

Bazuar në këto aplikime, në krahasim me vitin 2024, vihet re një rënie e numrit të lidhjeve fikse pikë-pikë të operatorëve të rrjeteve mobile. Kjo për shkak se rrjetet 5G kërkojnë kapacitet shumë më të lartë dhe latencë më të ulët. Këto kërkesa përmbushen më mirë nga fibra optike, e cila ofron stabilitet dhe shpejtësi më të madhe. Si rezultat, operatorët kanë orientuar investimet drejt fibrës, ndërsa lidhjet mikrovalore përdoren kryesisht si zgjidhje plotësuese ose në zona ku fibra mungon.

Sa i takon përdorimit të frekuencave në sisteme PMR radiokomunikimi/radioalarmi, gjatë vitit 2025, janë konfirmuar 130 aplikime, nga të cilat 108 aplikime për sisteme të reja, 11 aplikime për ndryshime në autorizimin ekzistues dhe 11 aplikime për revokimin e frekuencave.

Gjithashtu, bazuar në Rregullat “Mbi regjistrimin e detyrueshëm në AKEP të frekuencave të brezit 2.4/ 5.8 GHz që mund të përdoren pa Autorizim Individual”, janë trajtuar aplikimet e sipërmarrësve për regjistrim të pajisjeve radio që operojnë në brezat 2.4/ 5.8 GHz. Nëpërmjet sistemit të aplikimeve *online*, janë kryer 15 regjistrime për pajisje radio akses pointe që operojnë në brezin 2.4/5.8 GHz, nga 1 sipërmarrës i rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike. Bazuar në rregulloren e sipërcituar, këto frekuenca përdoren pa autorizim individual, por sipërmarrësit kanë detyrimin t’i regjistrojnë në AKEP, përpara fillimit të përdorimit të tyre dhe t’i çregjistrojnë kur heqin dorë nga përdorimi i tyre.

AKEP në mbështetje të aktivitetit ndërkombëtar të ciklizimit (Edicionit të 108-të të Giro d’Italia) që u zhvillua në Shqipëri në datat 9-11 maj 2025, ka lëshuar autorizim individual të përkohshëm për shërbimin PMSE (Programme Making and Special Events), për të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë. Ky aktivitet pati një vëmendje të gjerë mediatike. Përveç dimensionit sportiv, ky event promovoi turizmin, kulturën dhe bukuritë natyrore të Shqipërisë. Organizimi kërkoi bashkëpunim ndërinstitucional midis AKEP-it, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe organizatorëve të huaj të Giro d’Italia, ku AKEP garantoj dhënien e përdorimit të frekuencave brenda afateve të ngushta të aplikimit, duke siguruar përdorimin eficient dhe pa interferenca të brezit frekuencor të kërkuar.

Lirimi i brezit 700 MHz (DD2)

Brezat kryesorë të frekuencave 5G janë brezi 700 MHz (694-790 MHz), brezi 3400-3800 MHz dhe brezi 26 GHz (24.25-27.5 GHz). Brezi 700 MHz është nën administrimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe do të kalojë nën administrimin e AKEP-it menjëherë pas lirimit nga AMA. Ky brez frekuencash aktualisht vijon të përdoret nga disa media audiovizive.

Brezi 700 MHz mbetet prioritet dhe me vëmendje të lartë për AKEP-in. Menjëherë pas liritimit nga AMA, AKEP do të fillojë procedurat për dhënien në përdorim të këtij brezi frekuencash për operatorët celularë.

Brezi 700 MHz (694-790 MHz), teknikisht është brezi më i mirë i frekuencave për ndërtimin e rrjeteve 5G, veçanërisht për shkak se frekuencat e këtij brezi realizojnë mbulim shumë të mirë me një numër të caktuar stacionesh (antenash).

Lirimi sa më shpejt i këtij brezi frekuencash do të krijojë mundësinë e mbulimit më të shpejtë të gjithë territorit të vendit me rrjet 5G, por do të shmangen edhe problematikat e interferencave që transmetuesit e mediave audiovizive iu shkaktojnë operatorëve 5G në zonat kufitare me shtetet fqinje, madje edhe me vende të BE-së si me Greqinë, Italinë dhe Kroacinë.

Për brezin 26 GHz, operatorët celularë janë shprehur që nuk kanë interes për shkak të mbulimit të vogël që sigurojnë antenat e këtij brezi frekuencash dhe numrit të madh të antenave që nevojiten për të siguruar mbulimin e nevojshëm.

Koordinimi ndërkombëtar i frekuencave

Gjatë vitit 2025, janë ndjekur dhe zbatuar procedurat e koordinimit ndërkombëtar të frekuencave në përputhje me pikën 9.17 të Rregullores së Radiokomunikimeve (RR), për shërbimet satelitore.

Përkatësisht janë administruar kërkesat e administratës së Greqisë për njoftimin e caktimeve të frekuencave në stacionet satelitore si më poshtë:

- PSACHNA Stacion Tokësor
- DUTH_GS Stacion Tokësor
- FIRELINK_LAVRION Stacion Tokësor
- DUTH_GS dhe LAROS_GROUND_UNIT Stacion Tokësor

AKEP ka realizuar analiza teknike dhe rregullatore dhe ka përgatitur qëndrimet përkatëse, duke garantuar mbrojtjen e caktimeve ekzistuese kombëtare dhe shmangien e interferencave të dëmshme.

Gjithashtu, është trajtuar edhe kërkesa e administratës turke për përfshirjen e territorit të Republikës së Shqipërisë në zonën e shërbimit të rrjetit satelitor TURKSAT-42E-FSS-4 (42°E), në zbatim të pikës 6.6 të Shtojcës 30B të Radio Rregullores (RR) së ITU. ITU pas analizave të kryera sipas dispozitës 6.5 të Shtojcës 30B të RR, ka konkluduar se rrjeti satelitor TURKSAT-42E-FSS-4, nuk afekton allotmentin tonë. Në këto kushte, në mbështetje të pikave 3 dhe 4, të nenin 9, të ligjit 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe praktikave të vendeve të tjera lidhur me këtë procedurë, AKEP i ka përcjellë për kompetencë

MIE kërkesën e Autoritetit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit të Turqisë për përfshirjen e territorit të Republikës së Shqipërisë, në zonën e ofrimit të shërbimit të rrjetit satelitor TURKSAT-42E-FSS-4.

Ndërkohë nga i njëjti rrjet satelitor TURKSAT është administruar kërkesa e kësaj të fundit për ofrimin e shërbimit IFC (*In -Flight Connectivity*) në Republikën e Shqipërisë. Ky shërbim do të ofrohej nga satelitët TURKSAT dhe jashtë mbulimit të tyre nga satelitët Eutelsat S.A.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultoi se:

- shërbimi i In-Flight Connectivity (IFC) i ofruar nga TURKSAT operon në përputhje me Radio Rregulloret e ITU-së, kuadrin rregullator të harmonizuar evropian, si dhe ECC Decision (13)01.
- Aero-terminalet operojnë brenda brezave të frekuencave 17.7–20.2 GHz (nga hapësira drejt Tokës) dhe 27.5–30.0 GHz (nga Toka drejt hapësirës), siç përcaktohet në Vendimin ECC (13)01;
- Terminalet janë të instaluar në bord të avionëve të regjistruar jashtë vendit dhe janë të autorizuar në mënyrë të rregullt nga autoritetet kompetente të shtetit të regjistrimit të avionit;
- Aero-terminalet nuk krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë me rrjetet publike kombëtare të komunikimeve elektronike brenda Republikës së Shqipërisë, dhe i gjithë trafiku i internetit transmetohet përmes lidhjeve satelitore dhe infrastrukturës tokësore të vendosura jashtë territorit shqiptar.

Sa më sipër, AKEP nuk ka paraqitur kundërshtim, nga perspektiva e menaxhimit të spektrit dhe rregullimit të komunikimeve elektronike, ndaj operimit të aero-terminaleve IFC të sipërpërmendura në bord të avionëve të regjistruar jashtë vendit, gjatë fluturimit mbi territorin ose gjatë operimit brenda hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Administrimi dhe menaxhimi i numeracionit

AKEP-i në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi siguron burime të përshtatshme numerike për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun, sipas planit të numeracionit. Plani i numeracionit përcakton strukturën, gjatësinë dhe caktimin e numrave për akses në rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve publike.


Bazuar në planin kombëtar të numeracionit, AKEP-i jep të drejta përdorimi për burimet e numeracionit për ofrimin e shërbimeve specifike për sipërmarrje të ndryshme nga ofruesit e rrjeteve apo shërbimeve të komunikimeve elektronike.

4.2.1 Alokime/anulime numeracioni 2025

Gjatë viti raportues janë përpunuar dhe procesuar:

- Alokime numra, kode dhe seri numerike, janë alokuar 17 numeracione (seri numerike, nr. i gjelbër, SMSVAS, NSPC, kod rrugëzimi);
- Anulime të kërkuara nga vetë subjektet/sipërmarrësit: 5 anulime (seri numerike, nr. i gjelbër, SMSVAS, NSPC, kod rrugëzimi).

Figura 18: Caktime, anulime të kodeve dhe numrave gjatë vitit 2024-2025



Për çdo caktim numeracioni fiks, kodi portabiliteti, kodi NSPC, ISPC apo dhe për çdo anulim të numeracioneve të tilla, janë kryer procedurat që caktimet/anulimet të pasqyrohen në Databazën e Portabilitetit (DBRC).

4.2.2 Numri i emergjencës 112

Gjatë vitit 2025 AKEP-i ka marrë pjesë në takimet e zhvilluara në Ministrinë e Mbrojtjes në kuadër të grupit ndërinstitutional të punës dhe të grupit teknik të punës për kryerjen e analizës së situatës, vlerësimit të alternativave dhe paraqitjen e propozimeve për ngritjen dhe funksionimin e numrit të thirrjeve emergjente 112.

Përfaqësuesit e AKEP-it kanë bashkëpunuar ngushtësisht dhe kanë dhënë kontributin e tyre për kryerjen e analizës së situatës, vlerësimit të alternativave dhe paraqitjen e propozimeve për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112. Vendosija në funksion të plotë i një sistemi të unifikuar për menaxhimin e thirrjeve emergjente është domosdoshmëri për të siguruar komunikim, paralajmërim të hershëm, njoftim, alarm, informim, koordinim, vendimmarrje, aktivizim dhe ndërhyrje të integruar të strukturave operacionale në përballimin e aksidenteve dhe të situatave emergjente që mund të ndodhin në të gjithë vendin.

Numri 112 është bërë pjesë e përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të komunikimeve elektronike prej shumë vitesh dhe të gjithë operatorët/sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve publike telefonike e kanë të implementuar këtë numër në sistemet e tyre dhe kanë detyrim për ofrimin e thirrjeve drejt 112 (dhe gjithë numrave të tjerë të emergjencës) pa pagesë për përdoruesit fundorë/ qytetarët. Roli i AKEP-it është që të garantojë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe nënligjore të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për

dërgimin pa pagesë të komunikimeve të përdoruesve drejt 112 dhe gjithë numrave të emergjencave kombëtare, sipas kërkesave të strukturave përkatëse për përgjigjen dhe trajtimin e këtyre thirrjeve/komunikimeve.

Aktualisht, procesi i analizës së situatës, vlerësimit të alternativave dhe hartimit të propozimeve ka përfunduar, por ende nuk ka një dakordësi midis institucioneve të përfshira në këtë proces.

4.3 Regjistri i sipërmarrësve që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike

1. Paraqitje e numrit të sipërmarrësve aktivë:

Gjatë vitit 2025 kanë ushtruar aktivitet:

- ✓ 281 Sipërmarrës për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike
- ✓ 119 Sipërmarrës për ofrimin e rrjeteve që mundësojnë transmetimin e programeve Audiovizive

2. Sipërmarrës të rinj dhe sipërmarrës të çregjistruar gjatë vitit 2025:

- a. Gjatë vitit 2025 në AKEP janë regjistruar, 12 ofrues të rinj për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe janë çregjistruar 11 prej tyre.
- b. Gjatë vitit 2025 janë regjistruar në AKEP, 9 ofrues të rinj për ofrimin e rrjeteve që mundësojnë transmetimin e programeve Audiovizive dhe janë çregjistruar 5 prej tyre.

3. Sipërmarrës që ofrojnë shërbime publike telefonike:

- 2 sipërmarrës telefoni të lëvizshme
- 30 sipërmarrës telefoni fikse
- 3 sipërmarrës kartë me parapagim

4. Sipërmarrës që ofrojnë shërbimet internet, transmetim të dhëna dhe linja me qira:

Gjatë vitit 2025 kanë ushtruar aktivitet sipërmarrës që ofrojnë shërbime të tjera:

- 247 sipërmarrës që ofrojnë shërbim interneti;
- 42 sipërmarrës që ofrojnë transmetim të dhënash;
- 18 sipërmarrës që ofrojnë linja me qira.

4.4 Autorizimet, Licencat dhe Certifikatat për shërbimet aeronautike, detare, radioamatore

Gjatë vitit 2025 kanë ushtruar aktivitet:

1	Operator Radiodetar	120 certifikata
2	Stacion Radio në Anije	73 licenca
3	Stacion Radio në Avion	5 licenca
4	Radioamator (shqiptar)	47 licenca
5	Radioamator (të huaj)	5 licenca
6	Stacion Radio Bregdetar	3 autorizime

Për vitin 2025, janë lëshuar Licenca, Certifikata dhe Autorizime Stacion Radio Bregdetar si më poshtë:

1	Certifikatë Operator Radiodetar	51 certifikata
2	Licencë Stacion Radio në Anije	14 licenca të reja dhe 4 çregjistrime
3	Licencë Stacion Radio në Avion	-
4	Licencë Radioamatori (shqiptar)	1 licencë
5	Licencë Radioamator (të huaj)	21 licenca (me afate të përkohshme)
6	Autorizim Stacion Radio Bregdetar	-

4.5 Veprimtaria monitoruese gjatë vitit 2025

Veprimtaria monitoruese e AKEP-it është thelbësore për garantimin e funksionimit të rregullt, të sigurt dhe efikas të tregut të komunikimeve elektronike në vend. Përmes monitorimit të vazhdueshëm të spektrit radio dhe rrjeteve, sigurohet që frekuencat të përdoren sipas autorizimeve përkatëse, duke parandaluar ndërhyrjet e dëmshme dhe përdorimet e paligjshme.

Kjo veprimtari kontribuon drejtpërdrejt në ruajtjen e cilësisë së shërbimeve për përdoruesit, si dhe në mbrojtjen e infrastrukturave kritike. Njëkohësisht, të dhënat e mbledhura nga monitorimi shërbejnë si bazë për vendimmarrje dhe planifikim strategjik, duke mundësuar menaxhim më të mirë të një burimi të kufizuar si spektri radio dhe zhvillimin e qëndrueshëm të teknologjive të reja të komunikimit. Më poshtë jepet një përmbledhje e veprimtarisë së monitorimit të AKEP.

4.5.1 Monitorimi i treguesve të cilësisë së shërbimit

Monitorimi i cilësisë së shërbimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike përbën një ndër komponentët thelbësor të veprimtarisë mbikëqyrëse dhe rregullatore të autoritetit.

Gjatë periudhës raportuese, AKEP ka vijuar realizimin e matjeve sistematike të treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe standardet përkatëse evropiane, në zona urbane dhe rurale, përgjatë akseve rrugore kombëtare, si dhe në zonat turistike.

Bazuar në rezultatet e monitorimeve dhe analizën e përmbushjes së indikatorëve kyç të performancës (KPI), AKEP ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me operatorët e telefonisë së lëvizshme, duke kërkuar marrjen e masave korrigjuese në zonat ku janë evidentuar mangësi në mbulim ose cilësi shërbimi. Këto masa kanë përfshirë, sipas rastit, optimizimin e konfigurimit të antenave ekzistuese, rritjen e kapaciteteve të rrjetit, si dhe vendosjen e stacioneve provizore të transmetimit për të përballuar ngarkesën e shtuar të trafikut, veçanërisht gjatë sezonit veror.

Konkretisht, gjatë vitit 2025 janë kryer matje në qytetet Burrel, Klos, Laç, Peshkopi, Bulqizë, Fier, Selenicë, Korçë, Liqenas; në zonat turistike Bylis, Dardhë-Voskopojë; në akset rrugore Rruga e Arbrit, Lis-Lapidar-Klos, Ura e Qerenecit-Klenjë, Qafë Bualli-Krastë, akset e qarkut Korçë, Aksi Korçë-Voskopojë, aksi Qukës-Qafë Plloçë, aksi Lumi i Vlorës, Aksi Kotë-Sevaster-Kalivaç, aksi Tiranë-Dogana, Pustec-Dogana, Kapshticë-Korçë-Ersekë-Leskovic-Përmet-Tepelenë.

Në mënyrë të veçantë, AKEP ka kryer verifikime të detajuara mbi nivelin e mbulimit me sinjal celular të tre akseve të rëndësishme kombëtare: “Bylis” dhe aksin rrugor drejt tij në bashkinë Mallakastër, aksin rrugor “Lumi i Vlorës” dhe aksin rrugor “Qukës–Qafë Plloçë”, sipas kërkesës së deputetëve të Kuvendit, të cilët më pas janë informuar nga AKEP mbi rezultatet e monitorimit të kryer.

Zonat ku janë përmirësuar niveli i sinjalit celular dhe transmetimi i të dhënave (internetit) janë qyteti Burrel, zona turistike Dardhë dhe aksi rrugor drejt kësaj zone, zona turistike Voskopojë dhe aksi rrugor drejt saj, aksi Rruga e Arbrit dhe aksi Lumi i Vlorës.

Gjatë vitit raportues, përveç monitorimeve të kryera, AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me operatorët celular për përmirësimin e sinjalit me shërbim në zonat turistike gjatë sezonit veror duke siguruar optimizimin e antenave ekzistuese si dhe vendosjen e stacioneve provizore. Konkretisht:

1. Operatori “One Albania”

- Ka kryer investime për përmirësimin e mbulimit me sinjal të vendit me shërbimet 2G/3G/4G, si dhe ka rritur kapacitetet në stacionet ekzistuese për teknologjinë 4G ku kërkesa për internet është më e lartë. Konkretisht janë ndërtuar 23 stacione të reja *macro* dhe *micro* (*small cell* dhe *remote cell*), që shërbejnë aktualisht në akset e reja rrugore, pikat turistike dhe vijën bregdetare, si dhe janë rritur kapacitetet e

transmetimit LTE për 168 stacione në breza të ndryshëm frekuencorë 900/1800/2100 dhe 2600 MHz.

- Për vitin 2026-2029 janë parashikuar investime të reja, veçanërisht në ndërtimin e stacioneve të reja të transmetimit në zona bregdetare (si Palasë, Sarandë, Kepi Rodonit), malore (si Grykë Nokë, Lurë) dhe akse rrugore (si lumi i Vlorës-Qeparo, By Pas Vlorë- Orikum, rruga e Arbërit, aksi rrugor Vlorë, Kuç, Gusmar, Tepelenë, Ura Laskos Qeparo, Kardhiq Delvinë, Qukës- Qafë Plloçë).

2. Operatori “Vodafone Albania”

- Ka kryer investime për mbulimin me sinjal të zonave turistike bregdetare/malove, duke aktivizuar 12 stacione të përhershme dhe 8 stacione të përkohshme. Gjithashtu është përmirësuar mbulimi me sinjal i akseve rrugore kombëtare problematike, duke aktivizuar stacionet në Tunelin e Murrizit, Skuraj Rep, Skërfica, Dedaj, Bradashesh. Sa i takon akseve të reja rrugore operatori ka ndërmarrë investime për implementimin e një stacioni të ri në rrugën e Arbërit i cili ende nuk ka përfunduar.
- Për aksin Kardhiq-Delvinë është aktivizuar një stacion dhe aktualisht Vodafone Albania është në negociata me ARRSH për instalimin e një stacioni që do të mundësojë mbulimin e Tunelit të Skerficës si edhe një pjesë të rrugës. Aktualisht mbetet problem furnizimi me energji elektrike.
- Aksi rrugor Qukës-Qafë Plloçë është pjesërisht i mbuluar pasi nga operatori është bërë upgrade në stacionin ekzistues Slabinjë. Gjithashtu është duke u vlerësuar ndërtimi i një stacioni të ri, pjesë e planit të investimeve të përbashkëta me One Albania.
- Në aksin Vlorë-Kuç-Gusmar-Tepelenë – aksi Vlorë-Kuç është aktualisht i mbuluar me aktivizimin e stacioneve të përkohshëm. Zgjidhja e përhershme do të jetë me aktivizimin e stacionit të ri Lumi i Vlorës. Aktualisht në pritje për zbardhjen e lejes së ndërtimit nga AZHT.
- Për aksin Kuç-Gusmar-Tepelenë është planifikuar një stacion i ri i përbashkët, aktualisht është në fazën e prokurimit.
- Aksi Ura Laskos-Qeparo mbulohet në pjesën më të madhe nga tre stacione të aktivizuara më parë. Pjesa e mbetur do të mbulohet me aktivizimin e stacionit të ri Lumi i Vlorës, aktualisht në pritje për zbardhjen e lejes së ndërtimit.

Për sa më sipër, përmirësimi i mbulimit me shërbim i zonave me cilësi sinjali jo në përputhje me parametrat KPI (voice dhe data), përveç investimit të kërkuar, kërkon zgjidhjen e problematikës së vonesave të konsiderueshme në marrjen e lejeve të ndërtimit të stacioneve të reja në institucionet kompetente si AZHT, ARRSH, Bashki, MIE si dhe lidhjen e kontratave të shfrytëzimit të ambienteve për instalimin e antenave me administratorët e godinave. Gjatë vitit raportues, AKEP ka zhvilluar takime dhe komunikime të vazhdueshme me këto institucione, me qëllim përshpejtimin e procedurave dhe zgjidhjen e kësaj problematike, e cila ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve dhe përvojën e përdoruesit fundor.

4.5.2 Mbyllja e transmetimeve në teknologjinë 3G (3G Sëitch off)

Mbyllja e transmetimeve në rrjetet 3G është rezultat i një zhvillimi të natyrshëm teknologjik dhe ekonomik në sektorin e komunikimeve elektronike. Me rritjen e ndjeshme të kërkesës për shërbime të dhënash, aplikacione digjitale dhe përmbajtje multimediale, rrjetet 3G nuk janë më në gjendje të përmbushin në mënyrë efikase nevojat aktuale të përdoruesve. Teknologjitë më të avancuara, si 4G dhe 5G, ofrojnë kapacitete shumë më të larta transmetimi, shpejtësi më të mëdha dhe cilësi më të qëndrueshme shërbimi, duke e bërë 3G gjithnjë e më pak të përdorshëm.

Në këtë kontekst, operatorët kanë orientuar strategjitë e tyre drejt optimizimit të përdorimit të spektrit të frekuencave radio, duke ri-dedikuar brezat e përdorur më parë nga 3G për teknologji më efikase. Ky proces jo vetëm që rrit kapacitetin e rrjeteve ekzistuese, por edhe mundëson zhvillimin e shërbimeve të reja dhe inovative. Paralelisht, mirëmbajtja e disa gjeneratave të rrjeteve njëkohësisht paraqet kosto të konsiderueshme operacionale, çka e bën të paqëndrueshme në afatgjatë mbajtjen në funksion të një teknologjie që po përdoret gjithnjë e më pak.

Si rrjedhojë, shumica e vendeve të BE-së kanë ndërmarrë këtë iniciativë si një domosdoshmëri drejt modernizimit të infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duke krijuar kushtet për rrjete më të shpejta, më të sigurta dhe më efikase.

Gjatë vitit 2025, operatori Vodafone Albania ka ndërmarrë nismën për fikjen (*sëitch off*) e transmetimeve 3G dhe aktualisht ka përfunduar procesi në qarkun e Korçës, Dibrës, pjesërisht në qarkun e Fierit dhe Elbasanit. Rreth 30.1% e stacioneve 3G janë të fikura. Ndërkohë, në janar 2026 parashikohet mbyllja e 3G në qarkun e Vlorës dhe të Beratit dhe në mars-prill parashikohet mbyllja e 3G në qarqet Tiranë, Durrës, Fier, Lezhë, Shkodër, Kukës. Vodafone Albania parashikon ta finalizojë të gjithë procesin e fikjes së transmetimeve 3G gjatë 6 muorit të parë të vitit 2026. Operatori Vodafone deklaron se para çdo faze të fikjes së 3G, janë kryer një sërë optimizimesh në rrjet, duke përfshirë shtimin e kapaciteteve të transmetuesve për të mundësuar përballimin e trafikut 2G, si dhe optimizime specifike për LTE, SRVCC për thirrjet VoLTE dhe CSFB. Paralelisht, Vodafone Albania ka zhvilluar fushata të dedikuara komunikimi përmes SMS-ve dhe thirrjeve të personalizuar nga dyqanet, të orientuara drejt abonentëve të identifikuar me karta non-USIM ose pajisje vetëm 3G.

Aktualisht, në zonat ku është finalizuar fikja e shërbimit 3G, operatori Vodafone Albania nuk ka evidentuar ankesa nga abonentët, ndërsa situata në dyqane ka rezultuar plotësisht normale. Fikja e shërbimit 3G ka ndikuar në rritjen e trafikut 2G të operatorit, e cila është brenda pritshmërive dhe plotësisht e përbalueshme, falë shtimit paraprak të kapaciteteve të transmetuesve në zonat ku është finalizuar ky proces.

Ndërkohë One Albania ka planifikuar fillimin e fikjes së teknologjisë 3G në tetor 2026 dhe finalizimin e këtij procesi në fund të vitit 2027. Procesi i fikjes do të realizohet në dy faza. Gjatë

fazës së parë do të realizohet fikja e dy shtresave 3G në frekuencën 2100 MHz deri në fund të muajit tetor 2026. Kjo do të sjellë uljen e kapacitetit për teknologjinë 3G, por që do të jetë akoma në përdorim rrjeti 3G vetëm në frekuencën 900 MHz. Ndërkohë gjatë fazës së dytë do të realizohet fikja e teknologjisë 3G në të gjithë Shqipërinë. Procesi i fikjes është planifikuar të kryhet zonë pas zone (Një zonë është e barabartë me një rajon). Shqipëria do të ndahet në gjashtë (6) rajone të cilat do të fillojnë fikjen duke filluar nga muaji shtator 2027 në rajone përkatëse ku numri i përdoruesve 3G do të jetë shumë i vogël dhe këta përdorues do të sugjerohen të kalojnë në teknologji të reja më të avancuara për thirrje dhe për data. Për përdorimin thirrje dhe SMS do të sugjerohet që përdoruesit të përdorin teknologjinë VoLTE dhe ata përdorues që nuk ua suporton telefoni do të përdorin rrjetin GSM (2G). Për përdorimin data do të sugjerohet që përdoruesit të përdorin teknologjinë 4G/5G.

Ky tranzicion kontribuon në përmirësimin e përvojës së përdoruesit, në rritjen e konkurrueshmërisë së tregut dhe në përputhjen me zhvillimet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike.

4.5.3 Monitorimi i shtrirjes së infrastrukturës 5G

Në kuadër të monitorimit të shtrirjes së infrastrukturës 5G, në përmbushje të kushteve të Autorizimit Individual, AKEP ka ndjekur ecurinë e implementimit të planit të veprimit të operatorëve të rrjeteve të lëvizshme për mbulimin me shërbim 5G, si dhe mbulimin e zonave të rëndësisë së veçantë si porte, aeroporte, zona turistike, rrugë kombëtare si dhe tunele në akset kombëtare.

Sipas përcaktimeve në kushtet e autorizimit individual me të cilin janë pajisur operatorët celularë, detyrimet për mbulimin me shërbim 5G janë 55% e popullsisë brenda vitit 2027 dhe 85% të popullsisë brenda vitit 2030. Konkretisht mbulimi me sinjal i porteve, aeroporteve, zonës industriale Tiranë- Durrës, qendrat spitalore të Tiranës deri në fund të vitit 2025 si dhe mbulimi me shërbim 5G në të gjitha qytetet e Shqipërisë deri në fund të vitit 2028.

Gjatë vitit 2025, operatori One Albania ka instaluar 64 stacione të reja që operojnë në brezin 3.4-3.6 GHz duke bërë të mundur mbulimin me shërbim në nivelet 46.6% të popullsisë dhe 15.7% të territorit. Deri në fund të vitit 2026, operatori parashikon edhe instalimin e 50 stacioneve të reja në disa qytete të vendit.

Për përmbushjen e detyrimeve të autorizimit për vitin 2025, One Albania ka hasur vështirësi në implementimin e stacioneve 5G në aeroportin e Kukësit dhe të Vlorës, kjo për arsye se këto aeroporte nuk janë funksionale dhe për t'i mbuluar me shërbim duhet të vendosen pajisje në ambiente të brendshme.

Ndërkohë, operatori Vodafone Albania gjatë vitit 2025 ka instaluar 130 stacione të reja në brezin 3.5 GHz dhe aktualisht mbulohen me shërbim 42.2% e popullsisë dhe 5.3% e territorit të vendit në këtë brez frekuencor. Por përveç brezit 3.5 GHz, Vodafone Albania përdor edhe brezin 1800

MHz për mbulimin me shërbimet 5G në disa qytete kryesore të vendit dhe mbulimi aktual i popullsisë, i llogaritur në mënyrë të kombinuar për të dyja bandat frekuencore, deri në 60%.

Gjatë periudhës së parë të raportimit të vitit 2026, mbulohet me shërbim 5G, bazuar në neutralitetin teknologjik mbi 60% e popullsisë për një operator dhe mbi 70% për operatorin tjetër, ndërsa mbulimi territorial varion deri në 36%.

Gjithashtu, implementimi i teknologjisë së re 5G, ka sjellë nevojën për investime të reja në AKEP, lidhur me përditësimin e sistemit të monitorimit të treguesve të cilësisë për matjen e performancës së këtyre rrjeteve. Ky investim, i cili është parashikuar në buxhetin e vitit 2026, do të ndikojë në përmirësimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe rregullatore të Autoritetit, duke siguruar zbatim më efektiv të detyrimeve ligjore të operatorëve për cilësinë e shërbimit dhe transparencën ndaj publikut sa i takon shërbimeve 5G.

4.5.4 Monitorimi i spektrit të frekuencave

Përveç monitorimit të treguesve të cilësisë, AKEP nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Frekuencave monitoron disponueshmërinë dhe përdorimin me eficiencë të spektrit të frekuencave, bazuar në matje në distancë dhe terren.

Gjatë vitit 2025 ka vijuar monitorimi nëpërmjet stacioneve fikse të instaluara në Pinet, Zall Herr, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë të qendëruar në Tiranë, me qëllim verifikimin e përdorimit të ligjshëm dhe efikas të spektrit të frekuencave, okupimin e kanaleve të frekuencave (FCO) dhe okupimin e brezave të frekuencave (FBO) si dhe kontrollin e përputhshmërisë teknike të stacioneve radio me kushtet e autorizimit individual.

Gjithashtu, matje janë kryer edhe në terren, bazuar në ankesat e ardhura nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për evidentimin e interferencave të dëmshme.

Ndërkohë, gjatë vitit raportues është finalizuar dokumenti përfundimtar i projektit të AKEP-it me ITU “Upgrade i Sistemit të Monitorimit të Frekuencave”, i cili do të mundësojë modernizimin e sistemit të monitorimit, përmes implementimit të stacioneve të reja në distancë, për një mbulim më cilësor dhe efikas të territorit. Raporti i përgatitur nga eksperti i ITU-s paraqet gjetjet e një analize të thelluar të rrjetit aktual të monitorimit të AKEP-it, duke identifikuar dhe propozuar përmirësime, me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale të sektorit.

Projekti përfshin instalimin e pajisjeve të avancuara për matjen dhe analizimin e sinjaleve radio, automatizimin e proceseve të monitorimit, si dhe rritjen e kapaciteteve për analizë teknike dhe raportim. Gjithashtu, ai kontribuon në forcimin e sigurisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe në garantimin e një përdorimi të rregullt dhe efikas të spektrit, në përputhje me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare të ITU.

Duhet theksuar se realizimi i projekteve të tilla kërkon angazhim të konsiderueshëm financiar nga ana e rregullatorit. Në këtë kuadër, pavarësisht burimeve të kufizuara buxhetore, AKEP do të mbetet i përkushtuar për të priorizuar investimet strategjike që lidhen me modernizimin e

infrastrukturës së monitorimit dhe rritjen e kapaciteteve institucionale, në mbështetje të zhvillimeve të reja teknologjike.

4.6 Adresimi i problematikave të interferencave të dëmshme

Procesi i adresimit të interferencave synon të sigurojë mbrojtjen e shërbimeve ekzistuese, shmangien e degradimit të cilësisë së komunikimeve dhe garantimin e një mjedisi të drejtë dhe konkurrues për të gjithë përdoruesit e spektrit. Me zhvillimet teknologjike dhe rritjen e numrit të operatorëve në treg, menaxhimi i interferencave paraqet një sfidë gjithnjë e më komplekse, e cila kërkon koordinim të ngushtë ndërmjet autoriteteve brenda dhe jashtë vendit si dhe sipërmarrësve që operojnë në këtë fushë.

Gjatë vitit 2025, Autoriteti ka administruar:

- 15 ankesa për interferenca nga operatorët e rrjeteve të lëvizshme;
- 2 ankesa për interferenca nga Albcontrol në shërbimin aeronautik;
- 2 ankesa për interferenca ndërkufitare nga administrata e Italisë dhe administrata e Malit të Zi në shërbimin aeronautik, të shkaktuar nga transmetimet FM në Shqipëri.

Me administrimin e ankesës, AKEP është angazhuar në kryerjen e matjeve përkatëse për gjetjen e burimit interferues. Në përgjithësi, nuk janë identifikuar interferenca nga burime të jashtme, por kryesisht kanë qenë problematika të brendshme të vet operatorëve për shkak të konfigurimeve të antenave/ BTS në kuadër edhe të implementimit të rrjeteve 5G, duke qenë se operojnë me teknologji neutrale. Sporadike kanë qenë edhe interferencat e shkaktuara nga pajisje jo të certifikuara me markimin CE, që funksionojnë jashtë brezi ose jashtë parametrave teknikë të përcaktuar në vendimet dhe rekomandimet CEPT/ECC në Planin Kombëtar të Frekuencave.

Zonat ku janë identifikuar interferenca të dëmshme kanë qenë Tirana, Shkodra, Lezha, Velipoja, Vau i Dejës, Rrësheni, Korça dhe Saranda. Ndërkohë përveç shërbimit të lëvizshëm, interferenca janë identifikuar edhe në shërbimin aeronautik si brenda dhe jashtë vendit, kryesisht të shkaktuara nga transmetimet audio FM në Shqipëri, për të cilat AKEP-i ka bashkëpunuar me AMA-n për zgjidhjen e menjëhershme të këtyre interferencave.

Nr.	Operatori	Numri i ankesave	Ankesa të trajtuara	Burime të identifikuara
1	One Albania sh.a.,	7	7	7
2	Vodafone Albania sh.a.,	8	8	8
3	Operatorë të tjerë	2	2	2
4	Administrata të huaja	2	2	2
	TOTALI	19	19	19

Sa i takon interferencave ndërkufitare në shërbimin e lëvizshëm, AKEP gjatë vitit 2025 nuk ka administruar asnjë ankesë.

4.7 Konformiteti i pajisjeve radio

AKEP, në zbatim të nenit 5 të VKM nr. 378, datë 5.6.2019, “Për miratimin e rregullit teknik për pajisjet radio, njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, ndryshuar me VKM nr. 721, datë 13.12.2023, dhe nenit 7 të Rregullores nr. 48, datë 22.4.2020, “Për zbatimin e rregullit teknik për pajisjet radio”, ka kompetencën për të regjistruar pajisjet radio të cilat impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë me kërkesat thelbësore sipas nenit 3, të VKM nr. 378/2019.

AKEP, në kuadër të kompetencave të tij në fushën e pajisjeve radio dhe pajisjeve terminale të komunikimeve elektronike sipas bazës ligjore të sipërcituar e cila është në përputhshmëri me kërkesat e Direktivës 2014/53/BE (Radio Equipment Directive – RED), nuk mundëson vlerësimin e përputhshmërisë së pajisjeve radio që impaktohen nga një nivel i ulët i pajtueshmërisë, për shkak se, aktualisht, në Republikën e Shqipërisë nuk ekziston një trup i akredituar për vlerësimin e përputhshmërisë së pajisjeve radio sipas kërkesave të kësaj direktive.

AKEP ka bërë me dije Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit lidhur me sa më sipër, në takimet e zhvilluara lidhur me këtë çështje si dhe në kuadër të raportimeve në BE për Kapitullin 1.

KAPITULLI V: MBROJTJA E KONSUMATORIT

5.1 Treguesit statistikorë të ankesave ndaj sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 si dhe të ligjit nr. 46/2015, përdoruesit fundorë (konsumatorë dhe biznese) të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare kanë të drejtë të ankohen tek ofruesi përkatës i shërbimit për çdo problematikë të hasur me ofrimin e shërbimit dhe/ose zbatimin e kushteve kontraktore, përfshirë për tarifat e aplikuara. Në rast se përdoruesit fundorë nuk marrin përgjigje dhe/ose nuk janë të kënaqur me zgjidhjen e dhënë nga ofruesi i shërbimit, ata kanë të drejtë të kërkojnë nga AKEP zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ofruesin e shërbimit të komunikimit elektronik apo postar sipas përcaktimeve përkatëse ligjore dhe nënligjore për komunikimet elektronike dhe postare. Gjithashtu, ligji nr. 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar, e ka përcaktuar AKEP-in si strukturën përkatëse për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve midis konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare.


AKEP ka vendosur një sërë mjedesh në dispozicion të pajtimtarëve për depozitimin e ankesave në rrugë shkresore dhe elektronike me *e-mail*, përfshirë formularë për pajtimtarët për kërkesa për zgjidhje mosmarrëveshje me operatorët të publikuara në faqen e internetit të AKEP-it si dhe një modul *online* (<https://akep.al/e-ankesa/>) i disponueshëm direkt në faqen kryesore (*homepage*) të internetit të AKEP.

Ankesat për shërbimet e komunikimeve elektronike

Ankesa total 2025: 394 / - 59% v 2024

Në vitin 2025 në AKEP u depozituan 394 ankesa nga pajtimtarët e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike, që përbën një reduktim të ndjeshëm me 59% krahasuar me vitin 2024, dhe nivelin më të ulët të ankesave në 6 vitet e fundit.

Figura 19: Ecuria vjetore e numrit të ankesave të pajtimtarëve të komunikimeve elektronike, 2020-2025



Ankesat sipas objektit dhe llojit të shërbimit Celular v Fiks

Numri i ankesave: 173 shërbim celular/120 portim numri celular/101 BB fiks

Ndryshimi vjetor në %: -71% ankesa portim numri /-61% ankesa shërbim celular/-9% ankesa BB fiks

Rënia e konsiderueshme në numrin total të ankesave në vitin 2025 është ndikuar kryesisht nga reduktimi me 71% i numrit të ankesave për refuzim të kërkesave për portim të numrit celular, si reduktimi me 61% i numrit të ankesave për shërbim nga rrjeti celular. Ndërkohë numri i ankesave për shërbime nga rrjetet fikse (kryesisht për shërbim akses në internet/BroadBand fiks) shënoi një reduktim të vogël me 9%.

Struktura në % e ankesave: 44% shërbim celular/30% portim numri celular/26% BB fiks

Ndërsa problematikat e hasura në refuzimin e kërkesave për portimin e numrit celular nga operatori dhënës i numrit, përbënin objektin kryesor të ankesave në periudhën 2020-2024 (96% të numrit total të ankesave në vitin 2020), ankesat me objekt portimin e numrit celular përbënin 30% të numrit total të ankesave në vitin 2025 (rënie me 12 pp nga viti 2024). Ankesat e tjera për shërbimin celular përbënin 44% të totalit të ankesave 2025 (rënie vjetore me 2 pp), ndërsa ankesat për shërbimin BB fiks përbënin 26% të totalit të ankesave (rritje vjetore me 15 pp).

Figura 20: Numri dhe struktura e ankesave të pajtimtarëve sipas objektit/ shërbimit celular dhe fiks, 2024-2025





Figura e mëposhtme paraqet ecurinë mujore të numrit të ankesave sipas objektit kryesor dhe shërbimeve/rrjeteve celulare dhe fiks në periudhën 2024-2025, ku vihet re një rënie e konsiderueshme e numrit të ankesave në bazë mujore, nga mesatarisht 81 ankesa në muaj në vitin 2024 në 33 ankesa në muaj në vitin 2025. Rënia më e madhe vihet re në numrin e ankesave për portim numri celular nga mesatarisht 34 në 10 ankesa në muaj në vitin 2025.

Figura 21: Ecuria mujore e numrit të ankesave të pajtimtarëve të komunikimeve elektronike sipas shërbimeve Celulare vs Fiks, (2024-2025)



Ankesat sipas operatorëve

Në vitin 2025, për One Albania u depozituan 268 ankesa, që përbën një reduktim me 68% në krahasim me 839 ankesa në vitin 2024. Ankesat në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim numri celular nga One Albania si Operator Dhënës shënuan rënien më të madhe me 75%, ndërkohë që ankesat për shërbimin nga rrjeti celular u reduktuan ndjeshëm me 68%, dhe ankesat për shërbim nga rrjeti fiks u ulën me 46%. Ankesat për One Albania përbënin 68% të numrit total të ankesave në vitin 2025, krahasuar me 86% në vitin 2024.

Për Vodafone Albania në vitin 2025 u depozituan 123 ankesa, apo 20% më pak se në vitin 2024. Ankesat në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim numri celular nga Vodafone Albania si Operator Dhënës u reduktuan ndjeshëm me 50%, ndërsa ankesat për shërbimin nga rrjeti celular u rritën me 12% dhe ankesat për shërbim nga rrjeti fiks u rritën më 17%. Ankesat për Vodafone Albania përbënin 25% të numrit total të ankesave në vitin 2025, krahasuar me 13% në vitin 2024.

Ndërkohë, ankesat për operatorët e tjerë të rrjeteve fikse si Digicom, ASC dhe Abissnet shënuan rritje dhe përbënin 6% (rreth 2% secili operator) të ankesave në vitin 2025, krahasuar me vetëm 1% në vitin 2024.

Figura 22: Ankesat e pajtimtarëve sipas operatorëve, 2024-2025



Numri i ankesave sipas operatorëve në proporcion me numrin e pajtimtarëve

Për të marrë në konsideratë ndryshimin në bazën e pajtimtarëve midis operatorëve, në tabelën më poshtë paraqitet numri i ankesave për 100 mijë pajtimtarë për secilin operator sipas llojit të shërbimit nga rrjete celulare (ankesa për portim+ankesa për shërbim) dhe nga rrjete fikse (shërbim akses BB fiks) për vitin 2025. Për numrin e pajtimtarëve celularë është përdorur numri përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare dhe numri i përdoruesve të aksesit BB fiks në fund të

T4 2025/vitit 2025 për secilin operator dhe për të gjithë tregun për të llogaritur këtë tregues për tregun (AVG.Market).


Tabela më poshtë paraqet treguesin e numrit të ankesave në raport me numrin e pajtimtarëve.

Tabela 14: Numri i ankesave për 100 mijë pajtimtarë sipas operatorëve dhe shërbimit

Ankesa per 100,000 pajtimtarë		
	Celulare (Shërbim+Portim)	Akses BB Fiks
One Albania	17	35
Vodafone Albania	6	14
Abissnet		13
Digicom		23
ASC		11
Avg.Market	12	13

Figura më poshtë parqet ecurinë e këtij numrit të ankesave për 100,000 pajtimtarë sipas shërbimit celular dhe fiks (mesataret e tregut) në bazë 3 Mujore.

Figura 23: Numri i ankesave për 100,000 pajtimtarë



Nga figura e mësipërme vihet re se numri i ankesave për 100 mijë pajtimtarë ka ardhur në rënie të ndejshme për shërbimet celulare (përfshirë për portim numri) nga 10-15 ankesa/100 mijë pajtimtarë në T1-T2 2024, në 2-3 ankesa/100 mijë pajtimtarë celularë në T2-T4 2025. Numri i ankesave për shërbimin akses BB fiks ka qenë më i qëndrueshëm në nivele 3-5 ankesa/100 mijë pajtimtarë akses BB fiks në tremujor.

5.2 Ankesat ndaj ofruesve të shërbimeve postare

Në vitin 2025 në AKEP u depozituan 19 ankesa nga përdorues të shërbimit postar, prej të cilave 9 ankesa ishin në lidhje me shërbimin postar të ofruar nga Albanian Courier, 4 ankesa për ADEX, 3 ankesa për Postën Shqiptare, 3 ankesa për Ulysses. Objekti i ankesave ishte kryesisht për vonesa në dorëzimin apo mosdorëzimin e pakove të porositura *online*, pra nga pala marrëse e objektit postar. Ofruesit e shërbimeve kanë trajtuar ankesat duke dhënë përgjigje sqaruese dhe më pas realizimin e dorëzimit të pakove.

Për ankesat me objekt përlllogaritjen e detyrimeve doganore të njoftuara, nga ofruesit e shërbimit postar përgjigja është e argumentuar, bazuar në deklaratimet e vlerave të manifestuara nga dërguesi.

Për ankesat me objekt vonesën në dërgimin e objekteve postare, nga ofruesit e shërbimeve postare janë argumentuar arsyet e vonesës ku shkak kanë qenë administratat e autoriteteve të huaja postare apo doganore.

Lidhur me mosdorëzimin e objekteve postare në adresën e marrësit, nga ofruesit e shërbimit postar në përgjigjet e sjella në AKEP për ankesat e referuara, për arsyet e mosdorëzimit, janë argumentuar me vështirësitë në gjetjen e adresave dhe pasaktësitë në deklarin e tyre nga përdoruesit.

5.3 Mosmarrëveshje të trajtuara nga Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve

Shumica e ankesave të administruara nga AKEP depozitohen në rrugë elektronike me *e-mail* ose nëpërmjet modulit *online* e-ankesa, dhe nuk klasifikohen si kërkesa për zgjidhje (alternative) mosmarrëveshje, pasi ankimuesit nuk kanë ezauruar fazën e ankimit me shkrim tek ofruesi përkatës i shërbimit dhe/ose janë jashtë afatit procedural/ligjor 15/30 ditor. Megjithatë, AKEP pranon të gjitha llojet e ankesave, të cilat i përcillen palës së ankimuar për trajtim dhe ofrim zgjidhje, dhe nëse ankimuesi nuk është i kënaqur me sqarimin dhe/ose zgjidhjen e dhënë nga ofruesi i shërbimit në këtë fazë të parë të trajtimit të tyre, ankimuesi mund të kërkojë trajtimin e ankesës nga AKEP me procedurë formale zgjidhje (alternative) të mosmarrëveshjeve. Shumica e ankesave adresohen dhe zgjidhen që në fazën e parë të trajtimit të tyre në sajë të bashkëpunimit të ofruar nga vet operatorët e ankimuar, pa qenë nevoja që ankesat të kalojnë në procedurë formale zgjidhje (alternative) të mosmarrëveshjeve me kërkesë të ankimuesit.


Në vitin 2025, Komisioni i Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve (KZAM) ka trajtuar 2 ankesa/kërkesa me procedurë (formale) zgjidhje alternative mosmarrëveshje, objekti i të cilave ishte për çështje faturimi, të cilat u zgjidhën me mirëkuptim në favor të pajtimtarit në seancën e pajtimit midis palëve të zhvilluar nga KZAM.

5.4 Portabiliteti i numrave

Portabiliteti i numrit është një lehtësi apo mundësi për të gjithë përdoruesit fundorë që janë pajtimtarë të shërbimit publik telefonik të pajisur me numra nga Plani Kombëtar i Numeracionit që të ruajnë numrat e tyre, sipas kërkesës, kur ata ndërrojnë sipërmarrësin që u ofron shërbimin publik telefonik dhe shërbime të tjera të lidhura me numrin e telefonit. E drejta e portimit të numrit dhe zbatimi me efektivitet i saj konsiderohet një faktor i rëndësishëm për maksimizimin e përfitimeve të përdoruesve fundorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike pasi portimi i numrit (ruajtja e numrit) të telefonit lehtëson procesin e zgjedhjes dhe ndërrimit të ofruesit të shërbimit të komunikimeve elektronike për pajtimtarët si dhe njëkohësisht nxit konkurrencën efektive midis ofruesve të shërbimeve në tregun e komunikimeve elektronike.


Në vitin 2025 u portuan me sukses 13.996 numra në total (celular dhe fiks), prej të cilëve 13.910 ishin numra celularë, me rënie prej 28% në krahasim me vitin 2024, dhe vetëm 86 numra fiks, me rënie prej 50% krahasuar me vitin 2024. Sasia totale numrave të portuar prej vitit 2012 deri në fund të vitit 2025 arriti në 1.37 milionë numra celularë dhe rreth 20 mijë numra fiks.

Figura 24: Ecuria e sasive vjetore të numrave të portuar, 2012-2025



Përqindja e kërkesave për portim të refuzuara nga operatori dhënës celular në vitin 2025 ishte në nivele 51-52%, që përbën një reduktim të lehtë prej 1-2 pikë përqindje në krahasim me vitin.

Figura 25: Ecuria e përqindjes së kërkesave për portime të refuzuara nga operatori dhënës, 2016-2025



Me qëllim adresimin e problematikave në lidhje me refuzimin e kërkesave për portim të numrit nga operatori dhënës celular, përfshirë normën e lartë të refuzimeve të kërkesave për portim numri, AKEP gjatë vitit 2025 ka kryer proces Këshillimi Publik për miratimin e Rregullores së re të portabilitetit të numrit, të cilat përfshijnë një sërë ndryshimesh në krahasim Rregulloren nr.43/2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, e ndryshuar. Këto ndryshime përshkruhen në seksionin përkatës të këtij raporti për përgatitjen e akteve të reja nënligjore të AKEP/në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit.

5.5 Mbikëqyrja e tregut/inspektimi

Me qëllim ushtrimin e kompetencës ligjore lidhur me mbikëqyrjen, kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë së ofruesve të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe postare, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, veçanërisht lidhur me zbatimin e kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Autorizimin e Përgjithshëm, AKEP kryen në mënyrë të vazhdueshme inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve postare.

Gjatë vitit 2025 janë kryer 41 (dyzet e një) inspektime ndër të cilat 21 (njëzet e një) përfshijnë edhe monitorimin, 6 (gjashtë) janë inspektime të ofruesve të shërbimit postar, 11 (njëmbëdhjetë) janë inspektime të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike dhe 3 (tre) për bllokimin e IP, DNS të cilat kanë lidhje me bllokimin e Aplikacionit Tik Tok.

Inspektime të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2025, krahas inspektimeve në terren, struktura përgjegjëse inspektuese e AKEP-it ka kryer edhe inspektime në distancë, në bashkëpunim me strukturat e tjera të AKEP-it. Me përfundimin e procedurës inspektuese në distancë, ndaj 11 (njëmbëdhjetë) sipërmarrësve të komunikimeve elektronike janë vendosur dënime plotësuese në formë rekomandimi.

Po ashtu, në përfundim të inspektimeve të kryera, krahas rekomandimeve të lëna, për shkelje të parashikimeve të ligjit organik, është vendosur 1 (një) masë administrative “gjobë”. Përveç dënimeve administrative, një tjetër masë e ndërmarrë nga ana e AKEP-it është sekuestrimi i pajisjeve antena marrëse, (që mundësojnë transmetime audiovizive DVBT-2) të cilat aksesonin sinjal jashtë brezit të lejuar, duke shkaktuar interferenca të përsëritura ndaj operatorëve celularë.

Inspektime të ofruesve të shërbimeve postare

Gjatë vitit 2025 janë realizuar inspektime rastësore dhe inspektime në distancë për të verifikuar përmbushjen e kushteve të ofrimit të shërbimeve postare. Në përfundim të procedurave verifikuese, AKEP ka konstatuar subjekte që ushtronin aktivitet pa qenë të pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimeve postare. Lidhur me këto raste, AKEP ka ndërmarrë masat e nevojshme për formalizimin e ushtrimit të këtij aktiviteti. Ndërkohë, inspektime janë kryer edhe pranë subjekteve të pajisur me autorizim për ofrimin e shërbimeve postare dhe rast pas rast janë ndërmarrë veprimet për përmbushjen e gjithë detyrimeve të autorizimit të pergjithshëm.

Nisur nga shqetësimet e ofruesve të shërbimeve postare, si edhe duke marrë shkas nga korrespondenca me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve e cila përcolli pranë AKEP një listë me subjekte të dyshuara që ushtrojnë aktivitet në fushën e ofrimit të shërbimeve postare, gjatë muajit dhjetor 2025, AKEP inicioi një proces monitorimi për të evidentuar nëse këto subjekte ushtrojnë aktivitet i cili rregullohet sipas parashikimit të legjislacionit për shërbimet postare në Shqipëri dhe marrjen e masave përkatëse nëse konstatohen subjekte që ushtrojnë aktivitet të shërbimeve postare në kundërshtim me përcaktimet e legjislacionit për shërbimet postare në RSH. Në përfundim të kësaj procedure rezultoi se një kategori e konsiderueshme nuk ofronte shërbim postar në kuptim të ligjit të posaçëm për shpërndarje (*delivery*), ndërkohë që AKEP vijon monitorimin dhe bashkëpunimin me strukturat tatimore për identifikimin e rasteve të ngjashme.

KAPITULLI VI: TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

6.1 Siguria dhe integriteti i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike

Gjatë vitit 2025, garantimi i sigorisë dhe integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike ka qenë një prioritet strategjik për AKEP-in. Sektori i komunikimeve elektronike në Shqipëri ka vijuar të zhvillohet me ritme të shpejta, duke u karakterizuar nga zgjerimi i rrjeteve *broadband*, rritja e përdorimit të shërbimeve digjitale dhe shtimi i kërcënimeve kibernetike ndaj infrastrukturave kritike. Telefonia e lëvizshme dhe rrjetet fiks/*broadband* përbëjnë tashmë komponentë thelbësorë për funksionimin e shërbimeve publike, aktivitetin ekonomik dhe komunikimin e qytetarëve.

Në këtë kontekst dhe në kuadër të kompetencave të përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP ka vijuar të ushtrojë rol rregullator dhe mbikëqyrës në drejtim të garantimit e funksionimit të sigurt të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, rritjes së qëndrueshmërisë së operatorëve ndaj incidenteve kibernetike, sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve kritike për përdoruesit fundorë.

Gjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimi i mekanizmit të raportimit të incidenteve të sigorisë nga operatorët, duke synuar koordinimin e reagimit si dhe minimizimin e ndërprerjeve të shërbimit si dhe nuk janë evidentuar incidente të sigurisë kibernetike që të kenë shkaktuar ndërprerje të shërbimit apo rrjedhje të të dhënave të përdoruesve.

Gjatë periudhës raportuese, AKEP-i ka vijuar bashkëpunimin me institucione të tjera publike dhe struktura kombëtare të sigurisë. AKEP, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, ka realizuar në bashkëpunim me ofruesit e shërbimit internet (ISP) bllokimin e domain-eve dhe adresave IP që hostojnë përmbajtje të dëmshme/të jashtëligjshme sipas kërkesave të paraqitura nga autoritetet kompetente si AKSK, AMA, AMLF, Policia e Shtetit, Prokuroria etj. Në shumë raste, përfshirja e AKEP-it ka qenë vendimtare në kufizimin e ndikimit të sulmeve kibernetike që kanë prekur infrastrukturën publike dhe private që mbështet shërbime thelbësore për qytetarët. Gjatë vitit 2025, incidentet më të shpeshta përfshinë fushata phishing të orientuara drejt vjedhjes së të dhënave personale të përdoruesve dhe mundësisit të mashtrimeve financiare, shpesh përmes faqeve të rreme që imitonin institucione si Posta Shqiptare, si edhe raste që lidhen me transmetime të paautorizuara të aktiviteteve sportive, platforma të paligjshme të lojërave të fatit/basteve *online*, si dhe shërbime të tjera mashtruese *online*. Në total, gjatë vitit u mbyllën mbi 180 domain-e/adresa IP.

Ky bashkëpunim ka kontribuar në forcimin e sigurisë kombëtare të infrastrukturës së komunikimeve elektronike.

6.2 Siguria kibernetike për rrjetet 5G

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, plotësimi i kuadrit nënligjor në fushën e sigurisë kibernetike për rrjetet 5G ka qenë një ndër prioritetet kryesore të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

Gjatë vitit 2025 janë organizuar trajnime dhe seminare të ndryshme në kuadër të transpozimit të 5G Security Toolbox të Bashkimit Evropian, politikave të spektrit radio, në vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe zhvillimit të infrastrukturës digjitale dhe rritjes së besueshmërisë në përdorimin e teknologjive ICT dhe telekomunikacionit, ku AKEP ka marrë pjesë (të tilla si TAIEX, ITU).

Në kuadër të këtyre aktiviteteve, është përfituar ekspertiza e nevojshme për implementimin e teknologjisë 5G, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Vlen të theksohet se zhvillimi i infrastrukturës 5G nuk përfaqëson vetëm një hap të rëndësishëm në aspektin e përparimit teknologjik, por edhe një lëvizje strategjike që synon rritjen e konkurrencës, forcimin e sigurisë dhe përsheptimin e integritetit të Ballkanit Perëndimor në ekonominë digjitale evropiane.

Gjatë kësaj periudhe, AKEP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe me operatorët celularë përmes takimeve periodike, me qëllim diskutimin dhe hartimin e kuadrit nënligjor që lidhet me garancinë dhe sigurinë e furnizuesve dhe ofruesve të rrjeteve 5G.

Konkretisht, me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM nr. 570, datë 8.10.2025) është miratuar lista e përbërësve kritikë dhe pjesëve të ndjeshme të rrjeteve 5G dhe pritjet të miratohet metodologjia për vlerësimin e profilit të rrezikut në nivel kombëtar të furnizuesve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjeteve 5G.

Këto projektakte kanë për qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor të nevojshëm për zbatimin e ligjit nr. 54/2024, si dhe harmonizimin me Rekomandimin e Komisionit Evropian (BE) 2019/534, ubl 26 mars 2019, “Për sigurinë kibernetike të rrjeteve 5G”, i njohur si 5G Toolbox.

6.3 Administrimi i domain-it

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) administron domainin “.al”, bazuar në germën dh), të pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregulloren nr. 2, datë 21.2.2008, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al””, e ndryshuar.


Domainet .al dhe nëndomainet gjatë vitit 2025:

Numri i domain-eve .al dhe nëndomaineve të regjistruar për vitin 2025 është 7338 domaine.

Numri total i domain-eve .al dhe nëndomaineve në fund të vitit 2025 është rreth 32822 domaine.

Në terma statistikorë vihet re se viti 2025 ka pësuar një rritje të numrit total të domain-eve të regjistruar, krahasuar me vitin 2024, me rreth 1764 domaine më shumë në fund të vitit 2025 krahasuar me vitin 2024.

Figura 26: Statistika mbi regjistrimin e domain.al



Regjistruesi Host.AL sh.p.k., vijon sërish të kryesojë listën e regjistruesve të domaineve .al (autorizuar nga AKEP) me numrin total më të madh të domaineve të regjistruar nëpërmjet tij, me një diferencë totale prej 3498 të numrit të domaineve nga Regjistruesi pasues, Ëebhost shpk.

AKEP mban vendin e pestë si regjistrues, për nga numri i domaineve të regjistruar nëpërmjet tij, duke pësuar kështu zbritje në renditje krahasuar me renditjen në vendin e katërt në vitin 2024.

Gjatë vitit 2025, AKEP ka autorizuar 1 regjistrues të ri (Abissnet sh.a.) për regjistrim të domaineve .al, lista e përditësuar e të cilëve është e paraqitur në faqen ëeb të AKEP-it.

Numri total i Regjistruesve të autorizuar të domaineve “.al”, përfshirë AKEP-in, është 13.

Numri i domain-eve sipas Regjistruesve gjatë vitit 2025 është paraqitur më poshtë në formë tabelare dhe me grafikë:

Nr.	Regjistruesi	Regjistrime gjatë vitit 2025	Nr. Total i Domaineve për secilin Regjistrues në fund të vitit 2025
1	AKEP	114	2099
2	One Albania sh.a.,	9	100
3	Host.AL sh.p.k.,	2846	12250
4	Ëebhost sh.p.k.,	1997	8824
5	Keminet sh.p.k.,	812	4798
6	Digicom sh.p.k.,	1	13
7	Soft&Solution sh.p.k.,	1	29

8	InnovaTech sh.p.k.,	274	931
9	InterMedia sh.p.k.,	370	974
10	Upflare shpk	902	2585
11	MC NETËORKING sh.p.k.,	0	0
12	IMPULS STUDIO sh.p.k.,	12	219

Figura 27: Numri i domain .al të regjistruar për çdo regjistruar gjatë vitit 2025





Figura 28: Numri total i Domaineve për çdo regjistruar në fund të vitit 2025



Gjatë vitit 2025 rezulton se 5262 domain-e .al dhe nëndomaine janë fshirë nga sistemi i administrimit të domaineve .al pasi nuk janë rinovuar. Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare të dhënat e detajuara të numrit të domain-eve, deri në fund të vitit për pesë vitet e fundit:

Numri i domaineve .al dhe nëndomaineve të regjistruar në 5 vitet e fundit është paraqitur më poshtë në formë tabelare dhe me grafikë:

Domain	Domain-e të regjistruara deri në 2021	Domain-e të regjistruara deri në 2022	Domain-e të regjistruara deri në 2023	Domain-e të regjistruara deri në 2024	Domain-e të regjistruara deri në 2025
.al	23820	25289	26294	29022	30834
.com.al	1164	1187	1168	1202	1197
.gov.al	408	434	439	449	426
.org.al	139	144	148	153	148
.edu.al	173	186	194	191	186
.net.al	33	32	31	32	28
.mil.al	3	3	4	4	3
Total	25740	27275	28278	31155	32822

Figura 29: Historiku i numrit të domaineve .al dhe nëndomaineve në 5 vitet e fundit





Figura 30: Historiku i numrit total të domaineve .al në 5 vitet e fundit



Domainet shtetërore (.gov.al)

Gjatë vitit 2025, janë regjistruar 22 domain-e .gov.al. Në fund të vitit 2025, numri total i domain-eve .gov.al rezulton të jetë 426. Rreth 45 domain-e .gov.al janë fshirë nga sistemi gjatë vitit 2025.

Gjatë vitit 2026, pritet të skadojnë 127 domaine .gov.al, procesi i rinovimit të të cilëve do të vijojë të ndiqet me kujdes.

Monitorimi i këtyre domain-eve prej AKEP-it ka qenë i vazhdueshëm dhe institucionet shtetërore janë kontaktuar vazhdimisht për t'u vënë në dijeni mbi afatet e skadimit të domaineve të tyre, në mënyrë që të shmangej mbyllja e shërbimeve që ofrojnë.

Domainet .gov.al për vitin 2025 janë paraqitur si më poshtë:

Domaine .gov.al të regjistruar gjatë 2025	Numri total i domaineve .gov.al në fund të 2025
22	426

AKEP ka vijuar gjatë vitit 2025 punën për forcimin e kuadrit rregullator të administrimit të domainit kombëtar “.al”, rritjen e sigurisë dhe integritetit të shërbimeve, si dhe përafrimin e praktikave administrative me kërkesat e ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 54/2024, AKEP ka filluar punën për hartimin e projektregullores për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al” me të cilën do të rishikohet rregullorja në fuqi, “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën “.al””, e ndryshuar (nr. 2, datë 21.2.2008). Ky akt do të mbajë në konsideratë VKM-në nr. 219, datë 17.4.2025, “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për domain-name-t “.al””.

Ky proces synon modernizimin e procedurave administrative për domainet “.al”, qartësimin e roleve dhe përgjegjësi të palëve të përfshira, si dhe forcimin e dispozitave mbi saktësinë e të dhënave, mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin, duke u mbështetur edhe në praktikatat më të mira evropiane të administrimit të ccTLD-ve.

6.4 Siguria e rrjetit të teknologjisë së informacionit të autoritetit

AKEP ka vijuar të ketë si prioritet strategjik forcimin e sigurisë së sistemeve informatike dhe garantimin e disponueshmërisë së shërbimeve kritike. Gjatë periudhës raportuese, infrastruktura e brendshme IT dhe sistemet mbështetëse kanë operuar në mënyrë të qëndrueshme, pa incidente që të kenë ndikuar në përdoruesit fundorë apo në vijueshmërinë e shërbimeve.

Në drejtim të rritjes së nivelit të mbrojtjes, janë ndërmarrë investime të vazhdueshme në pajisje dhe zgjidhje të avancuara sigurie, duke përfshirë përmirësimin e mekanizmave të kontrollit të aksesit dhe forcimin e politikave të sigurisë. Paralelisht, është vijuar me implementimin,

administrimin dhe përditësimin e zgjidhjeve antivirus/antimalëare për përdoruesit fundorë dhe serverat, me qëllim minimizimin e rreziqeve nga kërcënimet kibernetike.

Një fokus i veçantë i është kushtuar forcimit të sigurisë në komponentët kyç të infrastrukturës kritike, përmes konfigurimeve të avancuara, monitorimit të vazhdueshëm dhe aplikimit të praktikave më të mira të sigurisë (*best practices*). Gjithashtu, janë ndërmarrë masa për rritjen e ndërgjegjësimit të stafit mbi sigurinë informatike, me qëllim reduktimin e riskut nga faktorët njerëzorë.

AKEP ka luajtur një rol kyç në administrimin, monitorimin dhe reagimin ndaj çështjeve të sigurisë, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme për të gjithë stafin. Përmes ndërhyrjeve proaktive dhe asistencës teknike, janë parandaluar incidentet e mundshme dhe është garantuar integriteti, konfidencialiteti dhe disponueshmëria e sistemeve të institucionit.

Gjatë vitit raportues, AKEP ka vijuar mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemit të portabilitetit të numrit (CRDB), i cili përbën një komponent kritik në funksionimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe në garantimin e ofrimit të shërbimeve për përdoruesit fundorë.

Sistemi CRDB ka operuar në mënyrë të qëndrueshme, duke siguruar disponueshmëri të lartë dhe integritet të të dhënave, si dhe duke mundësuar përpunimin korrekt dhe në kohë të proceseve të portabilitetit të numrave ndërmjet operatorëve. Janë kryer monitorime të vazhdueshme të performancës së sistemit, me qëllim identifikimin dhe adresimin proaktiv të çdo anomalie.

Në vijim, është planifikuar modernizimi i infrastrukturës që mbështet sistemin CRDB, përmes zëvendësimit të serverëve dhe sistemeve të ruajtjes (*storage*), me qëllim rritjen e performancës, shkallëzueshmërisë dhe sigurisë së sistemit, si dhe përmirësimin e kapaciteteve për përballimin e kërkesave në rritje.

KAPITULLI VII: BASHKËPUNIME INSTITUCIONALE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

7.1 Procesi i integrimit evropian

Në kuadër të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian 2024 - 2026 dhe strukturave të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), AKEP ka vijuar angazhimin në procesin e integrimit evropian. Ky angazhim ka qenë i lidhur kryesisht me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian përmes përafrimit të kuadrit ligjor, forcimit të kapaciteteve administrative dhe zbatimit efektiv të reformave sektoriale.

AKEP kontribuon në kuadër të 9 kapitujve negociues të *acquis* të Bashkimit Evropian si më poshtë:

KAPITULLI
Kapitulli 1 - “Lëvizja e lirë e mallrave”
Kapitulli 3 - “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”
Kapitulli 7 - “E drejta e pronësisë intelektuale”
Kapitulli 8 - “Politika e konkurrencës”
Kapitulli 10 - “Shoqëria e Informacionit dhe Media”
Kapitulli 20 - “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”
Kapitulli 21 - “Rrjetet trans-evropiane”
Kapitulli 23 - “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”
Kapitulli 28 - “Mbrotjtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik”

Gjatë vitit 2025 AKEP-i ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë dhe teknik veçanërisht në Kapitujt 1, 3 dhe 10 të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave

Në kuadër të këtij kapitulli, AKEP ushtron kompetenca në fushën e pajisjeve radio dhe vlerësimit të konformitetit të tyre.

Gjatë vitit 2025, ka vijuar zbatimi dhe përafrimi i kuadrit ligjor kombëtar në përputhje me Direktivën 2014/53/BE (RED) dhe aktet përkatëse, duke forcuar mekanizmat e mbikëqyrjes së

tregut dhe duke garantuar përmbushjen e kërkesave thelbësore për sigurinë dhe përputhshmërinë e pajisjeve.

Kontributi i AKEP-it në këtë kapitull synon sigurimin e funksionimit të tregut në përputhje me standardet evropiane dhe rritjen e kapaciteteve administrative për zbatimin efektiv të legjislacionit.

Kapitulli 3 - E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Në sektorin postar, kuadri ligjor shqiptar është plotësisht i përafruar me direktivat e Bashkimit Evropian për shërbimet postare. Gjatë vitit raportues, AKEP ka vijuar:

- ✓ mbikëqyrjen e tregut postar në kushte konkurrence të ndershme;
- ✓ monitorimin e ofrimit të shërbimit universal postar dhe të standardeve të cilësisë;
- ✓ zbatimin e kërkesave për transparencë tarifore dhe ndarje llogarish;
- ✓ implementimin e rregullave për dërgesat ndërkufitare.

Veprimtaria e AKEP ka garantuar funksionimin e tregut postar në përputhje me parimet e tregut të hapur, mbrojtjen e konsumatorit dhe respektimin e detyrimeve që burojnë nga *acquis*.

Kapitulli 10 - Shoqëria e Informacionit dhe Media

Viti 2025 u karakterizua nga zbatimi i ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili përfaqëson reformën më të rëndësishme strukturore në sektor dhe një hap vendimtar në përafrimin me Kodin Evropian të Komunikimeve Elektronike.

Në këtë kuadër, AKEP ka:

- ✓ vijuar miratimin dhe zbatimin e akteve nënligjore;
- ✓ forcuar kuadrin rregullator për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve, përfshirë rrjetet 5G;
- ✓ rritur mbikëqyrjen rregullatore dhe mbrojtjen e përdoruesve fundorë;
- ✓ kontribuar në proceset e integritetit digjital rajonal.

Ligji i ri ka konsoliduar më tej pavarësinë institucionale, financiare dhe organizative të AKEP, duke forcuar rolin e tij si autoritet rregullator i pavarur që raporton drejtpërdrejt në Kuvend.

Kontributi i Autoritetit në Kapitujt 1, 3 dhe 10 përfaqëson një komponent të rëndësishëm të avancimit të procesit të integritetit evropian, duke garantuar funksionimin e tregjeve të komunikimeve elektronike dhe postare në përputhje me standardet dhe praktikatat e Bashkimit Evropian.

Prej vitit 2022, AKEP ushtron rolin e “*Drafting Leader*” në Grupin e Punës për *Roaming* pranë BEREC, duke udhëhequr procesin e hartimit të raportit vjetor “*WB Benchmark Data Roaming*”.

Ky raport përmbledh të dhëna nga autoritetet rregullatore të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe paraqitet për miratim në plenaren e parë të BEREC çdo vit.

Në ushtrimin e këtij roli, AKEP ka kontribuar në rritjen e cilësisë dhe saktësisë së raportimit përmes përpunimit të strukturuar të të dhënave, korigjimeve metodologjike dhe propozimeve për përmirësimin e procedurave. Angazhimi profesional i Institucionit ka ndikuar në forcimin e bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit dhe në përmirësimin e cilësisë së dokumenteve përfundimtare të publikuara nga BEREC.

Nga shkurti 2025, funksioni i “*Drafting Leader*” është institucionalizuar në kuadër të Zyrës së BEREC, duke u integruar dhe formalizuar në strukturën e Grupit të Punës për *Roaming*. Ky zhvillim garanton vazhdimësi institucionale, rrit efikasitetin e procesit të koordinimit dhe përpunimit të të dhënave, si dhe konsolidon rolin e AKEP në kontekstin rajonal dhe evropian të rregullimit të *roaming*-ut.

Gjatë vitit 2025, AKEP ka vijuar bashkëpunimin me ente të tjera rregullatore dhe institucione publike në procesin e përgatitjes dhe rishikimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e komunikimeve elektronike, me qëllim përafrimin e tyre me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë kuadër, AKEP ka kontribuar në konsultimin dhe harmonizimin e dispozitave që lidhen me sigurinë, integritetin, mbrojtjen e të dhënave dhe çështje të tjera që prekin edhe administrimin dhe menaxhimin e domainit kombëtar “.al”.

7.2 Bashkëpunime ndërinstitutionale

7.2.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për legjislacionin parësor dhe sekondar

Në zbatim të standardeve të Bashkimit Evropian (BE) sa i përket transformimit digjital dhe media, në veçanti në lidhje me procesin e përafrimit me *acquis* si Akti për Shërbimet Digjitale (DSA), Akti i Infrastrukturës Gigabit (GIA), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), nën koordinimin dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka marrë pjesë dhe ka dhënë kontribut në takimet e zhvilluara për këtë qëllim konkretisht lidhur me:

1. *Rregullore e Bashkimit Evropian 2022/2065, “Për Shërbimet Digjitale” (Digital Services Act – DSA)*

AKEP, gjatë vitit 2025 e në vijim, ka marrë pjesë në takimet/ëorkshope dhe seminarët e organizuara në drejtimin e MIE dhe me pjesëmarrje të disa institucioneve publike, (AKEP,

AMA, DDA, Kuvendi etj.) të zhvilluar në kuadër të procesit të transpozimit të kësaj rregulloreje në legjislacionin e brendshëm kombëtar.

Procesi i transpozimit duhet të koordinohet me një numër të gjerë institucionesh, sipas rolit që ato kanë dhe që lidhen me rregullimin e platformave/përmbajtjes, aksesin në internet, mbrojtjen e të dhënave, mbrojtjen e konsumatorit, pronësi intelektuale, konkurrencën, sigurinë kibernetike etj.

2. Rregullore e Bashkimit Evropian 2024/1309/BE “Gigabit Infrastructure Act (GIA)”

Rregullorja 2024/1309/BE, synon të përshpejtojë dhe të ulë kostot e ndërtimit të rrjeteve shumë të shpejta elektronike në të gjithë Bashkimin Evropian, të sigurojë internet shumë të shpejtë (*gigabit*) për të gjithë qytetarët dhe bizneset si dhe të mbështesë ekonominë digjitale dhe transformimin teknologjik në BE.

Në kuadër të përafrimit të kësaj rregulloreje, AKEP ka marrë pjesë në takime teknike të mbajtura me MIE, duke dhënë kontribut në analizën e implikimeve që kjo rregullore pritet të sjellë. Në këtë kontekst, është evidentuar nevoja për ndërhyrje dhe përafrim të mëtejshëm të legjislacionit kombëtar, në ligjin nr. 120/2016, si dhe koordinimi ndërinstitutional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, si AZHT, AKEP etj., duke marrë në konsideratë natyrën ndërsektoriale të kësaj rregulloreje dhe përfshirjen e disa institucioneve në zbatimin e saj.

3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 54/2024, ‘Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë’”

AKEP, në bashkëpunim me MIE, ka kontribuar në hartimin e propozimeve për ndryshime në ligjin nr. 54/2024, me qëllim krijimin e bazës ligjore për implementimin e regjimit “*roaming* si në shtëpi” (*roam like at home*) dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me kuadrin rregullator të Bashkimit Evropian.

Kontributi i AKEP në këto procese është fokusuar në ofrimin e ekspertizës teknike dhe rregullatore, në hartimin e një kuadri të qëndrueshëm dhe efektiv për zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve digjitale në vend.

Gjithashtu, AKEP ka dhënë kontributin e tij në hartimin e akteve nënligjore si më poshtë:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 219, datë 17.4.2025, “Për miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për domain-namet.al”.
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 8.10.2025, “Për miratimin e listës me përbërësit kritikë dhe pjesët e ndjeshme të rrjeteve 5G”.
3. Vendim i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të konkurrimit publik për dhënien e Autorizimit Individual për të drejtat e përdorimit të frekuencave”.
4. Vendim i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave specifike për transferimin ose dhënien me qira të të drejtave të përdorimit të frekuencave”.

5. Projektvendim, “Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të profilit të rrezikut të furnitorëve dhe ofruesve të pajisjeve të rrjetit 5G”.
6. Projektvendim, “Për ngritjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ekipit të përgjigjes ndaj emergjencave dhe krizës së sigurisë kibernetike”.
7. Projektvendim, “Për miratimin e masave për sigurimin e vazhdueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike në situata të jashtëzakonshme”.
8. Projektvendim, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimeve individuale për përdorimin e frekuencave të dhëna me konkurrim”.

Ndërkohë, në kuadër të bashkëpunimit institucional si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit në Bashkim Evropian (BE) lidhur me përafrimin e legjislacionit, AKEP ka shqyrtuar dhe përcjellë mendim për disa projektligje dhe projektakte të tjera, si:

1. Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 46/2015, “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.
2. Shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar”.
3. Projektligji, “Për mbrojtjen e konsumatorit”.
4. Projektligji, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të” të ndryshuar” etj.

7.2.2 Bashkëpunime të tjera

7.2.2.1 Bashkëpunimi me AKSK

Në respektim të rolit specifik në garantimin e sigurisë kibernetike në shkallë vendi, për arsye të mbikëqyrjes sistematike që ushtron mbi implementimin dhe respektimin e standardeve të sigurisë nga sipërmarrësit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, gjatë vitit 2025 AKEP-i ka patur një bashkëpunim të frytshëm me Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike. Ky bashkëpunim në shumë raste është shtrirë edhe te sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare. Komunikimi ndërmjet dy autoriteteve ka qenë i vazhdueshëm, bazuar në shkëmbime informacioni, por edhe në asistencë të ndërsjellë teknike.

Ndërkohë, me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 151, datë 6.3.2025, “Për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës *online* “Tik Tok”, është vendosur ndërprerja e aksesit në platformën *online* “TikTok” në territorin e Republikës së Shqipërisë, për një afat deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj, me qëllim shmangien e ndikimeve negative dhe të problematikave sociale në tërësi, kryesisht në nxitjen e dhunës, veçanërisht te fëmijët, që sjellin probleme të zhvillimit psiko-social të tyre, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Referuar VKM-së nr. 151, datë 6.3.2025, ngarkohet Autoriteti Kombëtar i Sigurisë

Kibernetike (AKSK), që në bashkëpunim me autoritetet rregullatore të fushës, të marrë masat e nevojshme për realizimin e ndërprerjes së aksesit. Në zbatim të VKM së sipërcituar, AKSK dhe AKEP kanë miratuar Urdhrin e Përbashkët, nr. 89, datë 7 mars 2025, “Për miratimin e masave teknike dhe procedurale për realizimin e ndërprerjes së përkohshme të aksesit në platformën online “Tik Tok” dhe detyrimin e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike për zbatimin e tyre”. Në kuadër të këtij procesi, AKSK ka përcaktuar si zgjidhje teknike për realizimin e bllokimit të aksesit në platformën Tik Tok, implementimin e teknologjisë *Deep Packet Inspection* (DPI). Si pjesë e zgjidhjes teknike, pranë Autoritetit rregullator AKEP është implementuar Qendra e Kontrollit të alerteve.

AKEP e ka ushtruar aktivitetin e tij në përputhje dhe në zbatim të parashikimeve me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 151, datë 6.3.2025, objekt i të cilit sikurse u citua është ndërprerja e aksesit në platformën online “Tik Tok”.

AKEP, me marrjen e kërkesave nga AKSK (e cila ka identifikuar IP-ve, DNS-ve dhe SNI-ve të TikTok), në zbatim të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ka kërkuar nga gjithë operatorët/sipërmarrësit që ofrojnë rrjete/shërbime publike të komunikimeve elektronike bllokimin e aksesit në IP-të, DNS-të dhe SNI-ve të TikTok, të lidhura me platformën TIK TOK në territorin e Shqipërisë.

Lista e IP, DNS dhe SNI ishte dinamike dhe AKSK në mënyrë të vijueshme ka përcjellë pranë AKEP kërkesa për bllokim të tyre.

7.2.2.2 Bashkëpunimi me ISHMT

AKEP, në zbatim të detyrimeve të legjislacionit në fuqi, lidhur me rregullat teknike për pajisjet radio dhe vlerësimin e konformitetit dhe garantimin e standardeve të tyre, ka qenë në komunikim më Inspektoriatin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), lidhur me hartimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, proces i finalizuar me nënshkrimin e Marrëveshjes përkatëse më datë 24.3.2026. Objekti i kësaj marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit institucional përmes shkëmbimit të informacionit dhe koordinimit të veprimeve, me synim rritjen e efikasitetit dhe përmbushjen e objektivave të përbashkëta në fushat e kompetencës së dy institucioneve.

7.2.2.3 Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes

AKEP ka bashkëpunuar me Ministrinë e Mbrojtjes në kuadër të grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të Tij, duke dhënë kontribut në përcaktimin e brezave të frekuencave, të dedikuar për shërbimet SAR në zbatim të Planit Kombëtar të Frekuencave.

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kërkim-Shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Planit të Veprimit të Tij”, ka si qëllim të përcaktojë kornizën ligjore, institucionale dhe operacionale të konsolidimit dhe funksionimit të një sistemi efektiv të kërkim-shpëtimit (SAR) në Republikën e Shqipërisë, përcaktimin e qartë të detyrave, kompetencave dhe përgjegjësi të të gjitha palëve të përfshira në ofrimin e shërbimeve SAR.

7.2.2.4 Bashkëpunimi me Policinë e Shtetit

AKEP ka zhvilluar takime me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim adresimin e problematikave lidhur me komunikimin e tyre me sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike sa i takon ruajtjes së të dhënave të trafikut, në kuadër të marrjes së informacionit të nevojshëm për të kryer detyrat funksionale që i ngarkon ligji.

Kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi përcakton detyrimin e sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike për ruajtjen e të dhënave të trafikut. Konkretisht, neni 160 i ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se, *për qëllime të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, luftimit të krimeve të rënda dhe parandalimit të kërcënimeve serioze ndaj sigurisë publike*, operatorët janë të detyruar të ruajnë të dhëna të trafikut të komunikimeve elektronike për një periudhë me afat maksimal 2 (dy) vjeçar. Po ashtu, AKEP e ka vendosur këtë detyrim për operatorët, edhe në kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm (rregullorja). I njëjti detyrim ligjor ka qenë i përcaktuar edhe në ligjin e mëparshëm të komunikimeve elektronike (ligji nr. 9918/2008, i shfuqizuar).

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e respektimit të këtij detyrimi ligjor, si dhe pasojave në parandalimin e veprave të rënda penale, pengimin e zbardhjes së tyre, humbje të provave digjitale, cenim të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar, AKEP i ka kërkuar operatorëve të telefonisë së lëvizshme marrjen e masave për respektimin e kërkesave të ligjit nr. 54/2024 dhe kushteve të autorizimit të përgjithshëm për ruajtjen e trafikut të të dhënave.

7.3 Pjesëmarrje në organin e rregullatorëve evropianë (BEREC)

AKEP, gjatë vitit raportues ka marrë pjesë në mënyrë aktive si vëzhgues në grupet e punës të BEREC, duke ndjekur zhvillimet rregullatore dhe praktikat më të mira në nivel evropian në fushën e komunikimeve elektronike. Kjo pjesëmarrje i ka mundësuar AKEP-it të jetë i integruar në mënyrë të vazhdueshme me proceset e harmonizimit rregullator të Bashkimit Evropian. Përmes statusit të vëzhguesit, është përfituar qasje e drejtpërdrejtë në diskutimet teknike dhe analitike të grupeve të punës, të cilat mbulojnë fusha kyçe si analiza e tregut, zhvillimi i rrjeteve fikse dhe mobile, neutraliteti i internetit, mbrojtja e përdoruesve fundorë, *roaming-u*, si dhe zhvillimet e kuadrit rregullator evropian. Gjithashtu, pjesëmarrja në këto grupe pune ka

kontribuar në forcimin e kapaciteteve institucionale të AKEP-it, duke rritur ekspertizën teknike dhe analitike të stafit përmes shkëmbimit të përvojave me autoritetet rregullatore të vendeve anëtare të BE-së, si dhe ka ndihmuar në harmonizimin e qasjeve rregullatore në fusha të rëndësishme si zhvillimi i infrastrukturës *broadband* dhe *gigabit*, implementimi i rregullave të konkurrencës, si dhe mbrojtja e konsumatorit në tregjet digjitale.

Në një plan më të gjerë strategjik, angazhimi i AKEP-it në BEREC si vëzhgues shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për procesin e integritit evropian të Shqipërisë, duke forcuar përgatitjen institucionale për përafrimin e plotë me standardet dhe praktikatat rregullatore të Bashkimit Evropian në sektorin e komunikimeve elektronike.

7.4 Aktivitete dhe pjesëmarrje në evente gjatë vitit 2025

7.4.1 Takim teknik ndërinstitutional për funksionimin e tregut të komunikimeve elektronike

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përmirësimit të funksionimit të tregut të komunikimeve elektronike, AKEP, më datë 15 korrik 2025 organizoi një takim teknik me përfaqësues të ofruesve të shërbimeve të internetit (ISP) dhe institucioneve kryesore, përfshirë MIE, OSHEE, Bashkinë Tiranë, ARRSH dhe FSHZH.

Takimi u fokusua në identifikimin dhe adresimin e problematikave që lidhen me funksionimin e tregut dhe ndërveprimin e operatorëve me infrastrukturën publike.

Gjatë diskutimeve u evidentuan sfida si vështirësitë në aksesin në infrastrukturën publike, kompleksiteti i procedurave ndërinstitutionale dhe nevoja për koordinim më të ngushtë ndërmjet institucioneve dhe operatorëve. U theksua gjithashtu nevoja për ndërhyrje konkrete në rastet e paligjshmërisë dhe për harmonizimin e kuadrit rregullator dhe teknik.

Takimi u konsiderua një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të funksionimit të tregut dhe forcimit të dialogut të qëndrueshëm ndërinstitutional.



7.4.2 Takim pune me ofruesit e shërbimit postar për transparencën, cilësinë dhe konkurrencën në treg

Në kuadër të përmirësimit të funksionimit të tregut postar, më 25 shtator 2025 AKEP zhvilloi një takim pune me ofruesit e shërbimit postar, me fokus adresimin e problematikave aktuale dhe përcaktimin e masave për rritjen e transparencës, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme.

Në takim morën pjesë përfaqësues të nivelit drejtues të operatorëve postarë, ndërsa u theksua nevoja për forcimin e mbikëqyrjes dhe zbatimin e detyrimeve ligjore nga subjektet e autorizuar. Gjatë diskutimeve u evidentuan problematika si ofrimi i shërbimeve pa autorizim, cilësia e pamjaftueshme e shërbimeve, si dhe pasaktësia e adresave që ndikon në shpërndarjen e dërgesave.

U nënvizua gjithashtu rëndësia e rritjes së transparencës përmes publikimit të saktë dhe të përditësuar të informacionit nga operatorët. Takimi shërbeu për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për krijimin e një tregu postar më të sigurt, transparent dhe konkurrues.

AKEP i ftoi ofruesit e shërbimeve postare të paraqesin me shkrim komentet dhe sugjerimet e tyre për të vlerësuar hapësirat e mundshme për ndërhyrje rregullatore në funksion të nxitjes së konkurrencës në treg. AKEP-i mbetet i angazhuar në luftën kundër informalitetit dhe identifikimin e subjekteve apo individëve që operojnë pa autorizimin përkatës. Gjithashtu, AKEP shprehu angazhimin për nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe koordinimin me të gjitha institucionet shtetërore që ndërveprojnë me ofruesit e shërbimeve postare, me qëllim evidentimin

e hapësirave të bashkëpunimit në funksion të nxitjes së konkurrencës në treg dhe mbrojtjen e konsumatorëve të shërbimeve postale.



7.4.3 Takim dialogues mbi reformat për zhvillimin e infrastrukturave digjitale dhe integrimin në BE

Në kuadër të avancimit të reformave për zhvillimin e infrastrukturave digjitale dhe procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, më 3 nëntor 2025 u zhvillua në Tiranë Takimi Dialogues “Drejt një Shoqërie Gigabit”, i organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me AKEP.

Takimi mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, të pushtetit vendor dhe të operatorëve të komunikimeve elektronike, me fokus përmirësimin e kuadrit rregullator dhe zbatimin e Rregullores Gigabit (GIA) në Shqipëri.

Gjatë diskutimeve u trajtuan çështje që lidhen me harmonizimin e kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së, zhvillimin e rrjeteve *broadband* dhe përmbushjen e objektivave të Kapitullit 10 “Transformimi Digjital dhe Media”.

U theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstytucional për zbatimin e reformave dhe ndërtimin e një ekosistemi digjital të qëndrueshëm. Takimi u konsiderua një hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së standardeve evropiane dhe ndërtimit të një shoqërie digjitale të avancuar dhe gjithëpërfshirëse.



KAPITULLI VIII: MIRADMINISTRIMI FINANCIAR DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

8.1 Performanca në mbledhjen e të ardhurave nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe operatorët e shërbimeve postare

Gjatë vitit 2025 janë realizuar të ardhurat nga pagesat e kryera prej sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare:

- Pagesa për caktim dhe përdorim të frekuencave;
- Pagesa për numeracion;
- Pagesa për mbikëqyrje tregu;
- Pagesa për koston e shërbimit të portabilitetit;
- Pagesa për domain;
- Komisioni i përfituar si agjent tatimor.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025”, i ndryshuar, AKEP-i u angazhua në faturimin dhe mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe përdorimin e tyre sipas kriterëve të përcaktuar për këtë qëllim.

Pagesat dhe komisioni i përfituar si agjent tatimor për AKEP-in gjatë vitit 2025 paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Programi 2025			Përqindja realizimi/plan
		Plani	Fakti	Arkëtimi	
Të ardhura nga pagesat gjithsej:		399.9	411.0	409.95	103
1	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike	188.0	188.0	188.0	100
2	Pagesat për caktim dhe përdorimin të frekuencave	114.9	116.2	115.6	101
3	Pagesa për Numeracion	25.5	26.3	25.9	102
4	Pagese për koston e shërbimit te portabilitetit te numrit	24.0	24.0	24.0	100
5	Pagesa nga mbikëqyrja e tregut të shërbimit postar	12.2	12.2	12.2	100
6	Pagesa për Domain	9.5	13.8	13.8	145
7	Pagesa dhe të ardhura të tjera	0.2	0.15	0.15	75
8	Komision nga agjenti tatimor	25.6	30.3	30.3	118

- janë faturuar rreth 411 milionë lekë, ose rreth 103 % e buxhetit;

- janë arkëtuar rreth 409.95 milionë lekë, ose rreth 99.7 % e faturimit.

Në krahasim me vitin 2024, janë faturuar rreth 4.5% me shumë dhe arkëtuar rreth 5% më shumë fonde.

Rritja e të ardhurave të faturuara krahasimisht me planin ka ardhur si pasojë e shtimit të faturimit për domain, kryesisht nga kërkesat e shtuara nga regjistrarët për blerje kredite dhe rinovim/regjistrim domain-esh.


Gjithashtu, gjatë vitit 2025, në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 8.7.2025, “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 30, datë 23.12.2014, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”, të ndryshuar, AKEP-i ka siguruar të ardhura prej afro 18% më shumë në rolin si agjentit tatimor.

Pagesat për AKEP ndër vite

Në milion lekë

Vitet	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Fondi i pagesave për AKEP	363	388.7	378.4	384.8	392.0	384.7	381.5	393.0	399.9
Pagesat për AKEP të realizuara	357.6	360.7	377.8	380.8	381.2	371.8	370.0	390.0	409.95
% e realizimit të pagesave ndaj programit	99%	93%	100%	99%	97%	97%	97%	100%	103%

Figura 31: Realizimi i pagesave nga AKEP sipas viteve



- **Pagesat nga mbikëqyrja e tregjeve**

Lidhur me procesin e realizimit të kësaj pagese, faturimet dhe arkëtimet janë:

- ✓ 188 milionë lekë faturuar nga mbikëqyrja e tregut të komunikimeve elektronike dhe arkëtuar 100% e shumës.
- ✓ 12.25 milionë lekë nga pagesa e mbikëqyrjes për tregun postar dhe arkëtuar 100% e shumës.

Gjatë vitit 2025, bazuar në deklaratimet e pasqyrave financiare të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, tregu i komunikimeve elektronike ka pësuar një rritje në masën 105% në krahasim me vitin 2024.

- **Pagesat nga përdorimi i spektrit të frekuencave**

Gjatë vitit 2025 janë:

- ✓ faturuar rreth 116.2 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i frekuencave dhe arkëtuar rreth 115.6 milionë lekë;

Referuar sa më lart, janë faturuar rreth 101.13% e pagesave për frekuenca dhe nga këto faturime janë arkëtuar rreth 99.48 %.

Vihet re sikurse dhe në vitet e mëparshme që ka një rënie të mëtejshme në faturimin e lidhjeve fikse. Në mbyllje të vitit 2025 operatori ONE revokoi 53 lidhje fikse dhe Vodafone ka revokuar mbi 69 lidhje fikse.

- **Pagesat për numeracion**

- ✓ Janë faturuar rreth 26.3 milionë lekë nga caktimi dhe përdorimi i numeracionit dhe arkëtuar rreth 25.9 milionë lekë.

Në lidhje me pagesat për numeracion janë arkëtuar rreth 100 %.

- **Pagesat për koston e shërbimit të portabilitetit**

- ✓ Gjatë vitit 2025 janë faturuar rreth 24 milionë lekë nga pagesat për koston e shërbimit të portabilitetit dhe janë arkëtuar 100% e vlerës së programuar.

- **Pagesa për Domain dhe të tjera**

Nga pagesat për Domain janë faturuar rreth 13.8 milionë lekë dhe janë arkëtuar rreth 100 % e shumës. Këtë vit ky zë ka shënuar rritje të ndjeshme në faturim fakti nga plani fillestar.

- **Komisioni si agjent tatimor**


Në programin e vitit 2025 ky zë u parashikua të ishte rreth 25.6 milionë lekë, por u realizua më shumë.

Nisur nga kërkesa e sipërmarrësve për breza të ndryshëm frekuencash dhe brezat që kanë në përdorim, janë faturuar rreth 550 milionë lekë, janë arkëtuar 541 milion lekë nga tarifat për përdorimin e spektrit të frekuencave.

Nga këto arkëtime, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë janë derdhur rreth 511 milionë lekë.

Si rezultat i faturimit, arkëtimit dhe derdhjes në Buxhetin e Shtetit të këtyre tarifave, janë arkëtuar në AKEP nga komisioni si agjent rreth 30.3 milionë lekë, ose rreth 118% e programit.

Figura 32: Struktura e pagesave për AKEP ndër vite



Gjatë vitit 2025, sipërmarrësit “ONE Albania” dhe “Vodafone Albania” kanë shlyer tërësisht detyrimet për Buxhetin e Shtetit, lidhur me dhënien e Autorizimeve Individuale për brezat 3400-3800 MHz, si dhe rinovimin e Autorizimit Individual për brezin 900-1800 MHz për ONE.

Pagesa të kryera në llogarinë e thesarit të AKEP dhe të kaluara për Buxhetin e Shtetit gjatë vitit 2025		
Pagesa për buxhetin e shtetit	900-1800Mhz	3400-3800 Mhz
One Albania	€ 1,454,969.83	€ 2,718,000.00
Vodafone Albania	-	€ 2,718,250.00
Totali sipas brezave (në euro)	€ 1,454,969.83	€ 5,436,250.00
Totali i arkëtuar (lekë)	677,728,724.68	

8.2 Ecuria e mbledhjes së detyrimeve financiare

Gjatë vitit 2025, AKEP ka llogaritur dhe dërguar faturat fiskale për vjeljen e detyrimeve të pagesave për AKEP për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe gjatë gjithë vitit ka ndjekur shlyerjen e detyrimeve nën një monitorim të vazhdueshëm nga strukturat përgjegjëse të AKEP. Buxheti i planifikuar i të ardhurave për vitin 2025, ishte 374 milionë lekë, janë ekzekutuar me pagesë të menjëhershme nga sipërmarrësit 1,452 fatura në vlerën e 380 milionë lek (102%). Në pikëpamje të mbledhjes së pagesave të sipërpërmendura, deri në datë 31.12.2025, janë arkëtuar 379.7 milionë lek (99.92%).

Në mbyllje të vitit 2025, rezultojnë 26 (njëzetegjashtë) subjekte me detyrim të papaguara në shumën 8,924,456 lekë, nga të cilat në masën 578,612 lekë për pagesën vjetore për AKEP (ose 0.2% të totalit të faturave të prera për vitin 2025) dhe në masën 8,345,844 lekë për tarifën për shërbimet e radiokomunikimit, nga e cila 8,000,000 lekë është detyrim nga Radio Televizioni Shqiptar, (shlyer tërësisht në datën 9 prill 2026).

Bazuar në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, veprimtaria e AKEP-it është e orientuar ngushtësisht me zbatimin e përcaktimeve ligjore, sa i përket detyrimit të të tretëve për kryerjen në kohë të pagesave përkundër përdorimit të frekuencave, *domain*-eve, serive numerike në përdorim prej tyre, etj., ndërkohë që në vazhdimësi inicion procese gjyqësore, dhe angazhon procedura përmbarimore për arkëtimin e debive.

AKEP ka iniciuar proceset gjyqësore pranë gjykatave kompetente me kërkesë padi për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj autoritetit dhe, si rezultat, gjatë vitit 2025 rezultojnë të jenë arkëtuar vlerat prej 996,495 lekë për detyrime financiare dhe në masën 230,000 lekë për sanksione me gjobë.

8.2.1 Procedurat gjyqësore

Gjatë vitit 2025 AKEP-i është përfshirë, në cilësinë e palës ndërgjygjëse në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në 6 (gjashtë) procese gjyqësore, të cilat vijojnë ende gjykimin, nga të cilat 2 procese gjyqësore për shlyerje të detyrimeve financiare dhe 4 procese gjyqësore me objekt përfundimin e marrëdhënies juridike të punës.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, AKEP është përfshirë si palë e paditur në 4 (katër) procese gjyqësore, të cilat vijojnë ende gjykimin, nga të cilat 3 procese gjyqësore me objekt përfundimin e marrëdhënies së punës dhe 1 proces gjyqësor si palë e tretë në çështjen me objekt ndalimin e përdorimit të *domain*.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, AKEP është përfshirë si palë e tretë në 1 (një) proces gjyqësor, i cili vijon ende gjykimin.

Ndërkohë, gjatë këtij viti, kanë përfunduar 8 procese gjyqësore, nga të cilat:

- 4 - pushuar (subjekti debitor ka shlyer detyrimin financiar kundrejt AKEP);
- 1 - humbur (vendimi është i formës së prerë dhe i paankimueshëm);
- 3 - procese gjyqësore, AKEP ka qenë në cilësinë e palës së tretë.

AKEP, gjatë kësaj periudhe, përveç ndjekjes së proceseve të iniciuara gjatë vitit raportues, ka vijuar ndjekjen e proceseve gjyqësore të mbartura prej viteve të kaluara, të cilat, për shkak të ushtrimit të ankimeve apo rekurseve prej palëve ndërgjygjëse, janë në proces gjykimi në Gjykatat e Apelit dhe Gjykatën e Lartë.

Pasqyrimi në mënyrë të përmbledhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tre shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur.

Kërkesat për lëshim urdhri ekzekutimi dhe kërkesat drejtuar shërbimit përbarimor shtetëror

AKEP, në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike, ka investuar organet gjyqësore duke kërkuar gjyqësisht shlyerjen e detyrimeve financiare apo lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, për 9 masa administrative të vendosura gjatë vitit 2024, prej të cilave:

- 2 tituj ekzekutive janë lëshuar;
- 1 kërkesë është rrëzuar (për shkak se nuk është provuar që debitori ka pasur dijeni për masën administrative);
- 6 kërkesa janë ende në proces shqyrtimi në gjykatë.

Sa i përket procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, AKEP i është drejtuar shërbimit përbarimor shtetëror për ekzekutimin e 11 titujve ekzekutivë të vitit 2025 dhe të mbartura nga vitet e kaluara, nga të cilat 9 kërkesa që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për shlyerje të detyrimeve financiare dhe 2 kërkesa që lidhen me vjeljen e sanksionit administrativ me gjobë.

Nga këto rezultojnë se 4 tituj janë ekzekutuar tërësisht dhe për pjesën tjetër vijon procedura e ekzekutimit nga shërbimi përbarimor.

8.2.2 Rishikimet buxhetore gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025 AKEP ka amenduar tavanet për parashikimet buxhetore për shpenzime korente dhe investime, si më poshtë:

- Me VKD nr. 8, datë 12.6.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr.32, datë 23.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025”, u shtua zëri “Shpenzime për investime” me 6,000,000 lekë dhe u reduktua zëri “Shpenzime për shërbime”, me të njëjtën masë. Qëllimi ishte blerja e 2 (dy) automjeteve të reja, për nevoja institucionale.
- Me VKD nr. 18, datë 14.10.2025, “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.12.2024, “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025”, i ndryshuar, u miratua kryerja e disa investimeve të reja të cilat u shoqëruan me rialokime zërash brenda tavanit të zërit “Shpenzime për investime”.
- Me VKD nr.4, datë 19.5.2025, “Për një ndryshim në VKD me nr. 23, datë 30.9.2024, “Për mënyrën e përdorimit të komisionit të përfutur nga AKEP si agjent tatimor për vitin 2025”, është përcaktuar se shuma e komisionit të përfutur si agjent tatimor të shpërndahet në masën jo më pak se 60% për shpërblime ndaj punonjësve.

Gjithashtu, në zbatim të objektivave institucionale dhe mbarëvajtjen e punës së administratës të AKEP, gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë ndërhyrje të nevojshme (rialokime) brenda tavaneve të zërit “Shpenzime për shërbime” sipas rastit, për shkak të aktiviteteve të paparashikuara të lindura gjatë vitit.

Konkretisht, rialokimet në zërat e përfshirë në grupin “Shpenzime për shërbime” që janë kryer gjatë vitit 2025, lidhen me:

- Rishikimin e strukturës organizative të AKEP, në zbatim të pikës 4, të nenit 14, të ligjit nr. 54/2024, me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 05, datë 19.5.2025, *“Miratimin e strukturës dhe organikës, elementeve përbërëse dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”*, duke reduktuar stafin nga 85 punonjës në 70, gjë e cila pasoi me ndryshime në planin e realizimit të disa zërave të parashikuar për vitin 2025;
- Mbylljen gjatë vitit 2025 të zyrave të AKEP në qytetet Korçë, Vlorë dhe Shkodër;
- Rishikimin e agjendës të takimeve/trajnimeve/përfaqësimeve të AKEP-it jashtë vendit, në kuadër të angazhimeve të reja që lidhen dhe me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE;
- Ndryshimin e kontratës aktuale të ambienteve me qira për zyrat qendrore të një pjese të stafit të AKEP, me efekte nga data 1 janar 2026, vendimmarrje e cila solli nevojën për disa ndryshime në shpenzimet administrative të parashikuar për vitin 2025;
- Realizimin e procesit të kalimit të kapitalit të 4 (katër) automjeteve nga pronësia e AKEP në pronësi të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si dhe blerja e 2 (dy) automjeteve të reja, solli rishikime në zërat e parashikuar për vitin 2025 për shërbimet për automjetet;
- Nevoja të ndryshme administrative për sigurimin e mbarëvajtjes së proceseve të punës të AKEP të paparashikuara.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar me sukses procedura prokurimi të parashikuara në buxhet, si dhe janë lidhur kontratat me operatorët ekonomik fitues, të cilat po vijnë të zbatohen përgjatë vitit 2025 dhe do të vazhdojnë të zbatohen sipas kohëzgjatjes 12 mujore kryesisht edhe në muajt e parë të vitit 2026.

8.2.3 Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2025

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues (VKD) nr. 32, datë 23.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025”, i ndryshuar, janë realizuar shpenzimet të ndara sipas llojit dhe natyrës, në milion lekë, sipas tabelës të mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2025
----	----------	-----------

		<i>Programi me ndryshimet 2025</i>	<i>Realizimi 2025</i>
Shpenzime gjithsej:		410.0	334.9
1	Shpenzime për paga dhe shtesa të tjera; Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndets	196.1	193.6
2	Shpenzime për materiale	9.0	3.8
3	Shpenzime për shërbime	156.8	123.1
4	Shpenzime për Investime	48.1	14.4
	% e realizimit kundrejt programit me ndryshime	82%	

Rishpërndarja e zërave të buxhetit solli realizimin e mbarëvajtjes së veprimtarisë financiare të AKEP, duke siguruar që pagesat e shpenzimeve administrative të kryheshin në kohë.

Gjatë vitit 2025 janë realizuar në total rreth 82% e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, ose rreth 334.6 milionë lekë. Realizimi i fondit të shpenzimeve për vitin 2025 ka pësuar një rënie pasi gjatë këtij viti u ndërmorën analiza të nevojave të AKEP lidhur dhe me angazhimet e reja institucionale në kuadër të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AKEP në dhjetor të vitit 2024.


Më poshtë gjenden të analizuara realizimet për shpenzime korente dhe investime për vitin 2025

- Shpenzime për paga, kontribute dhe të tjera, ka një realizim në masën 99% të planit të rishikuar. Gjatë periudhës raportuese janë miratuar disa vendime pëmes të cilave janë rishikuar tavanet buxhetore brenda kësaj kategorie shpenzimesh, duke u bazuar edhe në Udhëzimin e Përbashkët nënshkruar midis AKEP dhe Ministrisë së Financave “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për shërbimet e radiokomunikacionit”.
- Shpenzime për materiale, ka një realizim në masën 42% të planit vjetor. Realizimi i ulët i këtij zëri ka ardhur si pasojë e kalimit të kapitalit tek Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të 4 (katër) automjeteve të AKEP, duke sjellë ulje të shpenzimeve të parashikuara nën këtë zë për mirëmbajtjen e tyre (karburant, bateri, goma dhe pjesë këmbimi si dhe reduktimit të organikës të AKEP nga 85 në 70 punonjës.
- Shpenzime për shërbime, ka një realizim në masën 78% të planit të rishikuar, për shkak të zgjidhjes së kontratave ekzistuese (2 kontrata) për këto shërbime dhe zgjatjes së afateve në procedurat e prokurimit.

- Shpenzime për investime, ka një realizim në masën 30% të planit të rishikuar. Realizimi i ulët i këtij zëri ka ardhur si pasojë e mosrealizimit të disa zërave të parashikuar në planin e vitit 2025, konkretisht zëri “Implementimi i DNSSec per ccTLD.al”, pasi ka lindur nevoja e përmirësimit të komponentëve teknikë të sistemit, në të kundërt do duhej të ndërhyej përsëri në implementimin e DNSSec. Kjo do të çonte në rritje të kostove të implementimit të shërbimit DNSSe si dhe zgjatjes së procedurave të prokurimit dhe mospërfundimit i tyre brenda vitit 2025.

Më poshtë, paraqitje grafike e strukturës së shpenzimeve të buxhetuara në AKEP.

Figura 33: Struktura e shpenzimeve për vitin 2025



8.3 Reforma institucionale e AKEP-it në kuadrin e ligjit nr. 54/2024

8.3.1 Miratimi i strukturës së re organizative nga KD

Në zbatim të ligjit të sipërcituar, Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr. 05, datë 19.5.2025, miratoi Strukturën dhe Organikën e re të institucionit.

Struktura e re përbëhet nga 70 (shtatëdhjetë) pozicione pune, krahasuar me 85 pozicione të parashikuara në strukturën e mëparshme. Ky riorganizim reflekton një racionalizim të burimeve njerëzore dhe një konsolidim të funksioneve, duke eliminuar mbivendosjet dhe duke qartësuar linjat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së brendshme.

Struktura u hartua në përputhje të plotë me kompetencat e reja ligjore, me qëllim rritjen e efikasitetit institucional, forcimin e kapaciteteve të brendshme vendimmarrëse, përmirësimin e mekanizmave të transparencës dhe kontrollit të brendshëm, garantimin e ushtrimit të kompetencave rregullatore në mënyrë të pavarur dhe profesionale.

Organizimi i ri mbulon në mënyrë të plotë fushat kryesore të përgjegjësisë së AKEP, përfshirë:

- analizën dhe rregullimin e tregjeve;
- mbrojtjen dhe informimin e konsumatorit;
- menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave;
- sigurinë kibernetike;
- përpunimin dhe analizën statistikore;
- monitorimin e konkurrencës;
- menaxhimin e projekteve;
- përafrimin me *acquis communautaire* dhe praktikat e Bashkimit Evropian.

Një element i rëndësishëm i ristrukturimit është krijimi i një sektori të dedikuar për shërbimet postare, me qëllim forcimin e kapaciteteve rregullatore në këtë sektor, në përputhje me standardet evropiane.

Në tërësi, struktura e re organizative përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin e AKEP-it si autoritet rregullator i pavarur, i aftë të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga zhvillimet e sektorit dhe nga procesi i integritetit evropian.

8.3.2 Metodologjia e pagave dhe trajtimeve financiare të punonjësve

Në vijim të reformës institucionale dhe në zbatim të ligjit nr. 54/2024, Këshilli Drejtues i AKEP-it miratoi me Vendimin nr. 33, datë 22.12.2025, metodologjinë “Për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerave përkatëse, si dhe rregullave, kriterëve dhe masës së trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve për të punësuarit e AKEP”.

Miratimi i kësaj metodologjie përbën një akt të rëndësishëm në funksion të garantimit të pavarësisë financiare dhe administrative të institucionit, në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.54/2024, i cili njeh e AKEP si autoritet rregullator të pavarur me vetadministrim të të ardhurave.

Metodologjia synon:

- përcaktimin e një strukture page të qartë, transparente dhe të qëndrueshme;
- garantimin e konkurrueshmërisë së niveleve të pagave për të tërhequr dhe mbajtur burime njerëzore të kualifikuara;
- motivimin dhe ruajtjen e kapaciteteve profesionale;
- sigurimin e trajtimit të barabartë dhe objektiv të punonjësve;

- forcimin e stabilitetit dhe vijueshmërisë institucionale.

Parimet mbi të cilat bazohet kjo metodologji janë pavarësia institucionale, financiare dhe administrative, profesionalizmi, transparencja dhe përafrimi me praktikën e institucioneve të tjera rregullatore brenda dhe jashtë vendit.

Në mënyrë të veçantë, metodologjia garanton trajtim financiar më konkurrues për pozicionet teknike të lidhura drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve thelbësore rregullatore të AKEP-it, me qëllim tërheqjen dhe mbajtjen e ekspertizës së specializuar në fusha me kërkesë të lartë në treg.

Gjithashtu, metodologjia është në harmoni me politikat prioritare të reformës në administratën publike, sipas VKM nr. 91, datë 12.2.2025, “Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2026 - 2028”.

Në këtë mënyrë, miratimi i strukturës së re organizative dhe i metodologjisë së pagave përbëjnë dy shtylla thelbësore të reformës institucionale të AKEP-it, duke konsoliduar pavarësinë dhe kapacitetin rregullator të Autoritetit në përputhje me kuadrin e ri ligjor.

8.4 Trajnime profesionale të stafit

Gjatë vitit 2025 stafi i AKEP-it ka marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm aktiviteteve trajnuese, konferencash, seminareve dhe takimeve teknike, të organizuara nga institucione vendase dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete janë zhvilluar si brenda vendit, ashtu edhe jashtë tij, si dhe në formate hibride dhe *online*, duke mbuluar një gamë të gjerë tematikash në fushën e komunikimeve elektronike, sigurisë kibernetike, integritetit evropian dhe administratës publike.

Në nivel ndërkombëtar, përfaqësues të AKEP-it kanë marrë pjesë në aktivitete të organizuara nga institucione si ITU, Komisioni Evropian, TAIEX, RCC, BEREC, UPU, IEEE, si dhe organizata të tjera relevante. Këto përfshijnë konferenca dhe samite ndërkombëtare, si Samiti Botëror mbi Shoqërinë e Informacionit (WSIS+20) në Gjenevë, Kongresi Global i UPU-së në Dubai, konferenca të IEEE në Evropë, si dhe forume dhe panaire teknologjike në vende të ndryshme si Austri, Norvegji, Çeki, Francë dhe Arabinë Saudite.

Një pjesë e rëndësishme e këtyre aktiviteteve ka qenë e fokusuar në zhvillimet më të fundit në teknologjitë e komunikimeve elektronike, si implementimi i rrjeteve 5G, menaxhimi i spektrit të frekuencave, virtualizimi i rrjeteve celulare, si dhe qeverisja e të dhënave, inteligjenca artificiale dhe Interneti i Gjërave (IoT). Gjithashtu, janë zhvilluar aktivitete të specializuara në fushën e sigurisë kibernetike, përfshirë trajnime mbi menaxhimin e incidenteve, vlerësimin e rrezikut, standardet e sigurisë dhe simulimet praktike të mbrojtjes ndaj sulmeve kibernetike.

Në nivel kombëtar, një volum i madh trajnimesh është realizuar në bashkëpunim me institucione si ASPA, AKSK, AKSHI, si dhe institucione të tjera publike dhe partnere. Trajnimet e ofruara nga ASPA kanë mbuluar fusha të ndryshme si menaxhimi i projekteve, financat publike, prokurimi publik, etika dhe integriteti në administratë, analiza statistikore, menaxhimi i riskut, si dhe tematika të lidhura me integrimin evropian dhe zbatimin e *acquis* të BE-së.

Gjithashtu, janë zhvilluar një sërë takimesh teknike dhe konsultimesh publike në lidhje me projektligje dhe rregullore në fushën e komunikimeve elektronike, sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Këto aktivitete kanë kontribuar në përfshirjen aktive të institucionit në proceset legjislativë dhe rregullatore në vend.

Një tjetër komponent i rëndësishëm ka qenë pjesëmarrja në programe të dedikuara për ndërtimin e kapaciteteve, si “*Her CyberTracks*” dhe programe të tjera të ITU Academy, të cilat kanë ofruar mundësi për zhvillim të thelluar profesional në fusha specifike.

Në tërësi, pjesëmarrja në këto aktivitete ka ndikuar në rritjen e njohurive teknike dhe rregullatore të stafit, në përmirësimin e aftësive profesionale dhe në forcimin e kapaciteteve institucionale për të adresuar sfidat e tregut dhe për të përmbushur detyrimet në kuadër të integritimit evropian.

KAPITULLI IX: DREJTIMET KRYESORE TË PROGRAMIT TË PUNËS PËR VITIN 2026

Drejtimet kryesore të programit të punës të AKEP-it për vitin 2026, në kuadër të objektivave rregullatore:

1. Vijimi i punës për plotësimin e kuadrit nënligjor përmes miratimit të rregulloreve të reja dhe përditësimit të rregulloreve ekzistuese në funksion të vënies në zbatim të kuadrit të ri ligjor për komunikimet elektronike.
2. Menaxhimi eficient i burimeve të fundme, frekuencave, numrave, serive numerike.
3. Promovimi i investimeve në rrjetet e shpejtësisë së lartë dhe garantimi i konkurrencës efektive në treg.
4. Zgjerimi i rrjeteve dhe shërbimeve 5G në përmbushje të kushteve të përcaktuara në autorizimin individual.
5. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve dhe rritja e transparencës në ofrimin e shërbimeve të komunikimit elektronike dhe postare.
6. Harmonizimi i plotë i legjislacionit në kuadër të procesit të integritetit në zonën e përbashkët të *Roaming*-ut me BE-në.
7. Në cilësinë e institucionit pritës, organizimi i aktivitetit ndërkombëtar të rregullatorëve europianë (CN Meeting) 2026, në bashkëpunim me zyrën e BEREC.

ANEKS 1: VENDIME TË MIRATUARA NGA KËSHILLI DREJTUES I AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE GJATË VITIT 2025

NR. I VENDIMIT	DATA E VENDIMIT	TITULLI I VENDIMIT
1	19.03.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore për përcaktimin e modelit të përmbledhjes së kontratës për tu përdorur nga ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”. (vendimi nr.1,
2	19.03.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Mbi caktimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga AKEP”.
3	24.04.2025	Për miratimin e raportit të veprimtarisë së AKEP për vitin 2024.
4	19.05.2025	Për një ndryshim në VKD nr. 23, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e përdorimit të komisionit të përfituar nga AKEP si agjent tatimor, për vitin 2025”.
5	19.05.2025	Për miratimin e strukturës dhe organikës, elementëve përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të autoritetit të komunikimeve elektronike dhe postare.
6	19.05.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi i ofruesve të mundshëm të shërbimit universal postar”.
7	12.06.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Projektregullore për zbatimin e portabilitetit të numrit”.
8	12.06.2025	Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 22, datë 23.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025”.
9	23.07.2025	Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 22, datë 24.06.2011 “Mbi kushtet teknike për ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve kablllore urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndërrurbane të komunikimeve elektronike” të ndryshuar.
10	27.08.2025	Për miratimin e dokumentit përfundimtar: Analizë e tregut të shërbimeve postare dhe vlerësimi të ofruesve të mundshëm të shërbimit universal.

11	27.08.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut të telefonisë fikse – tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse.
12	27.08.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Projektregullore për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare.
13	27.08.2025	Për miratimin e disa tarifave/pagesave administrative për shërbimet që kryhen nga AKEP.
14	25.09.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit të rregullores për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.
15	25.09.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit “Projektregullore “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
16	25.09.2025	Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr.5, datë 19.05.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës, elementët përbërëse dhe vlerat e pages bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të AKEP”.
17	14.10.2025	Për dhënien e autorizimit individual shoqërisë “Posta Shqiptare” sh.a., për ofrimin e shërbimit universal postar.
18	14.10.2025	Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 32, datë 23.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2025 i ndryshuar.
19	03.11.2025	Për miratimin e dokumentit “Analizë e tregut të telefonisë fikse - tregjet me shumicë të terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse - dokument përfundimtar.
20	03.11.2025	Për përcaktimin e sipërmarrësit One Albania sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg, vendosjen e masave rregulluese për shërbimin e terminimit, heqja e statusit fnt si dhe masave rregulluese në tregun e tranzitimit të thirrjeve në rrjet fikse.
21	03.11.2025	Për përcaktimin e sipërmarrësve alternative me fuqi të ndjeshme në treg për terminimin e thirrjeve në rrjetet e tyre individuale publike të telefonisë fikse dhe vendosjen e masave rregulluese.
22	03.11.2025	Për miratimin e rregullores “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.
23	03.11.2025	Për miratimin e rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose

		shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
24	03.11.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: rregullore “Mbi masat organizative dhe teknike për garantimin e sigurisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
25	14.11.2025	Për miratimin e raportit përmbledhës të vlerësimit “Mbi përmbushjen e kushteve për përdorimin e frekuencave 2100 MHz (2 x 15 MHz, FDD) të sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a., të shoqëruar me propozimin për çmimin referencë minimal për rinovimin e autorizimit individual”.
26	14.11.2025	Për miratimin e rregullores “Për monitorimin e spektrit të frekuencave”.
27	14.11.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Rregullore e analizës së tregut”.
28	14.11.2025	Për miratimin për këshillim publik të rregullores “Për inspektimin e veprimtarisë së sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”.
29	14.11.2025	Për vlerësimin e punonjësve të AKEP, për përballimin e ngarkesës së shtuar të punës dhe realizimin e detyrave institucionale gjatë vitit 2025
30	22.12.2025	Për miratimin e buxhetit të AKEP për vitin 2026.
31	22.12.2025	Për miratimin për këshillim publik të dokumentit projektregullore “Për zbatimin e regjimit të autorizimit të përgjithshëm”.
32	22.12.2025	Mbi shtyrjen e afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Individual të sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a., për përdorimin e frekuencave të brezit 2100 MHz (sasi spektri 15 MHz, i çiftuar).
33	22.12.2025	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e elementeve përbërës të pagës bruto, vlerës, si dhe rregullat, kriteret, masën e trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimet e të punësuarve të AKEP.

ANEKS 2: ÇËSHTJET GJYQËSORE ME PALË AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ÇËSHTJE GJYQËSORE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË (INICIUAR 2025)			
Nr.	Paditës / I paditur	Objekti	Fituar / Humbur
1	Paditës: AKEP I paditur: Star Security Service sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
2	Paditës: AKEP I paditur: MEB L.L.C Albania sh.p.k.	Përmbushje detyrimi financiar	Në proces
3	Paditës: J.B I Paditur: AKEP Palë e tretë: DAP	Pretendim mbi përfundimin e statusit të nëpunësit civil	Në proces
4	Paditës: J.B I Paditur: AKEP Palë e tretë: DAP	Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit mbi përfundimin e statusit të nëpunësit civil	Në proces
5	Paditës: D.J I Paditur: AKEP Palë e tretë: DAP	Shpërblim dëmi si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës	Në proces
6	Paditës: A.Gj I paditur: AKEP	Dëmshpërblim dëmi financiar	Humbur I paankimueshëm

ÇËSHTJE GJYQËSORE NË GJYKATËN SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË			
Nr.	Paditës / I paditur	Objekti	Fituar / Humbur
1	Paditës: D.T I paditur: AKEP	Shpërblim dëmi si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënies së punës	Në proces
2	Paditës: E.M I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit për lirim e menjëhershëm nga puna	Në proces
3	Paditës: J.C I paditur: AKEP	Kundërshtim i vendimit mbi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil	Në proces

4	Paditës: BWT Holding I paditur: ISEC sh.p.k. Person i tretë: AKEP	Ndalimi i përdorimit të domain bët.al	Në proces
5	Paditës: Hertz.al I paditur: Besnik Merkaj Person i tretë: AKEP	Ndalimin e përdorimit të domain hertz.al	Përfunduar
6	Paditës: One Abania I paditur: Shoqëria Everest sh.p.k. Person i tretë: AKEP	Shpërblim dëmi kontraktor	Pushuar

ÇËSHTJE GJYQËSORE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT			
Nr.	Paditës / I Paditur	OBJEKTI	FAZA GJYQËSORE
1	Paditës: Unifi Holding I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit për sanksionimin me gjobë nr.152/2018	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
2	Paditës: AKEP I paditur: Tirana Tel shpk	Lëshim urdhër ekzekutimi për titullin ekzekutiv, gjobë nr.115/2018	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
3	Paditës: P.XH I paditur: Kuvendi i Shqipërisë/ AKEP	Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.107/2017 të Kuvendit të RSH, për largimin nga puna	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
4	Paditës: Erald Hysa I paditur: AKEP	Pavlefshmëri akti administrativ	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
6	Paditës: A.S I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit nr.301/ 2018, mbi përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
7	Paditës: Albtelecom (sot One Albania) I paditur: AKEP	Ndryshimin e pjesshëm të vendimeve nr. 73 dhe nr. 70 të Këshillit Drejtues të AKEP	Përfunduar gjykimi në Apel:Humbur pjesërisht nga AKEP VKD nr. 73 është shfuqizuar në vitin 2024

8	Paditës: Info Telecom I paditur: AKEP	Konstatim pavlefshmërisë absolute të faturës së AKEP për shlyerje të detyrimeve financiare	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
9	Paditës: Albtelecom I paditur: AKEP	Ndryshimin e vendimit nr. 11/2020 të Këshillit Drejtues të AKEP	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
10	Paditës: L.B I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit përfundimtar nr. 177/2020 për largimin nga puna.	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
11	Paditës: J.K I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit përfundimtar nr. 212/2020 për largimin nga puna	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
12	Paditës: One Telecommunication sh.a. I paditur: AKEP	Ndryshimin e vendimit nr. 7/2021 të Këshillit Drejtues të AKEP	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
13	Paditës: AKEP I paditur: Iva Electronic	Përmbyllje të detyrimi financiar	Fituar pjesërisht nga AKEP Në proces ankimi
14	Paditës: Turbo sh.p.k. I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit përfundimtar të inspektimit nr. 5/2021	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
15	Paditës: Posta Shqiptare I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit përfundimtar të inspektimit nr. 1/2020	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
16	Paditës: Vodafone Albania I paditur: AKEP	Shfuqizimin e vendimit përfundimtar të inspektimit nr. 3/2022	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
17	Paditës: Safecomm shpk I paditur: AKEP	Anulimin e pagesës në favor të AKEP	Humbur pjesërisht nga AKEP Në proces ankimi
19	Paditës: AKEP I paditur: Shoqëria Përmbarimore Private Elite Bailiffs Office	Pavlefshme titulli ekzekutiv	Humbur nga AKEP Në proces ankimi

	Pale e tretë: J. GJ		
20	Paditës: Mulliri Vjetër I paditur: Enkel Kapxhiu, Riselda Sejdijs Palë e tretë: AKEP	Ndalim përdorim domain mulliri.al	Pranim i kërkesëpadisë Në proces ankimi
21	Paditës: AKEP I paditur: Kristal shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
22	Paditës: AKEP I paditur: Rexha Group shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
23	Paditës: Neofone I paditur: AKEP/ Telecom Albania	Ndryshimin e vendimit nr. 15/2017 të Këshillit Drejtues të AKEP.	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
24	Paditës: Neofone I paditur: AKEP	Ndryshimin e vendimit nr. 30/2018 të Këshillit Drejtues të AKEP	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
25	Paditës: Neofone I paditur: AKEP	Ndryshimin e vendimit nr.38 dhe nr. 39 të vitit 2018 të Këshillit Drejtues të AKEP	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
26	Paditës: Neofone I paditur: AKEP Palë e tretë: Autoriteti i Konkurrencës	Anullimin e vendimit nr. 89/2018 për shfuqizimin e vendimit nr.78/ 2018, të KD të AKEP.	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
27	Paditës: Neofone I paditur: AKEP Palë e tretë: Autoriteti i Konkurrencës/Albtelecom sha	Ndryshimin e vendim nr. 96, datë 10.12.2018 për “Shqyrtimin e ankimit të sipërmarrësit Neofone sh.p.k.”	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
28	Paditës: Neofone I paditur: AKEP/ Vodafone Albania Palë e tretë: Autoriteti i Konkurrencës	Ndryshimin e vendimit nr.35, datë 14.10.2019, të Këshillit Drejtues të AKEP.	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
29	Paditës: AKEP I paditur: Jaguar sh.p.k	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
30	Paditës: AKEP I paditur: Jurisprudenca shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar nga AKEP Në proces ankimi

31	Paditës: AKEP I paditur: Badriklo shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
32	Paditës: AKEP I paditur: Goga shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
33	Paditës: AKEP I paditur: Shkëlzeni Agjenci shpk (2019)	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
34	Paditës: AKEP I paditur: Leksi Security	Përmbushje detyrimi financiar	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
35	Paditës: J.N I paditur: AKEP Palë e tretë: Përmbarues Gjyqësor Privat Valbona Qehajaj	Deklarimin e pavlefshmërisë së Titullit Ekzekutiv	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
36	Paditës: J.N I paditur: Përmbarues Gjyqësor Privat Valbona Qehajaj Palë e tretë: AKEP	Kundërshtimin dhe Anulimin pjesërisht të veprimeve përmbarimore	Humbur nga AKEP Në proces ankimi
37	Paditës: AKEP I paditur: Sajmiri AL shpk	Përmbushje detyrimi financiar	Fituar nga AKEP Në proces ankimi
38	Paditës: Shoqëria “Vodafone Albania” sh.a. I paditur: Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) Person i tretë: AKEP	Anulim: Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik	Në proces